



# Koha

www.koha.mk

**Një ide e mirë  
gjermane  
për 2018-n**

## AKTUALE

**A u shkelën  
parimet e  
sekularizmit?**



Hapja e dilemave rreth pjesë-marrjes masive të nxënësve në manifestime me karakter fetar, ka marrë së fundmi edhe përgjigjen e inspektorëve të arsimit, sipas të cilëve nxënësit dhe mësuesit janë qytetarë të lirë dhe mund të zgjedhin të manifestojnë përkatësinë e tyre fetare, mjafton që kjo të ndodhë jashtë institucioneve...

## RAJON

**Më shumë  
flitet sesa  
që luftohet  
korrupsioni**

## DOSSIER

**Një dokument  
që hedh  
dritë mbi  
shovinizmin  
maqedonas  
ndaj shqiptarëve**



**LIGJI PËR GJUHËT U VOTUA NGA SHUMICA PARLAMENTARE**

# SHQIPJA BARAZOHET ME MAQEDONISHTEN



Deputetët e VMRO-së nuk morën pjesë në seancë, ndërkaq nga ata që votuan "për" ishin shumica e deputetëve të partive shqiptare, deputetët e BDI-së, të ASH-së dhe ata të Lëvizjes BESA, pothuajse të gjithë deputetët e LSDM-së, si dhe deputeti i pavarur nga komuniteti rom, Amdi Bajram. "Nga sot, gjuha shqipe është e barabartë me gjuhën maqedonase dhe ky akt i sotëm i deputetëve në Parlamentin e Maqedonisë paraqet një festë të madhe për të gjithë ne. Nga ky vendim ka fituar Maqedonia dhe të gjithë qytetarët e vendit...", theksoi kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti

## Ushqim e veshje përmes internetit


Shkup, 11 janar - Oferta e larmishme, por edhe më e lirë se në tregtinë tradicionale, ka rritur dukshëm blerjet e qytetarëve të Maqedonisë përmes internetit. Këtë e konfirmojnë edhe të dhënat e Bankës Popullore të Maqedonisë, sipas të cilave në periudhën janar-shtator 2016 në tregtinë elektronike janë harxhuar afër 65 milionë euro. Një vit më vonë, për të njëjtën periudhë, tregtia elektronike është rritur për 20

për qind apo ka arritur në 78 milionë euro. Për rritjen e madhe të tregtisë elektronike në Maqedoni flet edhe fakti se në vitin 2014, në blerjet online janë harxhuar 25 milion euro, ndërsa tre vite më vonë vetëm, për periudhën janar-shtator, kjo shumë është trefishuar. Blerësit në internet preferojnë të blejnë më shumë veshmbathje, pajisje të ndryshme elektronike dhe sportive si, atlete apo...



## EDITORIAL

# DEFEKTET E BASHKËPUNIMEVE BRENDASHQIPTARE



Emin AZEMI

Strategjia e bashkëpunimit brendashqiptar në rajon, përpos defekteve që lidhen me (mos)implementimin e marrëveshjeve të aritura, vuan edhe nga një dozë e pakuptimtë e njëanshmërisë, gjegjësisht e përjashtimit të hapësirës shqiptare (kulturore e ekonomike) të Maqedonisë nga kjo strategji. Gjithkush e ka të qartë se Tirana e Prishtina e kanë shumë më lehtë të vendosin ura bashkëpunimi për çfarëdo çështje nga fusha të ndryshme, madje duke emëruar edhe zyrtarë nga Kosova në dikasteret qeveritare shqiptare, ndërkohë që metodologjia e bashkëpunimit me shqiptarët e Maqedonisë, jo vetëm që i ka specifikat e veta, ajo i ka edhe hendikepet përcjellëse.

Në radhë të parë, burokracitë e Tiranës e Shkupit, më përpara do të parapëlqenin të kontraktojnë marrëveshje që në vete përmbajnë problematika të përgjithshme, pak a shumë kosmopolite, dhe shumë më vështirë do të vendosnin ndonjë bashkëpunim të njëmendët kulturor që prek interesimet dhe fokusimet e shqiptarëve të Maqedonisë. Fatkeqësisht, në diplomacinë kulturore të Shkupit zyrtar, shqiptarët gati se janë të përjashtuar, dhe krejt të papërfillshëm, sidomos në bashkëpunimin e institucioneve shtetërore nga Maqedonia (teatrot, muzetë, galeritë, bibliotekat, ansamblet e ndryshme etj.) me institucionet simotra të botës, ndërkohë që arka shtetërore mbushet edhe me financat e taksapaguesve shqiptarë.

Prandaj, kërkesa për një vëmendje më të madhe të prodhimtarisë krijuese dhe aktiviteteve kulturore të shqiptarëve të Maqedonisë në protokollet e bashkëpunimit ndërshtetëror me Shqipërinë, është më se e arsyeshme dhe, madje, e vonuar. Nëse ndokush mendon se ardhjet ad hoc e artistëve e krijuesve nga Shqipëria në Shkup e Tetovë, përbushin nevojat e asaj që kanë nevojë realisht shqiptarët e Maqedonisë, ky në fakt do të ishte shtrembërimi i një gjendjeje që aspak nuk korrespondon me pritjet për një bashkëpunim më substancial.

Paradoksaliteti i bashkëpunimeve brendashqiptare në rajon, jo rralë është ushqyer edhe nga mania e subjektivizimeve të qarqeve të ndryshme të njerëzve, të cilët janë kujdesur që interesat e ngushta klanore t'i paraqesin gjoja si interesa të përgjithshme. Është e vetëkuptueshme që çdo njëri nga ne të ketë ndonjë mik në Tiranë a Prishtinë, të cilët do të tregoheshin më të vëmendshëm në përpilimin e agjendave kulturore, ku gjithsesi nuk do të mungonte edhe emri ynë, por kjo në asnjë mënyrë nuk e zëvendëson kuadrin më të gjerë të bashkëpunimit kulturor, në parametra më objektiv, si në pikëpamje të gjithëpërfshirjes së emrave dhe vlerave, ashtu edhe në pikëpamje të vendosjes së një kalendari afatgjatë të ngjarjeve me karakter jopersonal.

Krejt në fund. Qarkullimi i ideve e vlerave, sidomos tani kur po pretendojmë se duhet t'i përshtatemi proceseve eurointegruese, do të ishte i mangët, nëse në protokollet ndërshtetërore Maqedoni-Shqipëri do të mungonte potenciali më përfaqësues krijues e organizativ i shqiptarëve të Maqedonisë. Një nxitje më tepër e kësaj fryme pse të mos merret edhe nënshkrimi i marrëveshjes për bashkëpunim, që u bë ditë më parë, midis Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve të Maqedonisë dhe Arkivave të Shtetit Shqiptar.

Një akt si ky, por edhe paralajmërimi për shënimin e "Viti të Skënderbeut" edhe në Maqedoni, e legjitimojnë nevojën e kultivimit më intensiv të praktikave institucionale në kristalizimin e vizionit për të ardhmen kulturore të shqiptarëve në rajon.

## NJË OGUR I MBARË PËR SHQIPËRINË EVROPIANE

"Një lajm i mirë për të gjithë shqiptarët vlerësimi i shkrimtarit tonë të njohur Ismail Kadare me çmimin ndërkombëtar 'Nonino 2018', një çmim për figura të mëdha të kulturës me peshë botërore. Një ogur i mbarë për Shqipërinë evropiane dhe kontribut i çmuar për arritjen e qëllimit të saj madhor: Integrimin në Bashkimin Evropian", shkruan në profilin e tij zyrtarë në Facebook - presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta.

## LV I KTHEHET 17 PËRQINDËSHIT

"Ata që po thonë se LV po vetëshkatërrohet, nuk e kuptojnë se çka po ndodh. Si lëvizje dhe parti me strukturë amalgam (të pashkrirë), fryrja e saj në subjekt më të madhë zgjedhjet e qershorit, nuk ka prodhuar unitet, por fryrje të dy ballonëve përbërës me dy liderë kryesor, Albinin dhe Shpendin, që fryrjen e kanë parë si kontribut të vetin. LV kështu nuk po shkatërrohet, por po kthehet te elektorati i vetë 17% (plus rritja eventuale?) kurse krahu, balloni tjetër beson se ka mjaft krah që të vazhdojë rrugëtimin si subjekt i ri duke shpresuar se e ka të paktën 1/3 e elektoratit të qershorit, pra mbi 10%, që e bënë forcë parlamentare më të madhe se AAK dhe Nisma. Me këtë subjekt të ri ndryshon edhe problemi i numrave për qeverisje që bllokonte ose vështirësonte vendimmarrjen që nga viti 2013", shkruan në profilin e tij publicisti Shkëlzen Maliqi.

## DORËHEQJE QESHARAKE!

"Askush nuk diti të tregojë se pse po jep dorëheqje nga Vetëvendosja. Të gjithë të dorëhequrit po paraqiten si viktimë të linçimit, pa e specifikuar kush qenkan ata hundlesha që edhe ju kanë 'rrahë' edhe nuk ju lënë me qajt. Dorëheqja është akt i paaftësisë fizike, mendore, profesionale, shpirtërore etj. për ta kryer një punë, e kur thua se po jap dorëheqje i detyruar nga linçimi, atëherë rastin duhet ta paraqesësh në polici, sepse linçimi është i ndaluar me ligj. Ta vrasësh dikë moralisht apo ta varësh në litar pa i bërë 'gjqy' është krim. Nëse i quan linçim përgojimin dhe komentet negative në rrjetet sociale, atëherë ku janë ato 'linçime' që ne nuk po i shohim. Kush janë ato fantazma që po i linçojnë udhëheqësit e Vetëvendosjes, pa lënë asnjë gjurmë që shihet me sy e preket me dorë. Linçimi lë pasoja të mëdha te viktimë, rrezik që viktimat bien në depresion, izoloohen nga shoqëria, e humbasin besimin në njerëz dhe në veten, dhe psikologjia bile e parasheh që njeriu i linçuar nga trauma post-linçim në fund të fundit shumë kollaj mund të çojë edhe dorë kundër vetes...", shkruan në profilin e saj në FB, publicistja Kimete Berisha.

## DY VETITË KUNDËRSHTUESE TË SHQIPTARËVE

"Ne shqiptarët, pavarësisht hapësirës ku jetojmë, bartim dy veti, kundërshtuese dhe të habitshme: Mendjehapur, mirëkuptues dhe tolerant, deri në inferioritet me të huajt, afër dhe larg; Agresiv, mendjembyllur dhe asgjësues, deri në shkatërrimin e tjetrit, ndërmjet vendit... Shënim: Bashkëjetesa fetare në mes nesh është një rastësi e përveçme", shkruan në Facebook studiuesi i letërsisë shqipe, Behar Gjoka.

## MEDIACitate

Deputeti Frashër Krasniqi, i cili aktualisht ndodhet në Burgun e Dubravës, ka dhënë dorëheqje dje nga pozita e delegatit të Këshillit të Përgjithshëm dhe çdo pozitë tjetër në Vetëvendosje. Në një letër të dërguar nga Burgu i Dobravës, Krasniqi flet për raportet me Albin Kurtin, madje kujton një rast kur ky i fundit e kishte quajtur idiot. "Ta shohësh e përjetosh në lëkurën tënde tek quhen sërish tradhtarë ata që e thonë të vërtetën; tek quhen spiunë ata që u rriten në VETËVENDOSJE! dhe dhanë gjithçka për të. Përmasë kësaj letre jap dorëheqje nga pozita e delegatit të Këshillit të Përgjithshëm dhe çdo pozitë tjetër brenda organizatës, i vetëdijshëm që do të përballem me po ato shpifje e sharje që u përballën shoqet e shokët e mi. Por nuk do të bëhem pishman. Asnjëherë", shkruan mes tjerash Krasniqi.

(KOHA Ditore, 11 janar)

Tre liderët e Kosovës presidenti Hashim Thaçi, kryeministri Ramush Haradinaj, si dhe kryeparlamentari Kadri Veseli nuk janë unikë në qëndrime për temat më të vështira me të cilat po ballafaqohet vendi. Derisa presidenti Thaçi dhe kryeministri Haradinaj vazhdojnë ta kundërshtojnë Gjykatën Speciale, kryeparlamentari Veseli së fundmi ka ndryshuar qëndrim dhe ka dalë pro kësaj të fundit. Dihet se Thaçi dhe Haradinaj janë "në një vijë" për Specialen, por janë në pozicione diametralisht të kundërta për çështjen e demarkacionit me Malin e Zi.

(Zëri, 11 janar)

Presidenti amerikan Donald Trump duket se ka bërë një hap pas, sa i përket përfshirjes së SHBA-ve në marrëveshjen e Parisit për klimën. Në një takim me gazetarët, ai tha se vijon të mendojë se kjo marrëveshje është e keqe për SHBA-të, por nuk është kundër thelbit të saj. Trump pranoi se Shtetet e Bashkuara mund t'i bashkohen marrëveshjes së Parisit për klimën, nëse respektohen disa kushte. Vendimi i tij për t'u tërhequr nga kjo marrëveshje qershorin e kaluar, bëri që SHBA-të të ishin i vetmi vend i mbetur jashtë paktit. Kjo sjellje solli zemërim të madh si në vend, ashtu edhe jashtë vendit, ndërsa u quajt si një abdikim i udhëheqjes amerikane, në një sfidë kyçe globale.

(Top Channel, 11 janar)

## NËSE NUK E KENI DITUR...

## ÇFARË KA QENË VALIU?

Valiu ka qenë qeveritar i një vilajeti në shek.XVI-XVII dhe i një vilajeti në shek.XVIII-XIX në Perandorinë Osmane. Deri në vitet '30 të shek.XIX tokat shqiptare bënin pjesë në Vilajetin e Rumelisë. Valiu ishte në Vilajet përfaqësuesi më i lartë i pushtetit qendror dhe kryekomandant i forcave të armatosura kur nuk caktohej një tjetër për punët ushtarake në kohë lufte. Këtë post si valiu i Vilajetit të Rumelisë e zunë më 1802-1803

Ali Pashë Tepelena dhe më 1804-1806 Ibrahim Pashë Bushatlliu. Nga vitet '30 të shek.XIX me reformat e Tanzimatit dhe me ndarjen e Vilajetit të vjetër të Rumelisë në tri Vilajete më të vogla, valiu ishte vetëm përfaqësuesi më i lartë i pushtetit qendror në njërin nga Vilajetet. Me krijimin në vitet 1864-1868 të vilajeteve si njësi më e madhe administrative, valiu u vu në krye të secilit prej tyre.

LIGJI PËR GJUHËT MË NË FUND U VOTUA NGA SHUMICA PARLAMENTARE

## SHQIPJA BARAZOHET ME MAQEDONISHTEN

Deputetët e VMRO-së nuk morën pjesë në seancë, ndërkaq nga ata që votuan "për" ishin shumica e deputetëve të partive shqiptare, deputetët e BDI-së, të ASH-së dhe ata të Lëvizjes BESA, pothuajse të gjithë deputetët e LSDM-së, si dhe deputeti i pavarur nga komuniteti rom, Amdi Bajram

ÇFARË PARASHEH  
LIGJI PËR GJUHËT

Kur jemi tek përmbajtja e Ligjit - që në pesë nenet e para parashikohet që në të gjitha organet e pushtetit shtetëror në Republikën e Maqedonisë, institucionet qendrore, ndërmarrjet publike, agjencitë, drejtoritë, institucionet dhe organizatat, komisionet, personat juridikë, të cilët ushtrojnë autorizime publike në pajtim me ligjin dhe institucionet e tjera, gjuhë zyrtare krahas gjuhës maqedonase dhe shkrimit të saj të jetë, edhe gjuha që e flasin 20 për qind nga qytetarët e Republikës së Maqedonisë dhe shkrimi i saj (gjuha shqipe). "Në institucionet nga neni 1 paragrafi (3) nga ky ligj në pushtetin shtetëror në Republikën e Maqedonisë gjuhë zyrtare krahas asaj maqedonase dhe shkrimit të saj, është edhe gjuha të cilën e flasin të paktën 20 për qind nga qytetarët e Republikës së Maqedonisë dhe shkrimi i saj në: komunikim, përdorim dhe zbatim në të gjitha procedurat e qytetarëve para gjitha organeve të cilat e përbëjnë pushtetin shtetëror (Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, Presidenti i Republikës së Maqedonisë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë, gjyqësia, prokuroria publike), Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë, Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë, në procesin zgjedhor, arsim, shkencë, shëndetësi, kulturë, gjatë zbatimit të autorizimeve policore, në veprimtarinë radiodifuzive, noteri, ekzekutiv, objektet infrastrukturore, evidencën amë, dokumentet personale, financa, ekonomi si dhe në sferat e tjera", thuhet në sqarimin zyrtar të këtij ligji. Institucionet janë të obliguara sipas detyrës zyrtare të sigurojnë shfrytëzim, komunikimin dhe procedurat të zhvillohen në gjuhën të cilën e flasin të paktën 20 për qind nga qytetarët në Republikën e Maqedonisë dhe shkrimi i tij nëse personi, gjegjësisht pjesëmarrësi flet gjuhë të cilën e flasin të paktën 20 për qind nga qytetarët në Republikën e Maqedonisë. Gjithashtu, ueb faqet e institucioneve dhe përmbajtja e ueb faqes krahas në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e tij, detyrimisht do të publikohen edhe në gjuhën e ndryshme nga gjuha maqedonase të cilën e flasin të paktën 20 për qind nga qytetarët në Republikën e Maqedonisë dhe shkrimin e tij. Emërtimet e institucioneve si dhe të gjitha institucionet e tjera dhe njësitet e tyre rajonale në njësinë e vetëqeverisjes lokale në të cilat të paktën 20 për qind nga qytetarët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase edhe në Shkup, do të shkruhen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e tij cirilik dhe në gjuhën shqipe.

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 11 dhjetor - Me 69 vota "për" dhe asnjë "kundër" të enjten u votua Ligji për përdorimin e gjuhëve përmes të cilat gjuha shqipe - përveç gjuhës maqedonase, bëhet zyrtare në të gjitha organet e pushtetit qendror. Gjithashtu, Ligji për gjuhët u votua edhe me Parimin e Badenterit, nga deputetët e komuniteteve jo shumicë në vend edhe atë me 27 vota "për" dhe asnjë "kundër". Deputetët e VMRO-së nuk morën pjesë në seancë, ndërkaq nga ata që votuan "për" ishin shumica e deputetëve të partive shqiptare, deputetët e BDI-së, të ASH-së dhe ata të Lëvizjes BESA, pothuajse të gjithë deputetët e LSDM-së, si dhe deputeti i pavarur nga komuniteti rom, Amdi Bajram. Pas votimit të Ligjit, kryetari i Komisionit për çështje evropiane, Artan Grubi, tha se miratimi i Ligjit për shqipen është sukses i përbashkët i deputetëve në Parlament. Siç tha Grubi, me miratimin e Ligjit në fjalë rrumbullakësohet pjesa normative e Marrëveshjes së Ohrit. "15 vjet pas nënshkrimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, me votimin e Ligjit të gjuhëve është rrumbullakësuar pjesa normative, tani ngelet që të implementohet. I falënderoj të gjithë deputetët që votuan për Ligjin, por edhe ata që nuk votuan kundër Ligjit për gjuhët. Vlerësoj se Ligji është i përkrahur nga të gjitha palët, pasi të gjithë partitë janë nënshkruese të Marrëveshjes së Ohrit. Pres që opozita ta përkrah këtë Ligj, edhe pse nuk ishin në Parlament gjatë kohës së votimit. Me këtë Ligj do të fitojë Maqedonia, ndërkaq do të relaksohen marrëdhëniet ndëretnike, do të mbyllën shumë tema të cilat dalin nga pjesa normative e Marrëveshjes së Ohrit", theksoi Grubi. Ai më tej shtoi se Ligji aktual është shtrirje maksimale që e lejon korniza kushtetuese. "Që nga java e ardhshme edhe mbishkrimi në Parlamentin dhe Qeverinë do të jetë edhe në gjuhën shqipe dhe kjo është e drejtë

ligjore. Ligji aktual është shtrirje maksimale në kuadër të kornizës që e lejon Kushtetuta", ka thënë Grubi.

I PRITSHËM MOSNËNSHKRIMI  
I LIGJIT NGA IVANOVI

Siç dihet, në rast të mos nënshkrimit të Ligjit nga ana e Presidentit të vendit, i njëjti Ligj mund të kthehet në votim më së paku 30 ditë dhe më pas - me votimin "për" të shumicës parlamentare, Ligji do të hyj në fuqi menjëherë pa pritur të shpallet në gazetë zyrtare. Vetë presidenti Ivanov gjatë fjalimit vjetor në Parlament më 28 dhjetor të vitit të kaluar, pati kritika të forta kundër Ligjit për gjuhët, me çka në mënyrë indirekte paralajmëroi mos nënshkrimin e Ligjit. "Për shkak të pikëve politike afatshkurtra, po vihen në pikëpyetje interesat e përhershme të Maqedonisë dhe popullit maqedonas. Kërkesa për dygjuhësi është e rregulluar me Amendamentin 5 nga Kushtetuta, e cila doli nga Marrëveshja e Ohrit, ku rregullohet çështja për gjuhën zyrtare në Maqedoni. Ligji është represiv, ata që pohojnë se ky Ligj është në përputhshmëri me Kushtetutën dhe ligjet, do t'i pyes me cilën Kushtetutë dhe cilat ligje? Pas konsultimeve me ekspertë, mund të pohoj se ky Ligj për gjuhët nuk është kërcënim për gjuhën maqedonase, por për unitaritetin e shtetit", pati theksuar Ivanov në fjalimin e tij vjetor para deputetëve, me çka në fund u duartrokoi gjatë nga deputetët e VMRO-së. Kur dihet që shumë ekspertë maqedonas ishin aktiv në opinionin në atë që Ligji për gjuhët nuk është në pajtim me Kushtetutën dhe i njëjti nëse votohet mund të ketë

ZYRTARIZIMI I GJUHËS SHQIPE,  
HISTORIKE PËR SHQIPTARËT

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, përmes një postimi në faqen e vet në Facebook ka përshëndetur miratimin e Ligjit të gjuhës shqipe nga Parlamenti i Maqedonisë. "Miratimi nga parlamenti në Shkup i ligjit të gjuhës shqipe, një arritje historike për shqiptarët që demokratizon e forcon vetë Maqedoninë", shkroi Rama në Facebook.



implikime kushtetuese dhe ligjore, nuk përjashtohet që ndokush prej tyre të ngritë iniciative në Gjykatën Kushtetuese për të dhënë vlerësim mbi kushtetutshmërinë e Ligjit për gjuhët. Nga ana tjetër, ekspertë të njohur shqiptar vazhdimisht kanë insistuar në atë se Ligji për gjuhët është në përputhje të plotë me nenin 5 të Kushtetutës së Maqedonisë, i cili thotë se "gjuhë tjetër zyrtare përveç gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik, është edhe gjuha që flasin mbi 20 % të popullatës jo shumicë". Kur dihet fakti se shpesh anëtarët e Gjykatës Kushtetuese kanë anuar nga pushteti në vlerësimin e ligjeve specifike, kësaj radhe kur dihet që LSDM është në pushtet - ndoshta nuk do të ndodh më e keqja dhe të votohet kundër këtij Ligji. Nga anëtarët e rinj të Gjykatës Kushtetuese që të enjten u votuan në Parlament, doktori i shkencave juridike Osman Kadriu përsëritë qëndrimet e tij se Ligji për gjuhët është në harmoni të plotë me dispozitat kushtetuese.

UNIFORMAT DHE BANKËNOTAT  
NË KOMISIONIN E VENECIAS

Siç ka paralajmëruar LSDM, nenet që kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhës shqipe në uniformat

policore dhe ushtarake, si dhe përdorimin e gjuhës shqipe në banknotat shtetërore, Qeveria do të kërkojë mendim në Komisionin e Venecias. Kjo do të ndodh pasi të hyj në fuqi Ligji për gjuhët. Në rast se Komisioni i Venecias do t'i vlerësojë si antikushtetues dispozitat ligjore në fjalë, atëherë Qeveria do të nis propozim-ligj për ndryshimin e Ligjit për gjuhët në Parlament. Ndryshe, debati për Ligjin për gjuhët filloi më 5 shtator të vitit të kaluar në Komisionin Parlamentar për Çështje Evropiane, ndërsa shumica parlamentare e aprovoi nevojën për miratimin e tij më 15-të nëntor të vitit të kaluar. Por për leximin e dytë - më 15 dhjetor në Komisionin për çështje evropiane, LSDM dorëzoi katër amendamente me theks përmendjen e gjuhëve të komuniteteve tera përveç gjuhës shqipe në organet e pushtetit lokal. Por meqë në ligjet me shenjë e BESë debati zgjat vetëm tre ditë, kjo hapësirë juridike u shfrytëzua maksimalisht nga kryetari i Komisionit për çështje evropiane, Artan Grubi, duke humbur kohën me debatin për dy amendamente të lëvizjes BESA, gjë që bëri që amendamentet e LSDM të mos diskutohen fare.

## ZBATIMI MBETET SFIDË

Pasi të hyj në fuqi Ligji për gjuhët - topi do të jetë te Qeveria për zbatimin e këtij Ligji. Qeveria pritet të themelojë dy institucione përkatëse që lidhen direkt me zbatimin e Ligjit. "Agjencia për zbatimin e gjuhës" dhe "Inspektoratit për shfrytëzimin e gjuhëve" në përbërjen e Ministrisë së Drejtësisë. Në propozim-ligjin në

fjalë, janë paraparë edhe gjopa në vlerë prej 4.000 deri 5.000 euro për organin si dhe të gjitha institucionet e tjera për mosrespektim të dispozitave nga ky ligj. Gjohë në vlerë prej 30 për qind nga gjopa e vlerësuar do t'i shqiptohet edhe personit zyrtar dhe personit përgjegjës për mosrespektim të Ligjit.

BE ME POROSI PËR SHKUPIN ZYRTAR

# REFORMAT DHE MARRËVESHJA E PËRZHINËS, KYÇE PËR MAQEDONINË

Në mbledhjen e parë të eurokomisarëve flitej edhe për prioritetet institucionale të BE-së në periudhën e ardhshme - reformat në ekonomi dhe unioni monetar, përforcimi i kufijve të jashtëm dhe Shengeni, formimi i tregut të vetëm digjital evropian



cilat në këtë moment janë në "fazë inetrne punuese". Vetëm ashtu Komisioni Evropian do të mund të rekomandojë hapje të negociatave inkuadruese", paralajmërojnë në BE. Përfaqësuesit evropianë nga vendi presin edhe vazhdimin e përforcimit të marrëdhënieve me fqinjët.

Zëdhënësja e KE-së, Maja Kocijançiq sqaron se në KE në këtë moment punojnë në dy dokumente, të cilat kanë të bëjnë me Ballkanin perëndimor. I pari është Strategjia, e cila duhet të prezantohet në shkurt, ndërsa për prillin është planifikuar raporti i planifikuar i rregullt për përparimin, i cili do të jetë pasqyrë e situatës

në të gjitha vendet në procesin e eurointegritimit dhe rekomandimet e KE-së, si dhe edhe çka më tej për secilin vend ndaras. Me këtë rast, sipas Kocijançiq, KE-ja vlerëson se është me rëndësi të bëhet kornizë e ndarë punuese për secilin vend nga Ballkani Perëndimor. Në mbledhjen e parë të komisarëve të KE-së në vitin 2018 mes të tjerash u shqyrtua edhe afrimi i Ballkanit Perëndimor drejt BE-së.

"Që këtë ta arrijnë vendet nga rajoni duhet t'u japin prioritet më të lartë reformave në sferën e sundimit të së drejtës, jurisprudencës dhe të drejtave themelore. BE-ja nuk do të bëjë kompromise rreth

kritereve për anëtarësim", thotë Kocijançiq. Tema e njëjtë do të jetë në rend të ditës edhe nesër, kur në Sofje komisarët evropianë do të bisedojnë me përfaqësuesit bullgarë për prioritetet e kryesimit bullgar me BE-në. Në pajtim me paralajmërimet nga Brukseli, edhe Sofja zyrtare porositi se gjatë kryesimit gjashtëmuor, prioritet i saj do të jetë pikërisht përparimi i Ballkanit Perëndimor. Në detajet nga raporti punues i KE-së thuhet se vendet nga Ballkani Perëndimor duhet t'u japin prioritet më të lartë reformave në sferën e sundimit të së drejtës, jurisprudencës dhe të drejtave të njeriut.

Bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore do të jenë një nga kushtet për përparimin e vendeve nga Ballkani Perëndimor jo vetëm në vitin 2018, por edhe kusht për anëtarësim në BE. Në mbledhjen e parë të eurokomisarëve flitej edhe për prioritetet institucionale të BE-së në periudhën e ardhshme - reformat në ekonomi dhe unioni monetar, përforcimi i kufijve të jashtëm dhe Shengeni, formimi i tregut të vetëm digjital evropian.

Bruksel, 11 janar - Bashkimi Evropian nga pushteti dhe nga opozita në Maqedoni pret të vazhdojnë me plotësimin e Marrëveshjes politike të Përzhinës, e në të njëjtën kohë nga vendi pritet të punojnë në prioritetet urgjente reformuese dhe në kthimin e rrugës eurointegruese, thonë burime nga Bashkimi Evropian, njoftoi Dojçe Vele. Kjo është përmbajtur në dokumentet të cilat i përgatit BE-ja për periudhën e ardhshme, të

## Çavkovi ndjehet i pafajshëm

Shkup, 11 janar - Akuzat për "terorizëm", ish-drejtori i Byrosë për Siguri Publike, Mitko Çavkov, të enjten para Këshillit Penal në Gjykatën e Apelit në Shkup i ka refuzuar dhe për ngjarjet e 27 prillit është shprehur se ndjehet i pafajshëm. Angazhimin e tij shumëvjeçar dhe profesional në polici, Çavkov e ka marrë si bazë se akuzat që i ngarkohen nuk janë të drejta. "Kjo lëndë është absurde. Drejtpërdrejtë udhëhoqa aksionin e 27 prillit, me çka edhe urdhërova shpëtimin e jetëve të deputetëve. Kështu që privimi im nga liria është i kundërligjshëm", tha mes tjerash Çavkov. Duke filluar nga dita e mërkurë e deri në përfundim të shqyrtimit të 16 ankesave të palës mbrojtëse, Gjykata e Apelit duhet të prononcohet për masat e paraburgimit që i vuajnë këta të arrestuar. Në arsyetimin se paraburgimi i Mitko Çavkovit duhet të ndërpritet, avokati Sasho Dukovski theksoi se klienti i tij ka pësuar infarkt dhe se brenda ditës, ai doemos duhet të lëviz deri në 10 kilometra, respektivisht të pranojë ushqim të posaçëm. Ndërkohë, përfaqësuesi i Prokurorisë së Lartë, prokurori Dilaver Bekteshi ka nënvizuar se Çavkovi edhe më tej duhet të qëndrojë në paraburgim, për shkak të rrezikut që të ndikojë mbi dëshmitarët dhe personat tjerë.

Gjatë ditës së enjte, po ashtu para Gjykatës së Apelit u procedua ankesa e nëpunësit të Agjencisë për Zbulim, Munir Pepiq. Me këtë rast ai u shpreh se ditën 27 prillit, në Parlament ka qëndruar, sipas detyrës zyrtare, gjegjësisht caku i tij ka qenë një "iks" person. "Unë kam luftuar për sigurinë e shtetit. Nëntë vite me radhë e kam kënduar himnin e Maqedonisë. Nuk mundet të më thërrasin terrorist", tha, Pepiq. Ai, mes tjerash shtoi se mbrëmjen e 27 prillit e ka ndihmuar deputeten Radmilla Shekerinska që të largohet, me çka asaj ia ka veshur një pallto të mjekëve të ndihmës së parë. Përveç kësaj akuze, agjenti sekret i Agjencisë për Zbulim, Munir Pepiq, është pjesë e aktakuzës për rastin "Titanik", ne të cilën i është konfiskuar pasaporta. (O.XH)

## Emri, përdorimi dhe irredentizmi, linja e kuqe e Demokracisë së Re

Athinë, 11 janar - Emri, përdorimi dhe irredentizmi, janë tre pikat si pjesë e linjës kombëtare të partisë opozitare greke Demokracia e Re, të cilat përsëri i përmendi kryetari i partisë. Kirjakos Micotakis, njofton korrespondenti i MIA-s nga Athina, në kuadër të turneut dyditor në Greqinë e Veriut foli para anëtarëve të partisë në Litohero dhe u përqendrua edhe në çështjen për emrin. Prej bashkëpartiakëve të tij kërkoi të kenë besim në të, siç kanë pasur besim në Kostas Karamanlis në vitin 2008 në Bukuresht, kur është formuar edhe linja e kuqe

greke për emrin, pozitë, që sipas Micotakis dhe tani është e pandryshuar, ndërsa ka të bëjë me kufijtë në të cilat një zgjidhje do të ishte e pranueshme për Demokracinë e Re. "Edhe sot, në tërësi në fuqi është linja e njëjtë kombëtare. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me çështjen e emrit. Ka të bëjë me çështjet për përdorimin e emrit atë që e quajmë erga omnes. Ka të bëjë gjithsesi edhe me çështjet me irredentizmin dhe kërkesat e pranueshme prej fqinjëve, të cilët e ofendojnë krenarinë kombëtare jo vetëm të maqedonasve por edhe të grekëve. Dhe kjo

duhet të ndalojë nëse me të vërtetë duam të gjejmë zgjidhje të pranueshme", sqaroi Micotakis, transmeton MIA. Kryetari i partisë opozitare greke, në fjalimin e tij tha se jorastësisht ka zgjedhur të jetë në qytetet konkrete në Greqinë e Veriut, në rajonin Maqedonia, duke e lidhur turneun e tij me bisedimet për emrin. "Këto janë ditë kur e di shumë mirë se bashkëkombësit tanë të rajonit Maqedonia ndjehen të brengosur, por në të njëjtën kohë janë në pritje të zgjidhjes së çështjes kombëtare", tha Kirjakos Micotakis.

## KADRIU DHE KOSTADINOVSKI EMËROHEN GJYKATËS KUSHTETUES

Shkup, 11 janar - Parlamenti i Maqedonisë dje i zgjodhi Osman Kadriu dhe Darko Kostadinovskin për gjykatës të rinj kushtetues. Kadriu dhe Kostadinovski vijjnë në vendin e gjykatësve Natasha Gaber Damjanovska dhe Gëzime Starovës, të cilave mandati u përfundoi në tetor të këtij vitit. Ato u zgjodhën për gjykatëse të Kushtetueses me propozim të presidentit Branko Cërvenkovski në vitin 2008. Osman Kadriu është jurist i shquar dhe i njohur në Republikën e Maqedonisë. Si propozim për gjykatës në Gjykatën Kushtetuese vjen nga komuniteti akademik, si profesor në Fakulte-



tin për Shkenca Juridik në FON, ekspert në fushën e së drejtës obligative. Ai ka stazh disa dekada, në fushën e shkencave juridike si gjyqtar në Gjykatën Komunale në Kërçovë, anëtar i Këshillit Gjyqësor

Republikan dhe avokat. Më shumë se dhjetë vite, dr. Kadriu ka qenë i angazhuar si profesor në Fakultetin Juridik të Universitetit Shtetëror të Tetovës në sferën e së drejtës civile. Dr. Kadriu i ka publikuar

katër libra prej sferës civile-juridike, marrëdhëniet e punës dhe juridike dhe sistemi politik. Është autor i mbi 50 temave shkencore bibliografike dhe artikujve të publikuar në revistat e njohura profesionale në Maqedoni dhe jashtë vendit. Darko Kostadinovski është doktor i shkencave të drejtësisë në Universitetin "Shën Cirili dhe Metodi" në fushën e të drejtës ndërkombëtare. Ka doktoruar në temën "Kompetenca këshillëdhënëse e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë: pasojat ligjore nga mendimet këshillëdhënëse të Gjykatës", dhe është autor i librave "Arbitrazhi Ndërkombëtar" dhe

"Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë - domosdoshmëri për reforma dhe ndryshime (Mendimet këshillëdhënëse të Gjykatës së dhe implikimet e tyre)". Kostadinovski si propozim për gjyqtar kushtetues, vjen nga vendi këshilltar për politikë të jashtme në kabinetin e presidentit të Republikës së Maqedonisë. Ai është anëtar i Kabinetit të presidentit që nga viti 2001 në Kabinetin e atëhershëm të presidentit, Boris Trajkovski. Në vitin 2015, Kostadinovski është emëruar në funksionin i dërguar i Republikës së Maqedonisë në Aleancën e civilizimeve të Kombeve të Bashkuara.

## SEZONË E NXEHTË GJYQËSORE

Me interes të posaçëm pritet të procedohet edhe rasti "Monstra" nga ana e Prokuroria për ndjekjen e korrupsioni dhe krimin të organizuar, proces ky që do të mbahet me 12 shkurt, kurse sulmuesit e deputetit Zijadin Sela do të gjykohen më 26 janar



# BANKAT E TË AKUZUARVE PLOT ME POLITIKANË

Koha

Omer XHAFERI

Shkup, 11 janar - Procesi gjyqësor kundër të dyshuarve për "tentim vrasje" ndaj kreu të Aleancës për Shqiptarët, deputetit, Zijadin Sela, është caktuar për 26 janar. Lëndën gjyqësore kundër dhjetë të akuzuarve do ta procedon gjykatësja Sllavica Andreevska, konfirmojnë për gazetën KOHA nga Gjykata Penale në Shkup.

Përveç të akuzuarit Kire Gjeorgjievski dhe babait të tij, të cilët u arrestuan disa javë pas ngjarjeve të 27 prillit në parlament, në bankën e të akuzuarve do të ulen edhe Oliver Ovashovski, Sasho Senkov, Nikollçe Dimitriesvki, Aleksandar Janevski-Toshta, Andrej Micov, Nikolla Vojminovski, Stojan Pavlevski-Kobra dhe Kosta Dellov.

MPB arriti që t'i arrestoj të kërkuarit për rrahjen brutale të deputetit, Zijadin Sela, në bazë të hetimeve ndaj këtij grupi dhe thirrjes publike për denoncim dhe prezantimit të fotografive të të dyshuarve. I akuzuari Kire Gjeorgjievski dhe prindi i tij, dyshohet se në sallën numër 3 të Kuvendit, kanë filluar ta godasin deputetin Sela. Ndërkohë të njëjtit, së bashku me disa të akuzuar tjerë, nga videot e publikuara në

opinion shihen se si e tërheqin zvarrë deputetin Sela, nëpër korridoret e parlamentit. Njëkohësisht, më i riu prej këtij grupi të të akuzuarve, është i dyshuari Kosta Dellov, i cili përmes statusit të tij në rrjetin social "fejsbuk", disa orë pas ngjarjeve të dhunshme në parlament shkroi "Ndjenja e rrahjes brutale të Zijadin Selës, me të goditur në kokë, është e pa përshkruar". Nga java e ardhshme fillojnë edhe gjykimet kundër ish funksionarëve të lartë të shtetit, përfshi Nikolla Gruevski, Sasho Mijallkovin dhe Gordana Jankullovska.

Pakoja e aktakuzave të iniciuara në qershor të vitit të kaluar nga Prokuroria Speciale Publike, fillon të procedohet nga e para. Në muajin janar dhe shkurt mbahen 34 seanca gjyqësore. Me interes të posaçëm pritet të procedohet edhe rasti "Monstra" nga ana e Prokuroria për ndjekjen e korrupsioni dhe krimin të organizuar, është ajo për rastin "Monstra", proces ky që do të mbahet me 12 shkurt. Njëkohësisht, prej aktakuzave më atraktive të iniciuar nga PSP, pa dyshim është lënda e bashkuar për rastet "Target- Fortesa", ku si të dyshuar kryesor ngarkohen ish funksionarët e lartë të policisë së shtetit dhe policisë sekrete, dyshja Mijallkov-

Jankullovska. Seanca për këtë lëndë pritet të mbahet me 17 janar. Kurse më 18 janar, është caktuar të mbahet procesi gjyqësor kundër Sead Koçanit, Vasilije Aviroviq dhe Safet Vatiq, të cilët PSP, i ka ngarkon për keqpërdorim të mjeteve buxhetor në vlerë prej 17 milionë euro, në rastin "Trust".

Gati çdo të dytën ditë, në GJPSH, pritet të gjykohen të akuzuarit për rastin "Transportesi" (ish kreu i Manastirit, Vladimir Talevski), për rastin "Tenderat" (ish Ministria e Kulturës, Elizabeta Kançevska-Milevska) e kështu me radhë. Në vazhden e këtyre gjyqimeve, mes tjerash më 6 shkurt është paraparë të vazhdon seanca për rigjykimin e rastit të "Sopotit", me cka kësaj radhe si dëshmitar pritet të prezantohen pjesëtarët e Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbuli, të cilët e kanë maltretuar dëshmitarin e mbrojtjes, Ramadan Bajrami. Nëpunësit e policisë sekret e Robert Ivanovski, Boban Stojanovski, Ilija Smilevski, Mile Vellkovski, Marjan Nikolovski dhe Mile Andonovski (një pjesë e të cilëve janë në pension), duhet të japin detaje për rrjedhën e hetimeve lidhur me zbardhjen e vrasjes së ushtarëve Polak, në vitin 2003 në fshatin Sopot të Kumanovës.

## Bogoevski ka shpifur për Ahmetin dhe Xhaferin



Shkup, 11 janar - Gjykata Themelore Shkup 2 e pranoi padinë e Ali Ahmetit dhe Musa Xhaferit kundër ish-zbuluesit Sllobodan Bogoevski për shpifjen se ata kanë marrë rryshfet nga "Maxhar Telekom". Vendimin të enjten e publikoi Gjykata Themelore Shkup 2 në ueb faqen e saj. Në vendim citohet se Bogoevski është përgjegjës për shpifjen për Ahmetin

dhe Xhaferin. Bogoevski nuk do t'i paguajë dëmshpërblim Ahmetit dhe Xhaferit sepse ata e kanë tërhequr kërkesën.

Bogoevski para gjykatës në Nju-Jork në procedurën e cila zhvillohej kundër tre ish-menaxherëve të "Maxhar Telekom" deklaroi se dy funksionarët e lartë të BDI-së kanë marrë rryshfet prej 2.5 milionë eurosh.

## KRONIKË

### Edhe një sulm nga qentë endacakë

Një gjashtëdhjetë e tre vjeçar nga Shkupi ka paraqitur se dje rreth orës 11:30 minuta është sulmuar nga dy qen endacakë në rrugën "Februarski pohod" në Novo Lisiçe. Siç njoftoi MPB, një prej qenve e ka kafshuar atë në pjesën e pasme të këmbës së majtë duke e lënduar dhe gjakosur. Shkupjani ka shkuar vetë në Klinikën Infektive ku i është dhënë ndihma mjekësore. Policia konfirmoi se rasti është paraqitur në orën 11:45 minuta.

### Ndalohen 7 valltare në lokalit "Korabi"

Të mërkurën mbrëma rreth orës 23 e 30 minuta pjesëtarë të Policisë së Tetovës në bashkëveprim me njësinë për kriminalitet ndërkufitar, të huaj dhe riatdhesim, kanë realizuar një aksion kontrolli në lokalit e natës "Korabi" pronë e B.L 48 vjeçar nga Tetova. Gjatë kontrollit, në objektin e locuar në rrugën regjionale Tetovë-Gostivar, në Sedllarcë të Epërme janë ndaluar 7 vajza valltare, të cilët kanë argëtuar mysafirët prej të cilëve dy shtetase të Shqipërisë, A.S 47 vjeçare dhe E.Gj 23 vjeçare dhe 5 shtetase të Maqedonisë nga Shkupi, Struga, Velesi dhe Tetova të moshës nga 30 deri në 41 vjeçare. Për shkak të keqpërdorimit të qëndrimit turistik, shtetaset e Shqipërisë janë arrestuar në Stacionin Policor në Tetovë, janë mbajtur për procedurë të mëtejshme, ndërsa shtetaset e Maqedonisë janë lëshuar. Pas zbardhjes së rastit, dy shtetaset e Shqipërisë do të kenë padi adekuate dhe do të depërtohen në vendin e tyre.

### Vajza pasi u kthye në shtëpi sërish largohet

Vajza 15 vjeçare nga Gostivari, e cila u denoncua se është gjetur nga të afërmit e saj në shtëpinë e të dashurit, sërish është denoncuar se është larguar nga shtëpia në drejtim të panjohur. Largimin nga shtëpia e ka denoncuar babai i saj 59 vjeçar I.P nga Gostivari, banor në lagjen e Fazanerisë. Përndryshe, më 7 janar vajza ishte denoncuar se është larguar nga shtëpia, kurse më 9 janar ishte vetëparaqitur në polici, ndërsa tashmë e njëjta sërish është larguar. Rastet e largimit të vajzave nga shtëpia tashmë janë bërë dukuri e shpeshtë.

### Digjet një Golf në "Maxhir Maalo"

Herët në mëngjesin e djeshëm rreth orës 04:50 minuta ka shpërthyer një zjarr në rrugën "Gjuro Gjonoviç" në lagjen e Shkupit "Maxhir Maalo" ku si pasojë u dogjën një automjet golf dhe dy shtylla druri. Policia njoftoi se automjeti është në pronësi të B.A (76) nga Shkupi. Zjarri është shuar në orën 05.25 minuta nga ana e Brigadës Zjarrfikëse në Qytetin e Shkupit. (U.H)

"BUZMI" SI SHKAS

# A U SHKELËN PARIMET E SEKULARIZMIT?

Inspektorët e arsimit kanë qetësuar opinionin me konstatimin e tyre se "shkollat nuk kanë realizuar veprimtari fetare për Karvanin e Buzmit". Nxënësit dhe mësuesit ishin në periudhën e pushimeve dimërore dhe, jashtë shkollës janë qytetarë të lirë për të manifestuar përkatësinë fetare. Procedurë për shqyrtimin e rastit ka hapur, me vetëiniciativë edhe Avokati i Popullit



komuna.

Karvani, pjesë e të cilës u bënë edhe nxënësit, ndau opinionin në ata që e konsideruan manifestimin si cenim të sekularizmit të shtetit dhe si rrezik për keqësimin e marrëdhënieve ndërfetare dhe në ata që e konsideronin angazhimin e të rinjve si shprehje të vlerave në respektim të festave fetare. Çështja u aktualizua dhe mori nuanca politike edhe për shkak të mbështetjes që kishte karvani i Buzmit nga ana e disa kryetarëve të komunave, siç ishte rasti me Komunën e Ohrit. Por pavarësisht qëndrimeve diametralisht të kundërta, "për" dhe "kundër", manifestimit në publik të përkatësisë fetare nga ana e nxënësve, për ngjarjet që implikuan nxënësit në atë manifestim, Inspektorati Shtetëror i Arsimit (ISHA) doli me qëndrimin zyrtar se "shkollat nuk kanë realizuar veprimtari fetare për Karvanin e Buzmit". Në fakt, një ditë pas atij aktiviteti ishte Ministria e Arsi-

mit dhe Shkencës (MASH) e cila reagoi përmes një njoftimi në të cilin u kërkonte shkollave që "mbi gjithçka të ruajnë sekularizmin". Në të njëjtën kohë bëhej e ditur se nga MASH as është kërkuar dhe as është dhënë ndonjë leje për ndërmarrje të çfarëdoqë aktiviteti që i lidhën nxënësit me organizimin dhe pjesëmarrjen në aktivitete të këtilla gjatë gjysmëvjetorit të arë të vitit shkollor 2017/2018. Madje, që në krye të informacionit, MASH kujton se manifestimi për Karvanin e Buzmit është mbajtur në kohën e pushimeve shkollore. "Lidhur me ngjarjet e datës 6 janar 2018, kur grupe të fëmijëve morën pjesë në manifestime fetare në më tepër qytete të Maqedonisë, MASH bën të ditur se bëhet fjalë për periudhë kur nxënësit janë në pushim dimëror, kur prindërit respektivisht kujdestarët e organizojnë kohën e lirë dhe aktivitetin e fëmijëve të tyre".

Duke u bërë garant për respek-

timin e të drejtave fetare të qytetarëve dhe lirisë për shprehje të lirë të përkatësisë fetare, MASH citon nenin 11 të Ligjit për arsim fillor ku thuhet se "në shkollat fillore ndalohet organizimi dhe veprimi politik dhe fetar", ndërsa mësuesit dhe nxënësit e lëndëve që prekin çështje fetare, të obligueshme dhe zgjedhore, janë të obliguar të ndjekin programin e miratuar nga ana e Ministrisë. Megjithatë, për të sqaruar të gjitha dilemat që u hapën për shkak të Karvanit të Buzmit kërkoi nga ISHA-ja që të inspektojë të gjitha indicet për organizimin eventual apo veprimtari fetare të shkollave. Inspektimi rreth implikimit eventual të shkollave nuk mund të bëhej para datës 9 janar, kur edhe përfundonte pushimi për mësuesit dhe administratën e shkollave. Për këtë ISHA nxori në terren inspektorët rajonal ditën e nesërme dhe pas mbikëqyrjes së jashtëzakonshme u konstatua se "shkollat nuk kanë



Inspektimi rreth implikimit eventual të shkollave nuk mund të bëhej para datës 9 janar, kur edhe përfundonte pushimi për mësuesit dhe administratën e shkollave. Për këtë ISHA nxori në terren inspektorët rajonal ditën e nesërme dhe pas mbikëqyrjes së jashtëzakonshme u konstatua se "shkollat nuk kanë përgjegjësi, pasi në asnjë mënyrë nuk kanë marrë pjesë në organizimin e Karvanit të Buzmit". Sipas drejtorit Tome Spirovskit, nxënësit janë organizuar përmes rrjeteve sociale dhe janë ftuar nga organizata jo qeveritare. "I shqyrtuam raportet e të gjitha qyteteve dhe erdha në përfundim se shkollat nuk kanë realizuar veprimtari fetare", ka deklaruar Spirovski, drejtori i ISHA-së.

përgjegjësi, pasi në asnjë mënyrë nuk kanë marrë pjesë në organizimin e Karvanit të Buzmit". Sipas drejtorit Tome Spirovskit, nxënësit janë organizuar përmes rrjeteve sociale dhe janë ftuar nga organizata jo qeveritare. "I shqyrtuam raportet e të gjitha qyteteve dhe erdha në përfundim se shkollat nuk kanë realizuar veprimtari fetare", ka deklaruar Spirovski, drejtori i ISHA-së. Procedurë për të parë nëse janë shkelur ose jo parimet e sekularizmit ka hapur me vetëiniciativë edhe institucioni i Avokatit të Popullit.

EDHE NJË INVESTIM ME VLERË MBI 2.5 MILIONË EURO

## "Alkaloid" hapi tre reparte të reja

Shkup, 11 janar - Kompania "Alkaloid SHA Shkup" në prezencë të përfaqësuesve të menaxhimit zyrtarisht lëshoi në përdorim tre projekte investuese: Repart për prodhim të formave farmaceutike gjysëm të ngurta (pomada, kremra, xhele dhe vagitorë); Peshore Qendrore 2 dhe Repart për paketim të formave të ngurta farmaceutike. Repartet e reja prodhuese, kumtuuan nga kompania, shtrihen në sipërfaqe prej 1000 m2 ndërsa vlera e këtij investimi të ri të "Alkaloid SHA Shkup" arrin mbi 2,5 milionë euro. Gjatë zbatimit të këtyre projekteve, janë implementuar standardet më moderne për Praktikë të mirë prodhuese (GMP).

"Prania e kompanisë në tregjet e mbi 30 vendeve në botë dhe synimi i vazhdueshëm drejt hapjes së tregjeve të reja edhe perspektiva të reja, kërkon ndjekje të kujdeshme të trendeve nga fusha e shëndetësisë dhe farmacisë dhe implementimi i tyre në punën e përditshme. Për këtë qëllim, investimet në kapacitete të reja, teknologji, njohuri dhe kuadro do të vazhdojnë të jenë imperativ në operacionet tona të përditshme", deklaroi kryetari i Bordit Drejtues të "Alkaloid SHA Shkup", Zhivko Mukaetov me rastin e lëshimit në përdorim zyrtar të projekteve të reja investuese. Theksoi se përcaktimi human programor prodhues

i orientuar kryesisht për konsumatorët final është parim sipas të cilit zhvillohen dhe do të vazhdojnë të zhvillohen operacionet e përditshme, duke u kujdesur rreptësisht për kredibilitetin dhe aksesin profesional të cilat i praktikojnë dhe zbatojnë në punën e përgjithshme të tyre. Nga kompania informojnë se repartit për prodhim të formave farmaceutike gjysëm të ngurta (pomada, kremra, xhele dhe vagitorë) përfshin 460 m2 sipërfaqe të pastra në të cilat zhvillohet procesi i tërësishëm i matjes së lëndëve të para, përgatitja e gjysmë produkteve si dhe dozimi dhe paketimi i prodhimeve të gatshme. Vlera e



përgjithshme e këtij investimi është rreth 1,4 milionë eurosh. Peshorja Qendrore 2 është investim i cili shtrihet në sipërfaqe prej 240 m2 dhe për të cilën kompania ka alokuar 600.000 euro për pajisje

dhe kapacitete. Repartit për paketim të formave të ngurta përfshin sipërfaqe prej 300 m2 në të cilën janë të instaluar dy linja prodhuese. Vlera e këtij projekti arrin 500.000 euro.

TREGTIA ELEKTRONIKË NË MAQEDONI

USHQIM

E VESHJE

PËRMES

INTERNETIT

Me përhapjen e internetit, po zhvillohet edhe tregtia elektronike, kurse treguesit statistikorë thonë se në Maqedoni kjo tregti shënon trende rritjeje, duke arritur në më shumë se 78 milion euro në vitin që shkoi

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 11 janar - Oferta e larmishme, por edhe më e lirë se në tregtinë tradicionale, ka rritur dukshëm blerjet e qytetarëve të Maqedonisë përmes internetit. Këtë e konfirmojnë edhe të dhënat e Bankës Popullore të Maqedonisë, sipas të cilave në periudhën janar-shtator 2016 në tregtinë elektronike janë harxhuar afër 65 milionë euro. Një vit më vonë, për të njëjtën periudhë, tregtia elek-

tronike është rritur për 20 për qind apo ka arritur në 78 milionë euro.

Për rritjen e madhe të tregtisë elektronike në Maqedoni flet edhe fakti se në vitin 2014, në blerjet online janë harxhuar 25 milion euro, ndërsa tre vite më vonë vetëm, për periudhën janar-shtator, kjo shumë është trefishuar.

Blerësit në internet preferojnë të blejnë më shumë veshmbathje, pajisje të ndryshme elektronike dhe sportive si, atlete apo edhe celularë. Blerësit në Maqedoni përveç uebfaqes së preferuar kineze "Alibaba", me të madhe në vitet e fundit shfrytëzojnë edhe uebfaqet vendore që ofrojnë lirime për blerjet në grup të prodhimeve dhe shërbimeve të ndryshme.

"Në internet më së shpeshti blihen pajisje sportive me afër 55 për qind, pajisje elektronike me 16 për qind, prodhime të ndryshme për amvisëri me 13 për qind, akomodim në hotel me afër 10 për qind si dhe udhëtime të ndryshme. Bile me 8 për qind, qytetarët në Maqedoni porosisin online edhe ushqim dhe prodhime ushqimore", tregojnë të dhënat e Entit të Statistikës. Dyqanet prej nga më shumë blejnë konsumatorët, janë

në Maqedoni, në Evropë por edhe në shtetet jashtë Evropës.

Pjesa më e madhe e transakcioneve në internet, apo 43 për qind janë në vlerën prej 50 deri 99 euro. Pasiq në më pak se 50 euro, ndërsa me 19 për qind janë prezente ato më të shtrenjta që kapin vlerën prej 100 deri 499 euro.

Njohësit e kësaj fushe të tregtisë sqarojnë se është shpërndarja e madhe e internetit në amvisëritë në vend që ka ndikuar në masivizimin blerjeve online, por edhe përcjellja e ngadalshme, por e sigurt e trendeve evropiane të blerjes, pranimi i teknologjive të reja etj.

Këtë fakt e konfirmojnë edhe bartësit dhe kreatorët e këtij biznesi. "Një nga parakushtet e zgjerimit të tregtisë elektronike është edhe posedimi i madh i internetit tek qytetarët, përdorimi i kartelave pagesore, oferta e mirë e kompanive, përdorimi i aplikacioneve për celularë e kështu me radhë", nënvizon Nina Angellovska, pronare e kompanisë për shitje përmes internetit.

Në ndërkohë, një problem tjetër që pritet të zgjidhet në të

ardhmen është edhe lehtësimi i kushteve për blerje përmes internetit jashtë shtetit. Nga Agjencia e Postës së Maqedonisë presin që të rritet kufiri prej 45 në 150 euro i shumës në të cilën doganohet malli për përdorim personal që qytetarët e porosisin nga jashtë përmes internetit. Aktualisht në transportin e udhëtarëve në Maqedoni ekziston mundësia që në mënyrë legale të mund të importohet mall për konsum personal në vlerë prej në denarë prej 350 euro pa pagesën e doganës, ndërsa në transportin e postës kjo shumë është 45 euro, edhe pse nga Agjencia e Postës që para disa vitesh kanë ngritur iniciativë që kjo shumë të trefishohet.

Ndërkaq, për rëndësinë e madhe që ka tregtia online flet edhe fakti se në Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë shpenzuar 223 miliardë dollarë për blerje përmes internetit, duke mbajtur vendin në zhvillimin e tregtisë elektronike. E gjithë kjo i atribuohet rritjes së vazhdueshme të këtij tregu, përmirësimit të ekonomisë amerikane dhe besimit më të madh të konsumatorëve amerikan në tregtinë elektronike.

## "Vizer" vjet ka transportuar 1.2 milionë udhëtarë

Shkup, 11 janar - Kompania ajrore me buxhet të ulët "Vizer" do të vendosë nëse do të marrë pjesë në thirrjen e Qeverisë së Maqedonisë për përkrahje financiare për vendosjen e linjave ajrore pasi që do të publikohen kushtet e reja për të cilat përgatitet strategji nga institucionet kompetente. Marrëveshja e "Vizer" me Qeverinë e Maqedonisë nga e cila kjo kompani ajrore merr subvencione për realizimin e fluturimeve, përfundon në qershor, ndërsa siç deklaroi dje Josef Varadi, drejtori i përgjithshëm ekzekutiv i "Vizerit" pret që bashkëpunimi të vazhdojë. Qeveria në pres konferencën e djeshme në aeroportin e Shkupit tha se "Vizer" ka 63 për qind të pjesëmarrjes në qarkullimin ajror në Maqedoni. Vjet transportuan 1,2 milionë udhëtarë nga Maqedonia, për 20 për qind më shumë në krahasim me vitin 2016. Sivjet, presin rritje të numrit të udhëtarëve për 23 për qind. Nga vitit 2011 deri në vitin 2017 "Vizer" ka transportuar gjithsej 4,1 milion udhëtarë nga Maqedonia dhe ka hapur 140 punësime direkte dhe 900 indirekte. Gjithsej ka investuar 400 milionë euro. Numri i përgjithshëm i fluturimeve në të dy aeroportet, në Shkup dhe në Ohër, vjet është rritur për shtatë për qind dhe arriti 18.130. Me paralajmërimin e linjës Ohër-Vjenë, Vizeri do të ofrojë 20 destinacione me buxhet të ulët në 14 shtete nga dy aeroportet në Maqedoni, në Shkup dhe në Ohër. Alper Ersoj, drejtori i përgjithshëm i TAV Maqedoni theksoi se si kompani ajrore me pjesëmarrje të madhe në qarkullimin ajror presin që "Vizer" të vazhdojë me zhvillimin e biznesit të tyre në tregun e Maqedonisë, me investimin e destinacioneve dhe rritjen e frekuencave të linjave ekzistuese ajrore.

KOMUNA E GOSTIVARIT DHE IPA FONDET

## Konkretizohet ndërtimi i rrugëve në Tërnovë dhe Padalisht

Gostivar, 11 janar - Kryetari i Komunës së Gostivarit Arben Taravari, i shoqëruar nga Besim Dogani-udhëheqës i Zyrës për zhvillim ekonomik lokal, dje kanë realizuar takim pune me konsulentët Edin Mehmeti dhe Aleksandar Ivanovski. Nga zyra për Informim e Komunës së Gostivarit informojnë se në takimin me konsulentët për mbikëqyrjen e projekteve të BE-së në kuadër të komponentit IPA, është biseduar në lidhje me dy projekte të rëndësishme që duhet të realizohen në Komunën e Go-



stivarit përmes EU IPA grantit, respektivisht ndërtimi i rrugëve lokale në fshatrat Padalisht dhe Tër-

novë. Me ndërtimin e këtyre rrugëve, thuhet më tej në kumtesë, synohet që në këtë pjesë të Malësisë

së Gostivarit të krijohet biznes klimë e volitshme për zhvillim të agrikulturës, bujqësisë, pylltarisë dhe cilësisë së furnizimit me ujë, si dhe zhvillimit të turizmit dhe hotelierisë rurale. Vlera e projektit për rrugët në fjalë pa TVSH është 7.314.814 denarë, në kundërvlerë 118.940 euro, ndërsa financimi tërësisht do të realizohet përmes EU IPA grantit. Nga komuna informojnë se ndërtimi i këtyre rrugëve lokale në Tërnovë dhe Padalisht, është pjesë e programit zhvillimor të Komunës së Gostivarit, të gjitha

procedurat janë përfunduar, ndërsa punimet ndërtimore do të fillojnë në pranverë të këtij viti. Gjithashtu, përfaqësuesit e ZHEL kanë informuar konsulentët se në kuadër të projektit të dytë për përmirësimin e shërbimeve komunale MSIP 2 të shpallur nga Ministria e Financave, komuna tashmë ka dorëzuar projektet "Asfaltimi i rrugëve lokale f. Forinë - Çajlë e Vjetër" dhe "Ndërtimi i rrugës lokale në fshatin Turçani i Vogël deri në f. Turçani i Madh", me vlerë 16.400.000 denarë.



REPUBLIKA E MAQEDONISË  
QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË  
Shërbimi për punë të përgjithshme dhe të përbashkëta

Nr. \_\_\_\_\_  
2018  
Shkup

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 alineja 2, paragrafi 3, paragrafi 8, paragrafi 13 dhe paragrafi 14 i Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 27/2014, 199/2014 dhe 27/2016), nenit 22, nenit 23, nenit 24, nenit 25, nenit 26 dhe nenit 27 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 62/2005, 106/2008, 161/2008, 114/2009, 130/2009, 50/2010, 52/2010, 124/2010, 47/2011, 11/2012, 39/2012, 13/2013, 25/2013, 170/2013, 187/2013, 187/2013, 113/2014, 20/2015, 33/2015, 72/2015, 195/2015 dhe 27/2016), Rregullores për sistematizim të vendeve të punës në Shërbimin për punë të përgjithshme dhe të përbashkëta të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë nr. 01-3692/2 të datës 01.06.2015, nr. 01-3692/6 të datës 29.07.2015, nr. 01-5703/4 të datës 16.09.2015, nr. 01-5703/3 të datës 17.09.2015, nr. 01-5703/5 të datës 26.10.2015, nr. 01-7007/1 të datës 09.11.2015, nr. 01-7819/1 të datës 09.12.2015, nr. 01-20/2 të datës 11.01.2016, 01-19/1 të datës 03.01.2017 dhe 01-2644/1 të datës 12.07.2017, Shërbimi për punë të përgjithshme dhe të përbashkëta të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë publikon:

#### SHPALLJE PUBLIKE NUMËR 02/2018

Për punësim të punëtorëve për shkak të kapacitetit përkohësish të rritur të punës në Shërbimin për punë të përgjithshme dhe të përbashkëta të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë

Shërbimi për punë të përgjithshme dhe të përbashkëta të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për shkak të kapacitetit përkohësish të rritur të punës, publikon shpallje publike për angazhim të 26 personave për kohë të caktuar, derisa është e nevojshme për institucionin, ndërsa më së gjati 1 vit për pozitën e punës në vijim:

- Vozitës në garazhe** në Departamentin për transport dhe mirëmbajtje të makinave – **5 realizues;**
  - Kualifikimet e nevojshme:** Arsim të mesëm, Leje të vozitjes të kategorisë B, përvojë pune prej së paku 1 vjet;
  - Neto pagesa bazë është 13.525,00 denarë;
- Vozitës të kategorisë D** në Departamentin për transport dhe mirëmbajtje të makinave – **2 realizues;**
  - Kualifikimet e nevojshme:** Arsim të mesëm, Leje të vozitjes të kategorisë D, përvojë pune prej së paku 2 vjet;
  - Neto pagesa bazë është 16.136,00 denarë;
- Kamerier** në Departamentin për shërbim në Kuvend, Qeveri, Klubin e organeve të drejtorisë, Villa në Shkup dhe objektet rezidenciale – **4 realizues;**
  - Kualifikimet e nevojshme:** Arsim të mesëm në sferën e hotelerisë, aftësi për komunikim me gojë, njohje bazike të gjuhës angleze, përvojë pune prej së paku 1 vjet;
  - Neto pagesa bazë është 13.112,00 denarë;
- Enëlarës në kuzhinë** në Departamentin për shërbim në Kuvend, Qeveri, Klubin e organeve të drejtorisë, Villa në Shkup dhe objektet rezidenciale – **2 realizues;**
  - Kualifikimet e nevojshme:** Arsim të mesëm, me ose pa përvojë pune;
  - Neto pagesa bazë është 12.011,00 denarë;
- Kafe bërës** në Departamentin për shërbim në Kuvend, Qeveri, Klubin e organeve të drejtorisë, Villa në Shkup dhe objektet rezidenciale – **2 realizues;**
  - Kualifikimet e nevojshme:** Arsim të mesëm, me ose pa përvojë pune;
  - Neto pagesa bazë është 13.112,00 denarë;

- Daktilo punëtor i KU** në Departamentin për kryerje të punëve normativo-juridike, profesionale-administrative dhe arkivore – **4 realizues;**
  - Kualifikimet e nevojshme:** Arsim të mesëm, aftësi për shtypje të tekstit shpejtë dhe pa parë në formë me shkrim, diktat dhe zbritje të fjalimit nga shiriti, të ketë njohuri për Microsoft Office – Word, përvojë pune prej së paku 1 vjet;
  - Neto pagesa bazë është 12.068,00 denarë;
- Referent i pavarur – Stenograf i debateve** në Departamentin për kryerje të punëve normativo-juridike, profesionale-administrative dhe arkivore – **2 realizues;**
  - Kualifikimet e nevojshme:** Arsim të mesëm ose të lartë, aftësi për shkrim të shpejtë me dorë dhe shënimet e pavarura t'ia diktojë operatorit, të realizojë redaktim stilistik dhe gjuhësor duke aplikuar gjuhën maqedonase, të ketë njohuri solide të Microsoft Office – Word dhe Excel, përvojë pune prej së paku 1 vjet;
  - Neto pagesa bazë është 15.681,00 denarë;
- Referent i pavarur – Arkivues** në Departamentin për kryerje të punëve normativo-juridike, profesionale-administrative dhe arkivore – **1 realizues;**
  - Kualifikimet e nevojshme:** Arsim të mesëm ose të lartë, njohuri për punë në zyrë dhe arkivore, arkivim të lëndëve sipas planeve për shenja arkivore, punë me material dokumentues dhe ndërtim arkivor, përvoja e mëhershme e punës do të logaritët si përparësi;
  - Neto pagesa bazë është 15.681,00 denarë;
- Referent i pavarur – Organizator për sigurim të instalimeve makinerike** në Departamentin për mirëmbajtje të vazhdueshme të objekteve të administratës shtetërore dhe përcjellje të shpenzimeve komunale – **1 realizues;**
  - Kualifikimet e nevojshme:** Arsim të mesëm ose të lartë nga drejtimi i makinerisë, bartje të evidencës për instalime të makinerisë, përpilim të raporteve dhe informacioneve për instalime të makinerisë, vendosje, ruajtje dhe mirëmbajtje të instalimeve të makinerisë, përvoja e mëhershme e punës do të logaritët si përparësi;
  - Neto pagesa bazë është 15.681,00 denarë;

**10. Referent i pavarur – Kontrollor i punës me denarë dhe deviza dhe përlogaritje të rrogave** në Departamentin për kontabilitet dhe pagesa – **3 realizues;**

- Kualifikimet e nevojshme:** Arsim të mesëm ose të lartë, punë në trezor, me denarë dhe deviza dhe përlogaritje të rrogave, përpilim të urdhërësive për pagesa, formësim të urdhërësive për regjistrim dhe kompletim të tyre me dokumentet e regjistruara, përvoja e mëhershme e punës do të konsiderohet si përparësi;
- Neto pagesa bazë është 15.681,00 denarë;
- Kandidatët së bashku me fletëparaqitjen për themelimit të marrëdhënies së punës duhet të parashtrojnë edhe dokumentet në vijim:
  - Fletëparaqitje të nënshkruar me dorë për vendin e punës që do të paraqiten;
  - Biografi të shkurtë (CV), me kontakt telefon dhe adresë të shënuar;
  - Certifikatë/Dëftesë për arsim të mbaruar përkatës;
  - Dëshmi për përvojën e punës të nevojshme për vendin e punës;
  - Orari i punës është 40 orë në javë, ndërsa orarin e të njëjtës mund ta përcaktojë punëdhënësi, që mund të organizohet me ndërrime, në pajtim me nevojat e procesit të punës.

Shpallja publike zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit. Fletëparaqitjet të parashtrohen deri në Shërbimin për punë të përgjithshme dhe të përbashkëta të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, bul. Kuzman Josifovski Pitu nr. 17, QT Skopjanka – Shkup, përmes arkivit të Shërbimit ose përmes postës.

Fletëparaqitjet që nuk do të parashtrohen në afatin e përcaktuar dhe fletëparaqitjet që nuk do të përmbajnë dokumentet e nevojshme do të konsiderohen si të vonuara dhe të pakompletuara dhe nuk do të shqyrtohen.

Në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët që nuk do të përmbushin kushtet.

Zgjedhja e kandidatëve të paraqitur do të realizohet në afatin e caktuar në pajtim me Ligjin për marrëdhënie pune.

Shërbimi për punë të përgjithshme dhe të përbashkëta të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 dhe neni 23 nga Ligji për marrëdhënie pune (Gazeta zyrtare e R. Maqedonisë nr. 145/2014), si dhe neni 80 dhe neni 82 paragrafi 1, paragrafi 3 dhe 4 nga Ligji për arsim fillor (Gazeta zyrtare e R. Maqedonisë nr. 103/2008) dhe me miratim nga MASH nr. 12-14411/3 nga viti 12.12.2017 SHF „Panajot Gjinovski” Butel Shkup, shpall:

#### SHPALLJE PUBLIKE

për punësim të kuadrit arsimor për vitin shkollor 2017/2018  
për kohë të caktuar deri më 31.08.2018

- Arsimtarë i grupit klasor - tre realizues, për mësim në gjuhën maqedonase me 20 orë mësimore, me neto pagesë prej 20.639,00 denarë.
- Arsimtarë i grupit klasor - dy realizues, për mësim në gjuhën shqipe me 20 orë mësimore, me neto pagesë prej 20.639,00 denarë
- Arsimtarë i gjuhës angleze- një realizues, për mësim në gjuhën maqedonase me 20 orë mësimore, me neto pagesë prej 20.639,00 denarë.
- Arsimtarë i gjuhës angleze- një realizues, për mësim në gjuhën shqipe me 9 orë mësimore, me neto pagesë prej 9.256,00 denarë
- Arsimtarë i matematikës - një realizues, për mësim në gjuhën maqedonase me 20 orë mësimore, me neto pagesë prej 20.639,00 denarë.
- Arsimtarë i matematikës - një realizues, për mësim në gjuhën shqipe me 4 orë mësimore, me neto pagesë prej 4.360,00 denarë.
- Arsimtarë i matematikës - një realizues, për mësim në gjuhën shqipe me 20 orë mësimore, me neto pagesë prej 20.639,00 denarë
- Arsimtarë i historisë - një realizues, për mësim në gjuhën shqipe me 16 orë mësimore, me neto pagesë prej 16.543,00 denarë
- Arsimtarë i fizikës - një realizues, për mësim në gjuhën shqipe me 8 orë mësimore, me neto pagesë prej 8.192,00 denarë.
- Arsimtarë i shkencave natyrore - një realizues, për mësim në gjuhën shqipe me 8 orë mësimore, me neto pagesë prej 8.192,00 denarë
- Arsimtarë i gjuhës shqipe- një realizues, me 20 orë mësimore, me neto pagesë prej 20.636,00 denarë.
- Psikolog - një realizues, për mësim në gjuhën shqipe me 40 orë mësimore, me neto pagesë prej 20.639,00 denarë
- Arsimtarë i gjuhës dhe kulturës së Boshnjakëve - një realizues, për mësim në gjuhën maqedonase me 2 orë mësimore, me neto pagesë prej 2.180,00 denarë.
- Arsimtarë i edukatës qytetare - një realizues, për mësim në gjuhën shqipe me 4 orë mësimore, me neto pagesë prej 4.360,00 denarë.
- Arsimtarë i edukatës muzikore - një realizues, për mësim në gjuhën shqipe me 8 orë mësimore, me neto pagesë prej 8.192,00 denarë

Orari i punës i kuadrit mësimor është prej ora 7:30 ndërsa përfundon sipas numrit të orëve në përputhje me programin vjetor për punë të shkollës prej të hënës deri të premten. Orari i punës është 40 orë. Punëtorit ka të drejtë në pauzë ditore prej 30 minuta. Kandidatët i kuadrove mësimore përveç kushteve të përgjithshme me Ligjin për marrëdhënie pune, duhet ti plotësojnë dhe kushtet e parapara në nenin 80 dhe 82 paragrafi 1, paragrafi 3 dhe paragrafi 4 nga Ligji për arsim fillor (Gazeta zyrtare e RM nr. 103/08), të jenë me apo pa përvojë pune. Kandidatët për kuadrit arsimor me lutjet duhet të dorëzojnë: diplomë për arsim të lartë të kryer, shtetësi dhe certifikatë për provimin profesional nëse e posedon. Dokumentet të dorëzohen origjinal apo kopje të notarizuara. Shpallja zgjat 5(pesë) ditë punë nga dita e publikimit (duke mos marr parasysh ditën e publikimit) në afat prej 30 ditësh pas skadimit të afatit për paraqitje do të bëhet përzgjedhja, Lutjet më dokumentacionin e nevojshëm të dorëzohen në SHF "Panajot Gjinovski" Butel Shkup Rr. Ferid Bajram nr. 30 prej orës 09:00 deri në ora 15:00. Dokumentacioni i pakompletuar dhe i dorëzuar pas afatit nuk do të merret parasysh. Tel. 2621-416

SHF "Panajot Gjinovski" – Butel, Shkup

Komuna Shuto Orizarë



"Градоначалник на Општина Шуто Оризари"  
„Dizakoro Serutno Komuna Suto Orizarë”,  
„Republika Makedonija - Republika Makedonija,”

Nr. 04 -34/3  
09. 01. 2018  
SHKUP

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 14, të Ligjit për Vetëqeverisje lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 5/2002"), nenit 45 paragrafi 1 pika 11 e Statutit të Komunës së Shuto Orizarës ("Fletorja zyrtare e Komunës së Shuto Orizarës" nr. 1/97), nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/2005, 106/2008, 161/2008, 114/2009, 130/2009, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 29/15, 27/2016), nenit 13 të Vendimit për organizim, detyrave të punës dhe mënyrës së realizimit të detyrave të administratës komunale të Komunës Shuto Orizarë nr. 08-1379/6 të datës 29.12.2016 ("Fletorja zyrtare e Komunës Shuto Orizarë" nr. 15/2016), në pajtim me nenin 17 pika 9 e Rregullores për sistematizim të vendeve të punës së Administratës komunale të Komunës Shuto Orizarë nr. 08-1379/6 të datës 29.12.2016, ("Fletorja zyrtare e Komunës Shuto Orizarë" nr. 15/2016), ndërsa në lidhje me nenin 1 të Vendimit për miratim të rregullores për sistematizim të vendeve të punës në Administratën komunale të Komunës Shuto Orizarë nr. 08-1379/6 të datës 29.12.2016 ("Fletorja zyrtare e Komunës Shuto Orizarë" nr. 15/2016), Komuna Shuto Orizarë më datë 09.01.2018 publikon:

#### SHPALLJE PUBLIKE

Për themelimit të marrëdhënies së punës me një realizues për kohë të pacaktuar  
- **Titulli i vendit të punës:** një (1) realizues për vendin e punës "voztës" në komunën Shuto Orizarë.

- **Kushtet që kërkohen për kryerje të punës:**

Krahas dëshmi të përgjithshme për përmbushje të kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet në vijim të parapara me Rregulloren për sistematizim dhe organizimin e vendeve të punës së Komunës Shuto Orizarë edhe atë:

#### 1. Lloji i arsimit:

- Arsim të mesëm gjimnaz ose profesional
- Me ose pa përvojë pune
- Provim të dhënë për vozitës të kategorisë B ose C

#### 2. Fillimi dhe mbarimi i orarit ditor dhe javor të punës:

Orari ditor i punës është prej ora 08 00 deri në ora 16 00, tetë (8) orë pune, gjegjësisht 40 (dyzet) orë pune në javë.

#### 3. Orari i kohës së punës: paradite

4. **Shuma në të holla e neto pagesës bazë ose shuma në të holla e shumës më të ulët ose më të lartë të neto pagesës për vendin e punës për të cilin kërkohet punëtor:**  
Neto pagesa prej 14.000,00 denarë deri në 16.000,00 denarë.

#### 5. Afati për paraqitje:

Më së voni në afat prej dhjetë ditëve të punës.

#### 6. Afati në të cilin do të realizohet zgjedhja:

Zgjedhja do të realizohet në afat prej 45/90/120 ditë pas kalimit të afatit për paraqitje varësisht nga numri i kandidatëve të paraqitur për vendin e theksuar të punës.

Të dhënat e sakta për punëdhënësin (emri, selia, telefoni, personi për kontakt dhe adresa për parashtrimin e aplikacioneve).

**Emri:** KOMUNA SHUTO ORIZARË

**Selia:** rr. "Haxhi Jovan Shishkov" pn, Fahu postal 688 Shkup

**Telefoni:** 02/ 2654-983, 070 855-296

**Personi për kontakt:** Danço Arsov

**Kontakt adresa për parashtrimin e aplikacioneve:**  
rr. "Haxhi Jovan Shishkov" pn, Fahu postal 688 Shkup

Kryetari i Komunës Shuto Orizarë  
Dudush Kurto



Komplikimi mund të ndodh për shkak se nuk është zgjedhur ende kryetari i Këshillit, ndërsa kryesuesi i seancës që ka qenë - këshilltarja më e vjetër nuk ka të drejtë të nënshkruajë Buxhetin. Situatë e këtillë mund të ndodh edhe në komunitet tjera ku nuk është zgjedhur kryetari i Këshillit

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 11 janar - Ndonëse Buxheti i Komunës së Tetovës është miratuar, megjithatë pritet që të ketë komplikime për miratim në Ministrinë e Financave. Komplikimi mund të ndodh për shkak se nuk është zgjedhur ende kryetari i Këshillit, ndërsa kryesuesi i seancës që ka qenë - këshilltarja më e vjetër nuk ka të drejtë të nënshkruajë Buxhetin. Situatë e këtillë mund të ndodh edhe në komunitet tjera ku nuk është zgjedhur kryetari i Këshillit. Kryetarja e Komunës së Tetovës thekson se kjo nuk duhet të jetë problem dhe se kanë kërkuar mendim edhe nga ana e Inspektoratit të Ministrisë së Pushtetit Lokal. "Ne kemi kërkuar paraprakisht këtë mendim dhe siç e dini - përpara mbledhjes që kemi mbajtur për

TETOVA AKOMA PA KRYETAR KËSHILLI

# BUXHETI I MIRATUAR NË LABIRINTE INSTITUCIONALE



Buxhetin, kemi kërkuar mendim nga Inspektorati për çështje lokale, dhe ai mendim tashmë është dërguar edhe në Ministrinë e Financave. Dhe ne, në bazë të atij mendimi, megjithatë është e mundur të mbahet një mbledhje dhe të sjellë vendime të plotë fuqishme Këshilli me shumicë të votave, d.m.th është i mundshëm, është legale dhe është ligjore. Për arsye se, llogaritni një mundësi që, për shembull - kryesuesi i zgjedhur i Këshillit të zëmë eventualisht ti ndodhë një aksident, të ketë ndonjë s'mundje e kështu me radhë, çka do të thotë ajo? Ajo do

të thotë se mos mbajmë mbledhje për buxhet, mos sjellim buxhet, mos sjellim vendime..., me këtë argument dhe mendimi që është dërguar nga ana e Inspektoratit na bënë të qartë se çështjen e buxhetit ne nuk e llogarisim problem", deklaroi kryetarja Tetuta Arifi. Ajo më tej nënvizon se sa i përket pushtetit lokal në aspektin e funksionimit - partitë duhet që t'i lënë politikat ditore dhe të punojnë për të mirën e qytetarëve. "Duhet sa më shpejtë të arrijmë të zgjedhim edhe kryesuesin e Këshillit. Ajo normalisht është e rëndësishme dhe besoj që tani me

fillimin e vitit, do të arrijmë ta mbyllim këtë çështje, që më lehtë dhe më me intensitet të mbajmë mbledhjet e rregullta të Këshillit. Është kohë që u është dashur partive politike, grupeve të këshilltarëve dhe unë mendoj që kjo kohë që i duhet ndoshta politikës për të arritur marrëveshje të veta, nuk duhet të paguhet nga ana e qytetarëve", deklaroi Arifi. Më tej, ajo falënderoi këshilltarët që votuan Buxhetin e Komunës së Tetovës.

"Unë edhe njëherë ju falënderohem jashtëzakonisht këshilltarëve që para vitit të ri nuk e lanë

Komunën e Tetovës pa e kryer këtë obligim. Kurse besoj se edhe gjatë këtij muaji, do të arrihet të kryhet edhe zgjedhja e kryetarit të Këshillit. Unë gjithmonë nisem nga logjika se komunitet nuk janë qeveri, komunitet nuk kanë as kapacitet, as mundësi, as poste qeveritare të mëdha për të ndarë, mendoj se ne do arrijmë që të merremi vesh", tha kryetarja e Komunës së Tetovës, Teuta Arifi. Në Tetovë ende nuk është krijuar shumica në Këshillin e komunës apo ende nuk është zgjedhur kryetari i Këshillit, megjithëse edhe pse kishte dy tentativa - të njëjtat dështuan.

Konkurset për

interpretues e autorë të shpallura nga RTVM sipas Ligjit për mbështetjen e produksioneve muzikore vendase supozohet se do të jenë të fundit, për shkak të kërkesës së Ministrisë së Kulturës për shfuqizimin e ligjit që mundëson subvencionimin e muzikës së lehtë dhe popullore. Që nga viti 2013, kur nisi subvencionimi i muzikës nga buxheti i shtetit janë financuar 321 krijime, shumica e të cilave thuajse që nuk është transmetuar në ekrane

Koha

Evis HALILI

Shkup, 11 janar - "As unë as ti", "Fati im", "Ti, më prit"... janë disa prej titujve të këngëve që do të subvencionohen nga shteti, të shpallura fituese në konkursin më të fundit

SHPALLEN FITUESIT E KONKURSIT TË RTVM

## MILIONAT E FUNDIT PËR KËNGËTARËT



të Radiotelevizionit të Maqedonisë. Në total janë 200 kompozime, mes të cilave edhe këto shqiptare, që u përzgjedhën gjatë tre konkurseve të zhvilluara vitin e kaluar, të ndara sipas disa kategorive të ndryshme. Kompozime me muzikë popullore dhe të lehtë nga emra të njohur dhe aspak të njohur për publikun, por edhe të tillë që prej vitesh nuk kanë performuar kanë qenë përzgjedhjet e bëra gjatë konkurseve për financimin e muzikës maqedonase. Në

shpalljen e publikuar nga Radiotelevizion i Maqedonisë ndër të tjera thuhet se sipas Ligjit për financimin e produksioneve të muzikës vendase të lehtë dhe popullore dhe më qëllim nxitjen e zhvillimit të muzikës RTVM çdo vit do të financojë 200 kompozime të reja. Konkurset për interpretues e autorë të shpallura nga RTVM sipas Ligjit për mbështetjen e produksioneve muzikore vendase supozohet se do të jenë të fundit, për shkak të kërkesës së Ministrisë së

Kulturës për shfuqizimin e ligjit që mundëson subvencionimin e muzikës së lehtë dhe popullore. Sipas këtij institucioni ky ligj nuk ka dhënë efekte pozitive.

"Në praktikë nuk i ka dhënë rezultatet e pritshme, para së gjithash se edhe pse për kompozimet e zgjedhura dhe produksionit e tyre ka evidencë, ato ose nuk janë emittuar fare, ose janë transmetuar shumë pak në radio dhe televizione", kanë deklaruar nga Ministria e Kulturës.

Kritikat po ashtu lidhen edhe me koston financiare të këtij projekti të qeverisë, për shembull në kategorinë Yjet artistët marrin me nga 4.500 euro, prej të cilave 1500 euro jepen për realizimin e spotit. Ligji hyri në fuqi në vitin 2014 (me afat deri në vitin 2023) dhe që atëherë nga buxheti i shtetit janë planifikuar të shpenzohen dy milionë euro. Në konkursin e tretë dhe të fundit fitues u shpallën 38 kompozime, mes të cilëve Dario Pankovski, Princ, Avni Aliji, e

të tjerë, të cilët kanë konkurruar në kategoritë - Yje, Talente, Interpretues i afirmuar, Interpretues i dalluar, Interpretues i lartë, kompozime që afirmojnë vlerat e familjes dhe shoqërisë, historinë e Maqedonisë, e të tjera. Shumat më të mëdha janë ndarë për kompozimet në kategorinë Yjet, deri në 4.500 euro. Për realizimin e këtij konkursi çdo vit mesatarisht shpenzohen mbi 500 mijë euro, ndërsa numri i kompozimeve të financuara është 321 në total me një kosto prej afro 900 mijë euro. "Duke pasur parasysh se kompozimet audio dhe video nuk kanë qenë të aksesueshme mjaftueshëm për publikun më të gjerë shtrihet çështja për justifikimin e kësaj mënyre të financimit për krijimin e kompozimeve të reja në sferën e muzikës së lehtë dhe popullore me paratë e buxhetit të shtetit", shkruhet në dokumentin e Ministrisë së Kulturës që propozon anulimin e subvencionimit të muzikës.

# Një ide e mirë gjermane për 2018-n

Nga  
YANIS VAROUFAKIS



Viti veç sa mbaroi, dhe u përshkua nga zgjedhja e një presidenti francez sipas qejfit të kancelares gjermane Angela Merkel, gjë që demonstroi se, tashmë nuk ka rëndësi se kush udhëheq në Berlin e në Paris, ose se sa shumë e pëlqejnë ata njëri-tjetrin. "Lufta e shenjtë" vazhdon, madje edhe nëse raketet me të cilat njëra palë shkatëron propozimet e tjetres mbështillen me pëlhurë diplomatike. Në zemrën e kësaj lufte franko-gjermane është përplasja mes dy R-ve: përkushtimi gjerman për të korrektesë kundër dobësisë së Francës për rishpërndarje. Zyrtarët gjermanë përhëndesin çdo propozim nga qeveria franceze duke ia llogaritur mendërisht kostot e tyre taksapaguesve gjermanë. Dhe, pas çdo kundërpropozimi të tyre, zyrtarët francezë shohin ndonjë dredhi për t'u fshehur prapa rregullave në atë mënyrë që elitat gjermane të marrin 'tortën' e tyre dhe ta hanë atë. Rrëshqitja e vazhdueshme e Evropës në stagnim e diskreditim është rrjedhoja e natyrshme e saj.

Ndoshta ngulmimi gjerman për korrektesë është i drejtë, megjithëse jo në kuptimin që zyrtarët gjermanë e kuptojnë. Unë nuk mundem, me një ndërgjegje të mirë, të mbaj anën e njëjtë me ndonjë ithtar grek, italian apo francez të rishpërndarjes nëse propozimet e tyre dhunojnë parimet e korrektesisë. Të bësh atë që është e drejtë, padyshim, që është më mirë se të bësh atë që është e gabuar, por e përshtatshme. Por, atëherë shtrohet pyetja: cila është gjëja e duhur për t'u bërë? Dhe qysh mund të pajtohem për ndonjë përgjigje, duke pasur interesa të ndryshme, dispozicione të ndryshme e poashtu edhe prapavijë të ndryshme kulturore?

Një gjë është e sigurt: në kurrë nuk do ta kuptojmë korrektesinë si duhet nëse udhëhiqemi vetëm nga 'interesat' tona. Qorrsoaku i Evropës është kryesisht shkaku i ngecjes mes dëshirave, objektivave e shqetësimeve kundërshtuese: frikërat e gjermanëve për një rend greko-latin gjithnjë do të ndjellë frikërat e Francës për një perandori gjermane, dhe anasjelltas. Por

nëse dëshirat dëmtuese çojnë në një qorrsokak, dhe dështojnë të zbulojnë rrugën e drejtë, atëherë ku qëndron çelësi i korrektesisë?

"Të gjithë duhet t'i kryejmë detyrat tona" - një replikë goxha gjermane - vetëm sa e zhvendos mosmarrëveshjen në një plan tjetër, ku ne pafundësisht debatojmë për detyrimet tona. Të gjithë të çmendurit me pushtet, në fund të fundit, besonin që po e bënin detyrën e tyre. Kështu që, pyetja që shtrohet është kjo: "Qysh mund ta dijë se cilat janë detyrat e mia?" Një përgjigje teiste është e papranueshme, marrë në konsideratë krimet monstruoze që u bënë nga fanatikët e bindur se po e përmbushnin një detyrim hyjnor. Përgjigjen më të mirë e kam gjetur në Gjermani: te Immanuel Kanti, që të jem më i saktë. Për Kantin, që kishte telashe në ridefinimin e etikës në një epokë të re të shoqërive të tregut, detyra jonë mundet dhe duhet të deduktohet nga kapaciteti ynë për

racionalitet. Jo në shijet personale, që janë të ndryshme dhe nuk ofrojnë rrugë të sigurt drejt lumturisë apo virtytit, detyrimet mund të dalin nga një mekanizëm logjik, i përbashkët për të gjithë njerëzit.

Të jesh racional nënkupton më shumë se thjesht të jesh i aftë që të vendosësh mjetet tua në mënyrë eficiente në mënyrë që t'i mbërrish qëllimet tua. Të gjitha sojet e kafshëve janë të afta që të përdorin mjetet në dispozicion për të mbërrirë qëllimet e caktuara. Por, njerëzit janë unikë, ngulmonte Kanti, sepse, për dallim nga qentë dhe macet, ne mund t'i kalojmë dëshirat tona përmes gjykimeve racionale. Ne mund të pyesim veten, "Unë e pëlqej X-in, por a duhet ta bëj?" Dhe mund të përgjigjemi, "Është detyra ime të bëj Y-in, ani që Y-i me gjasë do të më çojë në një rrjedhojë të papëlqyeshme për mua, marrë parasysh pritjet e asaj që njerëzit presin që unë të bëj". Por nëqoftëse shenja e

**Deri në 2016-n, gati të gjithë evropianët e kishin kuptuar që politikat radikale dhe reformat institucionale ishin thelbësore për të rigjallëruar projektin evropian. Reformat serioze ende pengohen nga mosmarrëveshje e zakonshme lidhur me atë se çka duhet bërë - të tillën, Presidenti i ri i Francës, Emmanuel Macron e kishte përshkruar si "lufta e shenjtë" mes elitave gjermane dhe franceze.**



një personi racional është aftësia e tij që të veprojë sipas arsyes duke e transcenduar analizën e çmim-përfitimit, qysh mundet detyra ynë racionale të deduktohet paanësisht, dhe e çliuar nga ndikimi i interesave apo paragjykimeve personale?

Kanti n'a jep një shembull të famshëm: Gjuha është ajo që n'a dallon neve nga speciet e tjera; pa të, ne jemi thjesht kafshë. Megjithëse të gënjesht shpesh shpaguhet mirë, nëse të gjithë do të gënjenim gjatë gjithë kohës, gjuha do të bëhej e papërdorshme. Njerëzit racionale, përfundon Kanti, duhet të pranojmë se e kanë për detyrim që të përmbahen nga praktika [e të gënjerit] që, nëse adaptohet nga secili menjëherëshëm, do të prishte shpikjen tonë më të çmueshme [gjuhën]. Asnjë zot nuk është i nevojshëm, e asnjë moralizim nuk kërkohet, që të demonstrojmë detyrimin tonë për të thënë të vërtetën. Një arsyetim praktik mjafton: Në një

## KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Rattkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e enjte 11 janar | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006  
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Zëvendëskryeredaktor: Emin AZEMI | Ndhimëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA  
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 221 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221  
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

botë ku të gjithë gënjejnë është ajo në të cilën racionaliteti njerëzor, që varet krejtësisht te gjuha, vdes. Kështu që, është detyra jonë racionale që të themi të vërtetën, pavarësisht përfitimeve që sjell të gënjerit.

E përdorur te shoqëritë e tregut, ideja e Kantit nxjerr konkluzione fascinuese. Reduktimet strategjike në çmime duke e kufizuar një kompetitor nga kalimi i testit të detyrave racionale [për aq gjatë sa çmimet nuk bien nën koston e përballueshme]. Në fund të fundit, duke prodhuar sasi maksimale në çmime minimale është grali i shenjtë për çdo ekonomi. Por shkurtimet strategjike të pagave në nivelet më të ulta të mundshme nuk mund të jetë racionale, sepse rezultati do të jetë një kolaps katastrofal, shkaku i zhdukjes së kërkesës së përgjithshme. Duke iu kthyer Evropës, parimet e Kantit nënkuptojnë detyrime të rëndësishme për qeveritë dhe politikën. Dhe Gjermania e Franca do të ishin përgjegjëse për braktisjen e detyrave të tyre për të mbajtur funksionale Evropën. Nëse tepricat e Gjermanisë, tash për tash që arrijnë deri në 9% të GDP-së, do të univerzalizoheshin, me çdo qeveritë e çdo shteti anëtar, sektorin privat, euroja do të shkonte në kulm, duke shkatërruar manufakturimin e mbarë Evropës. Barazisht, deficitet greko-latine do ta kthenin Evropën në një rast koshi.

Triku, dhe detyra jonë racionale është të përqafojmë politikën dhe të ndërtojmë institucione që janë konsistente me një tregti të balancuar dhe me rrjedhën financiare. Thënë ndryshe, korrektësia autentike gjermane nuk mund të arrihet pa një formë të rishpërndarjes që është e paevitueshme të përplasit me interesat e, të themi, oligarkisë franceze e greke, shumë të llastuara për të pranuar paqëndrueshmërinë e tyre.

Një kritik i kësaj ideje gjermane për të reformuar Evropën mund të pyes me shumë të drejtë se pse çdokush duhet të kryej detyrën racionale, e të mos mbetet në rrugën e tyre të interesave të ngushta? E vetmja përgjigje e zëshme është: sepse nuk ka asnjë alternativë racionale. Ose, se alternativat janë të gjitha hipokrite.

## Teatri politik rus

Nga Edward LUCAS



Rusia mban këtë vit zgjedhje e saj presidenciale. E drejtë? E gabuar. Në fakt, Kremli është duke organizuar një shfaqje elektorale, se sa një garë reale me votues të vërtetë, kandidatë të vërtetë, konkurrencë të vërtetë, dhe një dyshim të vërtetë mbi rezultatin përfundimtar.

"Shfaqja" që do të vihet në skenë, do të jetë në realiste dhe e kushtueshme, me personazhet e veshur me kostumet e përshtatshme, dhe me mjaft propagandë të prodhuar në mënyrë profesionale. Aktrimi do të jetë i shkëlqyer. Me gjasë, mund të presim disa kthesa interesante të komplotit, dhe disa ndjenja pezullimi dhe pasigurie. Skenari është gati në pjesën e tij më të madhe; vetëm se ne nuk i dimë të gjitha detajet. Rezultati përfundimtar nuk është në dyshim: kur të ulet sipari, Vladimir Putin do të fillojë një mandat tjetër si president i vendit.

Të quash këtë teatër politik makabër një poçes zgjedhor, do të thotë të degradosh fjalorin politik. Tipari më i rëndësishëm i zgjedhjeve të vërteta, është dyshimi. Në një sistem politik të lirë, ne nuk e dimë domosdoshmërisht se cilët do të jenë kandidatët në garë. Në sistemin politik të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, gara paraprake brenda dy partive të mëdha është e egër. Ne nuk e dimë më saktësi se si do të paraqiten kandidatët. Edhe kandidatët në dukje të fortë, si kryeministrja britanike Theresa Mej, mund të dalin shumë keq në zgjedhje brenda pak javësh.

Rastet dukshëm të pashpresa, si ai

i udhëheqësit të opozitës britanike të krahut të majtë, Xheremi Korbin, u bënë papritmas popullore. E fundit nga të gjitha ishte dijenia se kush do të fitojë. Ekspertët dhe sondazhet bëjnë punën e tyre, por janë votuesit ata që vendosin. Kur gjërat shkojnë keq, sikurse bëjnë në mënyrë të pashmangshme, atëherë vendosin gjykatat. Askush nuk e di paraprakisht se kush do të qeverisë. Duke përzier zgjedhje të tilla reale me ato të rremet, ne kemi në dorë një fitore të propagandës në Kremli. Një nga pikat kryesore të bisedimeve mbi Moskë, është se atje s'ka një dallim të vërtetë midis sistemeve politike të Perëndimit dhe kleptocracive autoritare sikurse është Rusia. Ne mund të kemi një PR (marrëdhënie me publikun) më të mirë për sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe liritë politike, por në fund pasuria dhe pushteti janë të zëvendësueshme.

Janë njerëzit e pasur, ata që vendosin se çfarë ndodh. Njerëzit që udhëheqin gjërat, bëhen të pasur. Çdo gjë tjetër është thjesht dekorative. Ashtu si me të gjitha propagandat, kjo përmban një element të së vërtetës. Edhe në një sistem politik të lirë dhe të mirëfilltë, zotëruesit e pasurisë dhe pushtetit kanë përparësi. Paraja dhe masa e mediave, kanë më shumë rëndësi sesa duhet. Kushdo që ka përparësinë të jetojë si qytetar i një demokracie, nuk duhet ta marrë kurrë atë si të mirëqenë. Por pandershmëria dhe papërsosmëria, nuk janë çështje. Ashtu si qeniet njerëzore që janë të papërsosura, po kështu edhe

**Një nga pikat kryesore të bisedimeve mbi Moskë, është se atje s'ka një dallim të vërtetë midis sistemeve politike të Perëndimit dhe kleptocracive autoritare sikurse është Rusia. Ne mund të kemi një PR (marrëdhënie me publikun) më të mirë për sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe liritë politike, por në fund pasuria dhe pushteti janë të zëvendësueshme**



sistemet politike. Problemi i vërtetë, është se si ju përballeni me gabimet. Këtu ndryshimi ndërmjet sistemeve politike perëndimore dhe regjimit në Rusi, është i qartë. Hilari Klinton, ndoshta garuesja më e privilegjuar që sistemi politik amerikan kishte parë në kohët moderne, e futi në ngërç fushatën e saj dhe humbi zgjedhjet.

Disa njerëz në fushatën e Donald Trump, patën lidhje të pa peshuara mirë me Rusinë. Ata ndodhen tashmë nën hetim. Angela Merkel, kancelarja dikur e patundur e Gjermanisë, gaboi në gjykimin e humorit të elektoratit të saj mbi emigracionin dhe tanimë është drejt largimit nga pushteti. Shembuj të tjerë ka me bollëk. Asnjë formulë dhe kufizim i tillë nuk vlen për Putinin dhe ndihmësit e tij. Është e vërtetë, karrierat politike ruse mund të përfundojnë papritmas; Aleksei Uljukavev, një ish-ministër i Ekonomisë, u dënua muajin e kaluar me 8 vjet burg me akuzën e korrupsionit. Por këto rënie, reflektojnë makinacionet e brendshme të politikës së Kremliut, dhe jo veprimet e një sistemi të pavarur të drejtësisë penale. Prokuroria ishte një farsë, ashtu si "rizgjedhja" e pritshme e Putinit. Teatri mund të jetë zbavitës, po aq sa edhe udhëzues. Ne duhet të ndjekim nga afër Putinin, dhe aktorët që luajnë rolin e rivalëve të tij në këtë garë, për të mësuar më shumë se si pushteti mund të ndryshojë pas skenave teatrale në Rusi. Por mos ngatëroni atë që shihni në skenë me jetën reale. (Center of European Policy Analyses)



# MË SHUMË FLITET SESA QË LUFTOHET KORRUPSIONI

Mbi 40 për qind e buxhetit të Kosovës shpenzohet përmes prokurimit publik. Korrupsioni në fushën e prokurimit publik është konsideruar se përcillet me pasoja të mëdha në minimin e investimeve ekonomike, në shërbime jo të mira lokale, në qasje dhe përkujdesjen efikase shëndetësore si dhe në kualitetin e arsimit

Luftimi i korrupsionit në Kosovë, mbetet një prej detyrave kryesore të institucioneve përkatëse. Vlerësimet për shkallën e lartë të korrupsionit, kanë ndikuar që Komisioni Evropian ta vë luftimin e kësaj dukurie në top-prioritetet e Kosovës edhe në lidhje me procesin e liberalizimit të vizave. Tenderët dhe prokurimi publik, konsiderohen si problem i vazhdueshëm në angazhimet për luftimin e korrupsionit, sidomos atij të nivelit më të lartë. Në kuadër të masave për luftimin e korrupsionit, ishte paraparë që të zbatohen disa reforma në prokurimin pu-

blik, ku ishte veçuar nevoja për zbatimin e prokurimit elektronik nga fillimi i vitit 2018, gjë që nuk ka ndodhur. Finalizimin e prokurimit elektronik e kishte kërkuar edhe ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Greg Delawie. Ai në dhjetor të vitit të kaluar në kuadër të 'Javës kundër korrupsionit', në një deklaratë për media iu kishte bërë thirrje autoriteteve në vend që deri në janar të këtij viti të finalizohet prokurimi elektronik. Nga fillimi i këtij viti, sipas një vendimi të Qeverisë së Kosovës të gjitha autoritetet kontraktuese do të përgatisin dhe do të publikojnë të gjitha njoftimet në platformën elektronike duke përfshirë të gjitha procedurat e prokurimit dhe për të gjitha vlerat. Por, në vendim thuhet se vazhdon të mbetet mundësia e dorëzimit të tenderit edhe në kopje fizike.

Safet Hoxha kryetar i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik i ka thënë Radios Evropa e Lirë se janë në prag të finalizimit të disa dokumenteve që bëjnë funksional prokurimin elektronik. "Ka disa arsye pse kanë mbetur edhe me tutje

kopjet fizike, për shkak se rezultati përfundimtar i raportit të vitit të kaluar ka treguar se në platformën elektronike vetëm 12 për qind e operatorëve kanë ofertuar në mënyrë elektronike, që nënkupton që niveli i zbatimit ka qenë tejet i ulët". "E dyta, është se jemi në një projekt me USAID-in për hartimin e politikave operacionale, një dokument që nuk ka arritur të finalizohet, si dhe jemi në përfundim të testimit të sigurisë së platformës. Ne shpresojmë që shumë shpejt do të kompletohen dokumentet dhe do të finalizohet prokurimi elektronik", thotë Hoxha. Prokurimi publik në raportet vendore dhe ndërkombëtare, ishte konsideruar si burim i korrupsionit në Kosovë. Një vlerësim i tillë ishte dhënë vazhdimisht në raportet e progresit për Kosovën të Komisionit Evropian. Luftimi i korrupsionit në fushën e prokurimit publik është edhe njëra prej kushteve në rrugën e Kosovës drejt integriteteve evropiane. Isuf Zejna, nga organizata "Demokraci Plus", në një prononcim për Radion Evropa e Lirë vlerëson se mungesa e finalizimit të prokurimit elektronik

paraqet një lajm të keq. Arsytet e mos finalizimit të kësaj platforme thotë ai, janë të pa baza.

"Prokurimi elektronik nuk e zhdokë korrupsionin në prokurimin publik, por në një masë i redukton problemet në vlerësimin e ofertave ku edhe janë problemet më të mëdha. Moszbatimi komplet i platformës së prokurimit elektronik është një gjë dëshpëruese pasi që edhe janë investuar mbi gjysmë milion euro mjete të Bankës Botërore, mjete të USAID-it dhe mjete të buxhetit të Kosovës. Por, përkundër të gjitha këtyre investimeve nuk po e funksionalizojnë", thotë Zejna. Parregullsitë e evidentuara gjatë procesit të prokurimit publik ishte vlerësuar se kanë krijuar probleme të mëdha edhe në zhvillimin ekonomik të vendit. Mbi 40 për qind e buxhetit të Kosovës shpenzohet përmes prokurimit publik. Korrupsioni në fushën e prokurimit publik është konsideruar se përcillet me pasoja të mëdha në minimin e investimeve ekonomike, në shërbime jo të mira lokale, në qasje dhe përkujdesjen efikase shëndetësore si dhe në kualitetin e arsimit.



## Dikoviq i padëshiruar në Amerikë

Ministri i Mbrojtjes Aleksanadar Vulin ka thënë se ai nuk e kupton se pse Ambasada e SHBA-së në Beograd ka refuzuar t'i japë vizën komandantit të përgjithshëm të Ushtrisë së Serbisë, Ljubisha Dikoviq, për të shkuar në konferencën e Shefave të luftës kundër organizatave të dhunshme ekstremiste. Vulin tha se Dikoviq është trim dhe i nderuar dhe se ushtria serbe është krenar me të dhe se asgjë në rrugën e tij të luftës dhe jetës nuk mund të jetë arsye që ai nuk ka marrë vizën për të udhëtuar në SHBA. Duhet shtuar se telegrafi serb ka publikuar sot disa emra që cilësohen si lista sekrete të cilët nuk mund të udhëtojnë në Amerikë, pasi shihen si njerëz të padëshiruar. Ndër ta ishte edhe emri i Dikoviq, Sheshel dhe këngëtares së njohur serbe, Ceca.

## Serbia nuk do ta njohë kurrë Kosovën



Milovan Drecun, kryetari i Komisionit Parlamentar për Kosovë ka thënë se presidenti i Serbisë, Aleksandar Vučić është i paluajtshëm ndaj qëndrimit të tij për Kosovën. Ai thotë se Serbia kurrë nuk do ta njohë pavarësinë e Kosovës, e këtë e sipas Drecun, Vučić e ka thënë në shumë takime para zyrtarëve të huaj, bile këtë nuk do ta bëjë edhe në qoftë se kjo do t'i kushtojë me anëtarësim në BE. "Unë kam qenë i pranishëm kur presidenti Vučić në bisedime me delegacionet e huaja dhe takime tjera është shprehur i vazhdimisht i bindur ndaj zyrtarëve të huaj që Serbia kurrë nuk do të njohë pavarësinë e vetë-shpallur të Kosovës, madje as me koston e anëtarësimin në BE", është shprehur Drecun për N1. Është thënë nga zyrtarët e BE-së, ata të Kosovës por edhe nga disa serbë se marrëveshja përfundimtare për të përmbyllur fazën finale të dialogut Kosovë-Serbi do të jetë ajo me njohje reciproke. Gjithashtu, është thënë se Serbia do të ketë kusht njohjen e Kosovës, për anëtarësim në BE.

## Kurti pa kundërkandidat, vazhdojnë dorëheqjet


Albin Kurti ka mbetur kandidati i vetëm në garë për kryetar të lëvizjes "Vetëvendosje", pasi asnjë anëtar tjetër nuk është paraqitur si kundërkandidat për këtë pozitë. Dje është mbyllur afati zyrtar për paraqitjen e kandidatëve. Adnan Rustemi, nga Komisioni për Zgjedhjen e Kreut të Lëvizjes "Vetëvendosje", një ditë më parë ka konfirmuar për "Zërin" se Kurti është i vetmi kandidat për kryetar dhe hapat tjerë të zgjedhjeve të brendshme do të bëhen publikë javën e ardhshme. Se Kurti është i vetmi që ka kandiduar për kryetar të partisë e ka bërë të ditur edhe i pari i Prishtinës, Shpend Ahmeti. "Po përfundon afati për kandidatu-



ra, nuk ka të tjera përveç Albin Kurtit", ka thënë Ahmeti. Lëvizja "Vetëvendosje" ende nuk e ka bërë të ditur datën se kur do të hapet votimi për Kurtin. Derisa nuk ka ndonjë kandidat tjetër për kryetar, anëtarët e kësaj partie do të votojnë vetëm pro ose kundër tij. Sipas Sta-

tutit dhe Rregulloreve në fuqi të Komisionit Zgjedhor të Përgjithshëm (KZP) të Lëvizjes, kandidatët për kryetar duhet të grumbullojnë së paku 1/5-n e nënshkrimeve të anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm ose 5% të nënshkrimeve të anëtarësisë për ta zyrtarizuar kan-

didaturën e tyre, shkruan tutje "Zëri". Ndonëse Kurti është i vetmi kandidat, anëtarët e kësaj partie ende nuk e dinë se kur do të fillojë fushata dhe votimi për të, ndonëse kanë paralajmëruar se kjo do të bëhet pas ditës së sotme. Ndërsa edhe Albin Kurti pritet që ditëve në vijim ta paraqesë platformën për kryetar. Disa anëtarë brenda "Vetëvendosjes" kanë paralajmëruar se e mbështesin Kurtin si kryetar të partisë. Në anën tjetër, dorëheqjet e njëpasnjëshme kanë shtyrë që dje të mbahet edhe mbledhja e Kryesisë së "Vetëvendosjes". Albulena Haxhiu është kthyer në parti, ndërsa Driton Çuashi ka dhënë dorëheqje



Në fakt firmat e SHBA duan ta përzënë Rusinë nga tregu evropian i gazit natyror. Por tani është bërë e ditur se gaz i lëngshëm rus është shitur drejtpërdrejt në SHBA. Si shpjgohet kjo?

# A DO TË SHESË RUSIA GAZ NË SHBA?

Rusia është eksportuesja më e madhe në botë e gazit natyror. Për dekada të tëra Moska ka qenë e varur nga gazsjellësit, të cilët e dërgonin gazin natyror që nga fushat e gazit në veri të vendit apo në Siberi për në Evropën Perëndimore. Një pjesë të madhe të biznesit Gazpromi vazhdon ta bëjë edhe më tej përmes këtyre gazsjellësve. Por për tubacionet e gazit ka shpesh grindje, sepse ato gjithmonë kalojnë në disa vende. Prandaj Kremli përpigjet që ta zvogëlojë këtë varësi. Dhe fokusohet - si edhe eksportues të tjerë të gazit - tek gaz i lëngshëm. Në mënyrë të veçantë këtu është angazhuar prodhuesi i dytë i gazit të Rusisë, Novatek. Drejtori ekzekutiv i tij, Leonid Michelson,

konsiderohet si njeriu më i pasur i Rusisë.

## VALA E TË FTOHTIT SI SHKAK?

Novateku ka disa vite që ka zhvilluar në gadishullin polar Jamal një sistem gjigand ekstraktimi të gazit të lëngshëm. Kjo sipërmarrje kontrollon atje 60 përqind të aksioneve. Por pjesë e lojës është edhe koncerni francez i naftës Total si dhe investitorë kinezë. Vëmendjen e tërhoqi këto ditë rrethana që gaz i lëngshëm nga Jamali është eksportuar përmes një tregtari francez për herë të parë në SHBA. Pikërisht në SHBA! Uashingtoni nuk lë gjë pa bërë për t'ia vështirësuar Rusisë eksportin e gazit në Evropë. Po tani është ai vetë që blen gaz nga Rusia? Por kjo

rrethanë është më pak spektakulare se ç'duket në vështrim të parë. Fakt është që vala e të ftohtit në SHBA sa të hapësh e të mbyllësh sytë i ka ngritur shumë çmimet e energjisë në SHBA. Për shkak të kësaj kapriçoje të motit papritur SHBA ka nevojë për gaz të lëngshëm dhe e blen këtë në tregun botëror. "Këtu nuk ka asgjë politike", shpjegon Svyatoslav Bikh nga Analytical Center for the Government of the Russian Federation, një qendër kërkimore në Moskë.

## KONSUMATORËT MUND TË PËRFITOJNË

Zakonisht për Rusinë dhe shtete të tjera është e vështirë që të eksportojnë në SHBA. "Çmimet atje janë të ulëta, sepse ame-

rikanët kanë vetë boll gaz natyror", thotë Bikh.

Ndoshta edhe në të ardhmen amerikanët do të marrin ndonjë anije-cisternë me gaz të lëngshëm nga Rusia. Por do të bëhet fjalë gjithmonë për sasi krahasimisht të vogla, besojnë ekspertët në Moskë. Shumë më interesante është rrethana se si po ndryshon në të gjithë botën biznesi i energjisë: në një kohë që transporti i gazit përmes tubacioneve ka ndikuar që tregtia të bëhet gjithmonë rajonale, cisternat me gaz të lëngshëm bëjnë që edhe ky biznes të globalizohet gjithnjë e më shumë. Lufta e konkurrencës po ashpësohet. Konsumatorin kjo do ta gëzojë, sepse do t'i mbajë të ulëta çmimet.



## Asnjëherë nuk do ta lëmë Palestinën vetëm

Ministri i Jashtëm i Turqisë, Mevlut Cavusoglu deklaroi se Turqia deri më sot nuk i ka lënë vetëm asnjëherë vëllezërit palestinezë. "Ne Palestinën nuk do ta lëmë vetëm asnjëherë në çështjen e ndihmave humanitare, projekteve të zhvillimit, gjithashtu as edhe në çështjen e politikës", tha Cavusoglu, i cili ishte ftuar në panelin editorial të Anadolu Agency (AA). Në lidhje me kërcënimet e SHBA-ve për ndërprerjen e ndihmave ndaj Palestinës, ministri Cavusoglu tha: "Le të themi që SHBA i ndërpreu ndihmat për Palestinën. Por, ne për çfarë jemi duke qëndruar? Shpresoj që edhe vendet e tjera muslimane të tregojnë të njëjtën ndjeshmëri. Ambasadorët e vendeve që shkuan për pushime për t'i shpëtuar presionit në votimin e Kudsit prej tani e tutje shpresoj se do të jenë më të ndjeshëm për ndihmën ndaj Kudsit, Palestinës dhe Gazës". Shefi i diplomacisë turke është pyetur për qëndrimin e Turqisë e cila ka kundërshtuar ndërhyrjet e jashtme në protestat e nisura më 28 dhjetor 2017 dhe të cilat vazhduan për rreth një javë në Iran, ndikimin në afrimin midis Ankarasë dhe Teheranit si dhe fakti nëse do të ketë apo jo një bashkëpunim më të ngushtë mes dy vendeve. Në lidhje me këtë Cavusoglu ka thënë se mes Turqisë dhe Iranit herë pas here ka patur ndarje pikëpamjesh në disa çështje por në çështjen e Sirisë me proceset në Astana dhe Moskë është formuar një bashkëpunim mes dy vendeve.

## Marrëveshja bërthamore me Iranin po funksionon



Shefja e politikës së jashtme të Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, u bëri thirrje të gjitha palëve të vazhdojnë të respektojnë marrëveshjen bërthamore midis Iranit dhe gjashtë fuqive botërore, duke thënë se ajo "po funksionon". Mogherini i bëri këto komente në Bruksel, një ditë para se të kalojë afati për presidentin amerikan, Donald Trump, që të deklarojë nëse do ta vazhdojë mbështetjen për këtë marrëve-

shje ose jo. Duke folur pas bisedimeve me ministrin e Jashtëm të Iranit, Mohammad Javad Zarif, si dhe me ministrat e Jashtëm të Francës, Gjermanisë dhe Britanisë, Mogherini tha se marrëveshja bërthamore "po përmbush qëllimin kryesor" për të parandaluar Iranin nga zhvillimi i armëve bërthamore.

"Bashkimi Evropian mbetet i përkushtuar në mbështetjen e zbatimit të plotë dhe efektiv të

marrëveshjes", tha Mogherini. Marrëveshja kërkon nga Irani të frenojë aktivitetet bërthamore në këmbim të lehtësimit të sanksioneve ndërkombëtare. Shtëpia e Bardhë ka lënë të kuptohet se mund të tërhiqet nga marrëveshja e vitit 2015, duke e akuzuar Iranin për moszbatim të saj. Irani ka paralajmëruar të mërkurën se do të tërhiqet nga marrëveshja, nëse edhe SHBA e bën një gjë të tillë.

SHPALLJE numër 1/2018  
PËR SHITJE TË PRONËS SË PATUNDSHME  
Përmes ankandit publik me gojë

1. **Lëndë e shitjes:**  
Pronë e patundshme e shënuar në Listën pronësore nr. 1156 për KK Qendër 2 PK nr. 1163 me sipërfaqe të përgjithshme prej 485m<sup>2</sup> dhe truall nën dhe përreth ndërtesës me sipërfaqe të përgjithshme prej 350 m<sup>2</sup>, edhe atë:

Nr.r	Sipërfaqja
1	130 m <sup>2</sup>
2	145 m <sup>2</sup>
3	75 m <sup>2</sup>
4	47 m <sup>2</sup>
5	69 m <sup>2</sup>
6	26 m <sup>2</sup>
7	80 m <sup>2</sup>
8	18 m <sup>2</sup>
9	114 m <sup>2</sup>
10	20 m <sup>2</sup>
11	101 m <sup>2</sup>
12	10 m <sup>2</sup>

- Prona e patundshme shitet si tërësi.
2. **Çmimi fillestar:**  
Prona e patundshme shitet me çmimi fillestar prej 17.076.829,00 denarë.
3. **Të drejtë për pjesëmarrje në ankandin publik me gojë:**  
Të drejtë për pjesëmarrje në ankandin publik me gojë kanë të gjitha subjektet e interesuara të vendit dhe të huaja që mund të kenë të drejtë pronësie në territorin e Republikës së Maqedonisë në pajtim me ligjin dhe të cilët përmbushin kushtet në pajtim me këtë shpallje për shitje.
4. **Afati dhe mënyra e parashtrimit të fletëparaqitjes për pjesëmarrje në ankandin publik me gojë:**  
Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve është 15 ditë kalendrike duke konsideruar prej ditës së ardhshme të ditës së publikimit të shpalljes për shitje të pronës së patundshme.  
Fletëparaqitja për pjesëmarrje në shpallje numër 1/2018 për shitje të pronës së patundshme mund të merret nga arkiva e Bankës së Maqedonisë për mbështetje dhe zhvillim SHA Shkup ose nga ueb faqja e BMMZH, [www.mbdp.com.mk](http://www.mbdp.com.mk)  
Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e plotë për përmbushje të kushteve për pjesëmarrje në ankandin publik me gojë duhet të parashtrohet më së voni 15 ditë kalendrike duke konsideruar nga dita e ardhshme e ditës së publikimit të shpalljes.
5. **Kushtet për pjesëmarrje në ankandin publik me gojë:**  
Dëshmi për garanci të paguar për pjesëmarrje në ankandin publik.
6. **Garancia për pjesëmarrje në ankandin publik:**  
Garancia për pjesëmarrje në ankandin publik është 10% e çmimit fillestar të pronës së patundshme.  
Garancia për pjesëmarrje në ankandin publik me gojë paguhet në llogarinë 10000000035062, deponent Banka popullore e Republikës së Maqedonisë, me shenjë "garanci për pjesëmarrje në ankandin publik me gojë" (është e domosdoshme të shënohet numri i shpalljes).  
Parashtruesve të fletëparaqitjeve të vonuara, të paplotësuar dhe jo të rregulluara dhe ofertuesve që nuk janë zgjedhur në ankandin publik do tu kthehet garancia në afat prej 15 ditëve nga dita e mbajtjes së ankandit publik me gojë, përveç ofertuesit, i cili a ofruar çmimin më të lartë, të cilit shuma e garancisë do t'i përlogarit në çmimin e përgjithshëm të shitjes.  
Afati për pagesën e garancisë për pjesëmarrje në ankandin publik është më së voni 3 ditë para ditës së mbajtjes së ankandit publik me gojë.
7. **Koha e fillimit dhe mbajtjes së ankandit publik me gojë:**  
Ankandi publik me gojë do të mbahet më datë 30.01.2018 në lokalet e Bankës së Maqedonisë për mbështetje dhe zhvillim, në rr. "Dimitrie Çupovski" nr. 26, 1000 Shkup me fillim në ora 11:00.
8. **Ankandi publik me gojë:**  
Ankandi publik me gojë fillon me shpalljen e çmimit fillestar të shitjes së pronës së patundshme.  
Secili ofertues para ankandit publik me gojë duhet të ketë me vete dëshmi për pagesë të garancisë për ankandin publik me gojë, dokument për identifikim personal, certifikatë për aftësi afariste për subjektet fizike dhe autorizime të vërtetuara për përfaqësuesit e subjekteve juridike.  
Ankandi realizohet "hap pas hapi" me rritjen e çmimit gjatë çdo hapi për 1% nga çmimi fillestar i pronës së patundshme.  
Pjesëmarrësi në ankand, i cili ka ofruar çmimin më të lartë merr statusin ofertues më i volitshëm.
9. **Obligimi i ofertuesit më të volitshëm për pagesë të mjeteve:**  
Ofertuesi më i volitshëm është i obliguar që të paguajë mjetet në afat prej 15 ditëve nga dita e mbajtjes së ankandit publik me gojë.  
Nëse ofertuesi më i volitshëm nuk do të paguajë mjetet në afatin e caktuar, do të konsiderohet se pronë e patundshme nuk është e shitur dhe garancia për pjesëmarrje në ankandin publik nuk do t'i kthehet ofertuesit më të volitshëm.  
Ofertuesi më i volitshëm obligohet të paguajë tatimin e qarkullimit që do të dalë si obligim pas marrëveshjes për shitblerje të pronës së patundshme.  
Shpenzimet për transferimin e pronësisë, procedurës noteriale, shënimin e pronës së patundshme në Agjencinë për kadastrë të patundshmeve dhe shpenzimet tjera eventuale bien në barrë të ofertuesit më të volitshëm.

SHPALLJE numër 2/2018  
PËR SHITJE TË PRONËS SË TUNDSHME  
Përmes ankandit publik me gojë

1. **Lëndë e shitjes:**  
Pronë e tundshme – automjet në gjendje jo të rregullt me karakteristikë në vijim:

1. Marka: Citroën
2. Tip/model: DXFCX-C5
3. Tabelat e regjistrimit: SK-642-NM
4. Numri i shasisë: VF7DCXFX76490125
5. Numri i motorit: XFX-10FJ3X0166307
6. Viti i prodhimit: 2004
7. Fuqia e motorit: 103KW
8. Vëllimi punues i motorit: 2946 cm<sup>3</sup> dhe
9. Ngjyra e karrocierisë: црна

Prona e tundshme shitet sipas parimit e parë-e blerë. Për të parë pronën e tundshme të interesuarit mund të drejtohen në numrin e telefonit 02/3115-844.

2. **Çmimi fillestar:**  
Prona e tundshme shitet në tërësi me çmimi fillestar që paraqet shumë të vlerësuar dhe është 40.300,00 denarë
3. **Të drejtë për pjesëmarrje në ankandin publik me gojë:**  
Të gjitha subjektet e afta afariste fizike dhe juridike që kanë bërë pagesën e garancisë.
4. **Afati dhe mënyra e parashtrimit të fletëparaqitjes për pjesëmarrje në ankandin publik me gojë:**  
Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve është 15 ditë kalendrike duke konsideruar prej ditës së ardhshme të ditës së publikimit të shpalljes për shitje të pronës së patundshme.  
Fletëparaqitja për pjesëmarrje në shpallje numër 2/2018 për shitje të pronës së patundshme mund të merret nga arkiva e Bankës së Maqedonisë për mbështetje dhe zhvillim SHA Shkup ose nga ueb faqja e BMMZH, [www.mbdp.com.mk](http://www.mbdp.com.mk)  
Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e plotë për përmbushje të kushteve për pjesëmarrje në ankandin publik me gojë duhet të parashtrohet më së voni 15 ditë kalendrike duke konsideruar nga dita e ardhshme e ditës së publikimit të shpalljes.
5. **Kushtet për pjesëmarrje në ankandin publik me gojë:**  
Dëshmi për garanci të paguar për pjesëmarrje në ankandin publik.
6. **Garancia për pjesëmarrje në ankandin publik:**  
Garancia për pjesëmarrje në ankandin publik është 10% e çmimit fillestar të pronës së tundshme.  
Garancia për pjesëmarrje në ankandin publik me gojë paguhet në llogarinë 10000000035062, deponent Banka popullore e Republikës së Maqedonisë, me shenjë "garanci për pjesëmarrje në ankandin publik me gojë" (është e domosdoshme të shënohet numri i shpalljes)  
Parashtruesve të fletëparaqitjeve të vonuara, të paplotësuar dhe jo të rregulluara dhe ofertuesve që nuk janë zgjedhur në ankandin publik do tu kthehet garancia në afat prej 15 ditëve nga dita e mbajtjes së ankandit publik me gojë, përveç ofertuesit, i cili a ofruar çmimin më të lartë, të cilit shuma e garancisë do t'i përlogarit në çmimin e përgjithshëm të shitjes.
7. **Koha e fillimit dhe mbajtjes së ankandit publik me gojë:**  
Ankandi publik me gojë do të mbahet më datë 31.01.2018 në lokalet e Bankës së Maqedonisë për mbështetje dhe zhvillim, në rr. "Dimitrie Çupovski" nr. 26, 1000 Shkup me fillim në ora 11:00.
8. **Ankandi publik me gojë:**  
Ankandi publik me gojë fillon me shpalljen e çmimit fillestar të shitjes së pronës së tundshme.  
Secili ofertues para ankandit publik me gojë duhet të ketë me vete dëshmi për pagesë të garancisë për ankandin publik me gojë, dokument për identifikim personal, certifikatë për aftësi afariste për subjektet fizike dhe autorizime të vërtetuara për përfaqësuesit e subjekteve juridike.  
Ankandi realizohet "hap pas hapi" me rritjen e çmimit gjatë çdo hapi për 1% nga çmimi fillestar i pronës së tundshme.  
Pjesëmarrësi në ankand, i cili ka ofruar çmimin më të lartë merr statusin ofertues më i volitshëm.
9. **Obligimi i ofertuesit më të volitshëm për pagesë të mjeteve:**  
Ofertuesi më i volitshëm është i obliguar që të paguajë mjetet në afat prej 10 ditëve nga dita e mbajtjes së ankandit publik me gojë.  
Nëse ofertuesi më i volitshëm nuk do të paguajë mjetet në afatin e caktuar, do të konsiderohet se pronë e tundshme nuk është e shitur dhe garancia për pjesëmarrje në ankandin publik nuk do t'i kthehet ofertuesit më të volitshëm.  
Ofertuesi më i volitshëm obligohet të paguajë tatimin e qarkullimit që do të dalë si obligim pas marrëveshjes për shitblerje të pronës së tundshme.  
Shpenzimet për transferimin e pronësisë, procedurës noteriale dhe shpenzimet tjera eventuale bien në barrë të ofertuesit më të volitshëm.

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune, nenit 59 të Ligjit për arsim të mesëm (Gazeta zyrtare e RM nr.167/2015), neni 59 dhe 60 të Ligjit për arsim të mesëm (Gazeta zyrtare e RM nr.44/1995 deri 67/2017), Rregulloja për sistematizimin e vendeve të punës dhe pëlqimit nr. 12-14687 të datës 11.12.2017, të marrë nga MASH-Shkup, dhe Vendimi i drejtorit të SHMPK "Dimitrija Çupovski" Veles publikon:

SHPALLJE

Për punësim për kohë të caktuar deri më 31.08.2018

1. Mësimdhënës të lëndëve profesionale të drejtimit shëndetësor me 22 orë mësimore, me fakultet të mbaruar të mjekësisë. – 1 realizues, me studime të mbaruara (në përputhje me normativin për arsim të mesëm) shkalla ALP-VII/1, orari i punës në ditë prej ora 07:30 deri në ora 13:30 apo 13:30-19:30 ora (në përputhje me orarin e orëve mësimore), paga neto bazë 21.535,00 denarë.
2. Mësimdhënës të lëndëve profesionale të drejtimit shëndetësor me 20 orë mësimore, me fakultet të mbaruar të mjekësisë, fakulteti i stomatologjisë ose fakulteti i farmacisë – 1 realizues, me studime të mbaruara (në përputhje me normativin për arsim të mesëm) shkalla ALP-VII/1, orari i punës në ditë prej ora 07:30 deri në ora 13:30 apo 13:30-19:30 ora (në përputhje me orarin e orëve mësimore), paga neto bazë 2.1535,00 denarë
3. Mësimdhënës të gjuhës angleze (si zëvendësim për drejtorin), me 21 orë mësimore, me fakultet të mbaruar filologjik – gjuhë angleze, drejtimi mësimor – 1 realizues, me studime të mbaruara (në përputhje me normativin për arsim të mesëm) shkalla ALP-VII/1, orari i punës në ditë prej ora 07:30 deri në ora 13:30 apo 13:30-19:30 ora (në përputhje me orarin e orëve mësimore), paga neto bazë 21.535,00 denarë.
4. Mësimdhënës të lëndëve profesionale të drejtimit shëndetësor me 21 orë mësimore, me fakultet të mbaruar të mjekësisë – 3 realizues, me studime të mbaruara (në përputhje me normativin për arsim të mesëm) shkalla ALP-VII/1, orari i punës në ditë prej ora 07:30 deri në ora 13:30 apo 13:30-19:30 ora (në përputhje me orarin e orëve mësimore), paga neto bazë 21.535,00 denarë.
5. Mësimdhënës të mësimin praktik për motër medicinale me 17 orë mësimore me arsim sipëror të mbaruar për motër medicinale – 1 realizues, me studime të mbaruara (në përputhje me normativin për arsim të mesëm) shkalla ALP-VII/1, orari i punës në ditë prej ora 07:30 deri në ora 13:30 apo 13:30-19:30 ora (në përputhje me orarin e orëve mësimore), paga neto bazë 18.304,00 denarë.
6. Mësimdhënës të lëndëve profesionale të drejtimit shëndetësor me 20 orë mësimore, me fakultet të mbaruar të mjekësisë – 1 realizues, me studime të mbaruara (në përputhje me normativin për arsim të mesëm) shkalla ALP-VII/1, orari i punës në ditë prej ora 07:30 deri në ora 13:30 apo 13:30-19:30 ora (në përputhje me orarin e orëve mësimore), paga neto bazë 21.535,00 denarë.  
Shpallja zgjatë 5(pesë) ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor.  
Zgjedhja do të bëhet në afat deri në 45 ditë pas skadimit të afatit për aplikim.  
Kandidatët duhet të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë, ta njohin gjuhën letrare dhe alfabetin me të cilin e mbajnë mësimin,  
**Dokumentet e nevojshme:**  
-Fletëparaqitje-CV me biografë profesionale,  
-Për vendin e punës mësimdhënës-diplomë për arsim të kryer shkalla VII/1 (original apo kopje e notarizuar),  
-Certifikatë për përgatitje pedagogjike-psikologjike dhe metodike të kryer në institucione të akredituara të arsimit të lartë,  
-Certifikatë të shtetësisë të R.Maqedonisë.  
Dokumentet jo të kompletuara nuk do të merren parasysh.

**Dokumentet të dorëzohen në adresën:** SHMPK "Dimitrija Çupovski" Veles  
rr."Bllagoj Gjorev nr.40, tel.043/232 541

Republika e Maqedonisë  
Ministria e Mjedisit Jetësor  
dhe Planifikimit Hapësinor



Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikim hapësinor të Republikës së Maqedonisë

SHPALLJE

Projekt ndryshimin e A – Lejes së integruar ekologjike  
për Minierën SASA DOOEL Makedonska Kamenica

Në përputhje me nenin 95 pika 1 të Ligjit për mjedisin jetësor (Gazeta zyrtare e RM 53/05 Бул. "Гоце Делчев" бр.18, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 187/13, 42/14, 44/15, 129/15, 1000 Скопје, Република Македонија Тел. (02) 3251 400

**Dorëzuesi i kërkesës:**  
Miniera SASA DOOEL Makedonska Kamenica  
rr.Rudarska nr. 28, 2034 Makedonska Kamenica  
Republika e Maqedonisë

**Koordinatat e lokacionit sipas sistemit koordinativ nacional:**

T-1	7626807	4663459
T-2	7626437	4663720
T-3	7625821	4664573
T-4	7625167	4664627
T-5	7624820	4665460
T-6	7624526	4665291
T-7	7624058	4665567
T-8	7623888	4666020
T-9	7623602	4666461
T-10	7624027	4666706
T-11	7623836	4667490
T-12	7624200	4667700
T-13	7624339	4667778
T-14	7624786	4666967
T-15	7625131	4666857
T-16	7625750	4665811
T-17	7625838	4665023
T-18	7626248	4664647
T-19	7626938	4663678

**Personi për kontakt:** Marija Stojanovska  
Udhëheqës i njësise për mbrojtjen e mjedisit jetësor  
e-mail: m.stojanovska@sasa.com.mk

**Instalacioni bjen nën aktivitetet nga Shtojca I**  
Pika 2.5 (a) Instalacione për prodhimin e metaleve me ngjyrë nga xehet, koncentratet ose lëndët e para minerale me procese metalurgjike, kimike ose me procese elektrolitike.  
5.6 Instalacione për menaxhimin e mbetjeve nga minierat

**Lloji i aktivitetit:**  
Gërmim dhe përpunim i 770,000 - 780,000 ton xehe / vit

Në të njëjtën kohë Projekt A-Leja e integruar ekologjike do të jetë e shpallur edhe në Ueb faqen zyrtare të Ministrisë së mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor [www.moep.gov.mk](http://www.moep.gov.mk)

Të interesuarit informata më të detajuara në lidhje me Projekt A-Lejen e integruar ekologjike do të mund të marrin në Ministrinë e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor në tel. 078426016 (e-mail s.vasileski@moep.gov.mk)

Të interesuarit në afat prej 14 ditëve që nga data e shpalljes së Projekt A-Lejes se integruar ekologjike, kanë të drejtë të parashtrorin vërejtjet dhe komentet e tyre në formë të shkruar deri te Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor, bulevardi „Goce Delçev“, nr. 18 ndërtesa e RTM (kati 10), 1000 Shkup.

**Opeli i ri**

# GRANDLAND X

- Kamerë mbresëlënëse me pamje prej 360°
- Kontrollë e avancuar IntelliGrip<sup>2</sup>
- Drita të përparme të reja LED me ndricim adaptiv.

opel.mk

\*Në dispozicion si opsionale ose në nivele më të larta të pajisjeve.  
IntelliGrip është pjesë e pakos për fuqi tërheqëse gjatë gjithë sezonit (All-Season Traction Pack) dhe nuk mund të blehet pjesërisht.

**E ARDHMJA I TAKON TË GJITHËVE**

Pamja e shfaqur e veturës është vetëm për ilustrim dhe nuk ka të bëjë me këtë promovim. Opel Southeast Europe LLC dhe tregtarët e autorizuar rezervojnë të drejtën për të ndryshuar ose tërhequr ofertën në çdo kohë dhe pa njoftim paraprak. Për më shumë informacion kontaktoni shitësit e autorizuar të Opel. Oferta vlen deri më 31.03.2018.

**Automakedonija 02 310 31 30**

**Auto CEM 044 353 330**

Në pajtim me nenin 89 paragrafi 6 i Ligjit për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 49/10, 53/11, 126/12, 15/13, 69/13, 106/13, 177/14, 25/15, 73/15, 83/15, 154/15, 11/16, 53/16, 120/16, 163/16, 74/17) dhe nenit 4 të Rregullores për kushtet më të përafërta për shënim në evidencë të Grupit lokal aksionar, procedurës për regjistrim, dokumentacion të nevojshëm dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 40/13), Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave publikon

**THIRRJE PUBLIKE NR. 01/18**

**Për shënim në evidencën e Grupit lokal aksionar (GLA)**

**I. LËNDA**  
Lëndë e kësaj Thirrje publike është parashtrimi i kërkesave për regjistrim në evidencën e Grupit lokal aksionar (në tekstin e mëtejshëm: GLA), me qëllim të nxitjes së zhvillimit lokal të mjediseve rurale, në pajtim me nenin 89 paragrafi 6 i Ligjit për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 49/10, 53/11, 126/12, 15/13, 69/13, 106/13, 177/14, 25/15, 73/15, 83/15, 154/15, 11/16, 53/16, 120/16, 163/16, 74/17) përmes masave dedikuara për mbështetje të:

- realizimit të strategjive për zhvillim lokal të mjediseve rurale,
- realizim të strategjive për zhvillim rural të njësive të vetëqeverisjes lokale me seli në mjedis rural dhe
- punës së GLA për zhvillim të mjediseve rurale dhe për përfshirje të banorëve të territorit të GLA për zhvillim të mjediseve rurale.

**II. TË DREJTË PËR PJESËMARRJE**

Të drejtë për pjesëmarrje kanë GLA-të e themeluara si shoqëri tregtare, bashkësi ose shoqata të qytetarëve ose fondacioni i themeluar për një tërësi territoriale të një ose më shumë mjedise rurale ku jetojnë jo më pak se 5.000 banorë dhe jo më shumë se 100.000 banorë.

GLA themelohet përmes:

- bashkimit të dy ose më shumë bashkësive rurale të cilat në mënyrë katastroale kufizohen mes vete,
- bashkim i dy ose më shumë komunave të cilat janë të definuara si mjedis rurale dhe në mënyrë katastroale kufizohen mes vete dhe
- partneritet publiko-privat mes komunave, subjekteve fizike dhe juridike ose shoqatave të qytetarëve me seli në rajonin e komunave.

Një subjekt nuk mund të jetë anëtar i më shumë se një GLA përveç se në rast të subjekteve që kanë, në pajtim me ligjin me të cilin janë themeluar, të regjistruara filiale me seli në territorin për të cilin është formuar GLA-ja. Shoqatat e qytetarëve për mbrojtje të mjedisit jetësor, prodhuesit bujqësor, të rinjtë dhe gratë në mjediset rurale duhet të jenë të përfaqësuar me së paku 50% në GLA-në për zhvillim të mjediseve rurale.

**III. KUSHTET MË TË PËRAFËRTA PËR REGJISTRIM NË EVIDENCËN E GLA**

- GLA-ja duhet të përmbushë kushtet në vijim që të jetë e regjistruar në Evidencën e GLA:
- të ketë formë përkatëse juridike;
  - të ketë marrëdhënie përkatëse mes anëtarëve të GLA-së;
  - të ketë përfshirje përkatëse të territorit dhe
  - të ketë Strategji të GLA për zhvillim lokal të mjediseve rurale.
  - të ketë procedura të hapura dhe transparente për sjellje të vendimeve;
  - të ketë rregulla të qarta dhe procedura për zgjedhje të anëtarëve të saj dhe të drejtat dhe obligimet e tyre;

- të ketë rregulla të qarta për respektim të qëndrimeve të të gjitha palëve të përfshira në përgatitjen e projekteve dhe sjelljen e vendimeve;
- të ketë konsultime të vazhdueshme me të gjithë anëtarët e GLA-së;
- të ketë rregulla dhe procedura të qarta për zgjedhje të personave më përkatës për realizimin e detyrave konkrete;
- të ketë mënyrë efikase për këmbim të informatave dhe vendime për të gjithë palët e interesuara për hapat e mëtejshme që do të ndërmerren;
- të ketë lajmërim të rregullt për punën dhe funksionimin e GLA-së;
- të ketë pasqyrë të rregullt të raporteve për shfrytëzimin të mjeteve financiare, parashikimeve financiare dhe pasqyrë të marrëveshjeve;
- të ketë nxitje të të punësuarve dhe anëtarëve të GLA-së për edukim dhe trajnim në sferat e nevojshme;
- të ketë identifikim të rreziqeve në sferat që do të mund të rrezikojn funksionimin e GLA-së, siç janë mjetet financiare, punësim etj;
- të ketë strategji të LGA-së për zhvillim lokal të mjediseve rurale dhe
- të ketë drejtues të trajnuar, që mund të organizojë punën e LGA-së, të koordinojë realizimin e Strategjisë së LGA-së për zhvillim lokal të mjediseve rurale, të grumbullojë ide për projekte të propozuara nga ana e palëve të interesuara nga territori i përfshirë me LGA-në, të përpilojë projekte dhe të menaxhojë me realizimin dhe financimin e tyre, të përpilojë kërkesa për pagesë të shpenzimeve dhe kontrollim të miratimit të shpenzimeve, të përgatitë material promovues për Strategjinë e LGA për zhvillim lokal të mjediseve rurale dhe inkurajon banorët lokal të marrin pjesë në definimin dhe realizimin e saj, të mbajë komunikim dhe bashkëpunim me Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave dhe institucioneve tjera dhe të kryejë detyra të tjera të besuara nga ana e LGA-së.

**IV. PROCEDURA PËR REGJISTRIM NË EVIDENCËN E LGA**

- Kërkesa për regjistrim në Evidencën e LGA përmban të dhënat në vijim:
- Titulli i subjektit (emri i LGA-së të regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë);
  - Adresa dhe selia e subjektit;
  - Numri tatimor i subjektit;
  - Veprimtaria prioritare e subjektit;
  - Numri i anëtarëve të subjektit dhe
  - Kontakt (numri i telefonit, telefaksit, postës elektronike).
- Statusi i LGA-së fitohet me regjistrimin në evidencë të LGA-së që udhëhiqet në Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave.

**V. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM**

- Për regjistrim në evidencë të LGA-së së bashku me kërkesën parashtrihet dokumentacioni në vijim:
- gjendja aktuale e LGA-së e dhënë nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë;

- vërtetim se subjektet juridike anëtare të LGA-së nuk janë në procedurë të falimentimit të dhënë nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë;
- vërtetim se subjektet juridike anëtare të LGA-së nuk janë në procedurë të likuidimit të dhënë nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë;
- akt për themelimin të LGA-së;
- statut të LGA-së;
- vendim për formim të organit drejtues të LGA-së;
- regjistër të anëtarëve dhe evidencë të anëtarëve të organeve të LGA-së;
- fotokopje të letërnjoftimit ose fotokopje të dokumentit të udhëtimit të anëtarëve të LGA-së që janë subjekte fizike;
- gjendja aktuale e anëtarëve të LGA-së që janë subjekte juridike;
- dëshmi për arsim të mbaruar të drejtësisë të LGA-së dhe
- strategjia e LGA-së për zhvillim lokal të mjediseve rurale.

**VI. AFATI PËR PARASHTRIMIN E KËRKESËS**

Afati për parashtrimin e kërkesave është 45 ditë nga dita e publikimit të thirrjes publike në gazetën ditore dhe në internet faqen zyrtare të Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave. Kërkesat të cilat nuk do të dorëzohen në afatin e paraparë nuk do të shqyrtohen.

**VII. MËNYRA E PARASHTRIMIT TË KËRKESËS**

Kërkesa nga Pjesa I e kësaj Thirrje publike parashtrihet me formular të plotësuar KËRKESË për regjistrim në evidencë të Grupit lokal aksionar (GLA), i cili parashtrihet në një kopje origjinale të vërtetuar dhe të nënshkruar nga ana e personit përgjegjës të subjektit. Kërkesa së bashku me dokumentacionin parashtrihet në zarf të mbyllur përmes postës në adresën: Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave, rr. Aminta Treti numër 2, 1000 Shkup, ose përmes parashtrimin në arkivin e ministrisë çdo ditë pune prej ora 9.00 deri në ora 15.00. Në pjesën e parme të zarfit në këndin e epërm të majtë të shënohet "për Thirrje publike 01/18 për regjistrim në evidencën e Grupit lokal aksionar (GLA)". Për kërkesat e pakompletuara deri te parashtruesi parashtrihet lajmërim me shkrim për kompletim të dokumentacionit. Parashtruesi parashtron dokumentacionin e kompletuar në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës për kompletim të dokumentacionit. Kërkesa për regjistrim në evidencën e GLA-së mund të sigurohet përmes internet faqes së ministrisë: [www.mzsv.gov.mk](http://www.mzsv.gov.mk). tel: ++ 389 2 3 144 477 lok. 113

**VI. PROCEDURA DHE MIRATIMI**  
Procedurën për regjistrimin në evidencën e LGA-së e realizon komisioni i formuar nga ana e Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave.



Nga Selam SULEJMANI

Në historinë e mediave, transmetimi në radio hap perspektiva të reja. Krijon një "fole audience", pra dëgjimin familjar dhe kolektiv mbrëmjeve në shtëpi, aty ku më vonë do të mbërrijë televizioni. Radioja e shtroi në mënyrë më të drejtpërdrejtë sesa kinemaja çështjen e relacioneve me shoqërinë dhe me shtetin, ngase në më shumë vende evropiane stacionet e transmetimit në radio, shfrytëzoheshin drejtpërsëdrejti edhe nga vetë institucionet shtetërore gjatë viteve tridhjetë. Sa i përket përmbajtjes së saj, radioja u ofron qytetarëve përvojën e dy modeleve të veçanta ose të përziera:

- modelin komercial që i jep përparësi lojërave, muzikës dhe argëtimit; dhe

- modelin edukativ që vlerëson normat e kulturës së ndritur.

Sikurse edhe shtypi në shekullin XIX, radioja, kur përparon "edicioni i lajmeve të folura" - ngrë një sistem kontrolli të informacioneve të transmetuara, që i bën ato koherente me kulturën politike të çdo vendi. Për më tepër, radios i duhej të negociojë një "modus vivendi" me shtypin e shkruar. Arbitrimet e këtyre problemeve, vareshin nga kultura dhe zgjedhjet politike të vendeve të interesuara.

#### HAPAT E PARA TË RADIOS

Në vitin 1921-1922, transmetimi në radio, nisi pak a shumë në të gjitha vendet e industrializuara. Radiodifuzioni lindi nga transformimet e teknologjisë së radio-komunikacionit dhe nga domosdoshmëria e kompanive të mëdha të materialeve radio-elektrike, që e kishin zhvilluar fuqishëm prodhimin e tyre gjatë Luftës së parë botërore, për tu kthyer në tregje civile, edhe pse disa shoqëri të mëdha, veçanërisht në SHBA, e shfaqën me vonesë interesin për radiodifuzionin. Në fillim të viteve 1920 përdorimet joprofesionale të radios u kufizuan me radio-amatorët që komunikonin ndërmjet tyre brenda caqeve të ngushta të caktuara nga ushtarakët të cilët nuk shqetësoheshin për zhvillimin e një sistemi komunikimi ndërpersonal të pakontrolluar, por megjithatë përhapnin një lloj entuziazmi dhe i jepnin një imazh shumë pozitiv teknikës së re. Në vitet e para - luftës, komunikimi me radio po shkonte drejt modelit të difuzionit. Plot vende mburreshin me emisione eksperimentale të transmetuara në radio përpara vitit 1914.

#### VEPRIMTARIA

Këtë rrugë të veprimtarisë së saj të emisioneve eksperimentale e filloi edhe Radio Televizioni i Te-

yteti i Tetovës, qendra e dytë më e madhe urbane pas Shkupit, kryeqendrës së vendit, vlerësojmë se ka nevojë që t'i kushtojë rëndësinë përkatëse edhe forcimit të medias, e cila sot vuan ditët më të vështira, sidomos media në gjuhën shqipe. Në qytetin tonë deri në fillim të viteve '90-ta, Radio Tetova, ishte e vetmja ndërmarrje radio-difuzive që e mbulonte këtë sektor të rëndësishëm, i informonte qytetarët për të gjitha zhvillimet: arsimore, sociale, kulturore, politike

toves, që nga themelimi, më 18 janar 1971. Bazuar në rolin e saj dhe ndikimin e gjerë në opinionin publik, besoj e meriton vëmendjen tonë, si njëri nga institucionet me kontribut të rëndësishëm në lëmin informativ. Qyteti i Tetovës, qendra e dytë më e madhe urbane pas Shkupit, kryeqendrës së vendit, vlerësojmë se ka nevojë që t'i kushtojë rëndësinë përkatëse edhe forcimit të medias, e cila sot vuan ditët më të vështira, sidomos media në gjuhën shqipe. Në qytetin tonë deri në fillim të viteve '90-ta, Radio Tetova, ishte e vetmja ndërmarrje radio-difuzive që e mbulonte këtë sektor të rëndësishëm, i informonte qytetarët për të gjitha zhvillimet: arsimore, sociale, kulturore, politike, etj.

Me fillimin e proceseve demokratike në vend, fatmirësisht filluan edhe iniciativat e para qytetare për të themeluar edhe të tjera media në gjuhën shqipe, dhe në këtë mënyrë do të kontribuonin fuqishëm për informimin, edukimin dhe përparimin e shoqërisë sonë në valën e tranzicionit të vështirë në Republikën e Maqedonisë. Përmes kësaj kumtese (modeste) dëshiroj që në mënyrë specifike të shpalos edhe një herë rolin e Radio

Tetovës, si medium i rëndësishëm dhe kontributin e saj në ngritjen e përgjithshme kulturore e arsimore të popullatës së këtij rajoni, i cili është i njohur për specifikat historike dhe tradicionale. Demokracia në këtë medium, pra në Radio Tetovë, arriti shumë më vonë se sa në institucionet tjera. Në vitin 1996, filluan ndryshimet e para, por jo me forcën e duhur për arsye se politika shqiptare e kishte lënë pas dore këtë medium duke e cilësuar si të panevojshëm. Gjatë veprimtarisë së saj rreth dyzetë vjeçare, programi i saj në gjuhën shqipe, maqedonase dhe turke, emetohej në rajonin e Pollogut dhe më gjerë. Skema programore dhe programi i punës, bazohej kryesisht në rregulloren ish - Këshillit Republikan për Radiodifuzion të Maqedonisë, (sot Agjencia për shërbime Mediatike Audio dhe Audivizuale), i cili për radiot e vendit rekomandonte formatin foljor - muzikor. Në strukturën programore dhe produksionit të saj, i kushtonte rëndësi:

- Programit informativ;
- Programit informativ-zbavitës; dhe
- Programit muzikor

Nga këndvështrimi i një dëgjuesi jo të vëmendshëm, Radio Tetova të krijonte përshtypjen e një radiostacioni multietnik, por historia e themelimit dhe puna e saj ndër vite, dëshmon për një diskriminim të hapur ndaj gjuhës shqipe, dhe përfaqësimit të drejtë të shqiptarëve në këtë medium. Drejtuesit e saj, që deri në vitin 1998 ishin të nacionalitetit maqedonas, propagandonin një politikë redaktuese të respektimit të principeve themelore, që kanë të bëjnë me standardet programore, siç janë e drejta për shprehje të lirë, marrja dhe përcjellja e informacioneve, kultivimi i raporteve humane dhe vlerave morale të individit, të drejtat e lëvizjes dhe shprehjes së lirë të qytetarit, pa

marrë parasysh përkatësinë nacionale, fetare, ose bindjeve politike, por në praktikë të gjithë drejtorët, pa përjashtim i zbatonin urdhrat e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të asaj kohe. Edhe ata pak gazetarë shqiptarë, rikujtojnë përvojat e tyre jo të mira, të kufizimit të të drejtave themelore të ushtrimit të punës së tyre.

Sipas tyre, drejtori dhe redaktori (i kohës), me agjendat e tyre nuk kultivonin frymën e tolerancës, respektimit të ndërsjellë të qytetarëve, duke mos qenë të hapur për të gjithë ata që kishin botëkuptim tolerant dhe qasje të sinqertë ndaj vlerave kulturore dhe tradicionale të popujve tjerë.

#### DISKRIMINIMI DHE BURGOSJA E KUADROVE SHQIPTARË

Pas vitit 1968, shqiptarët në Republikën e Maqedonisë, sidomos në pjesën perëndimore, u përballën me diferencimet politike. Ky medium ishte qendra e komitetit ekzekutiv, vendi ku pushteti përpilonte listat se cilët shqiptarë duhej të përjashtoheshin nga puna dhe cilët do të pranoheshin. Nuk bëhej fjalë vetëm për ata që do të punësoheshin në këtë medium, por edhe në vende të tjera. Jo rastësisht pushteti kishte zgjedhur Radio Tetovën, të vendosur në një lokacion, në një lagje të banuar me shqiptarë, ku qarkullojnë të gjithë njerëzit e të gjitha ka-

**Fatkeqësisht, kjo etapë e ndryshimit rrënjësor zgjati 5-6 vjet, pasi Qeveria e Republikës së Maqedonisë, përkatësisht Kuvendi, në vitin 2003, solli vendim për transformimin e 29 radiove lokale në vend, përfshirë edhe Radio Tetovën që kishte të njëjtin status. Ky vendim i dëmshëm i autoriteteve shtetërore, kërkonte nga drejtuesit e radiostacioneve lokale, që në afat kohor prej tre vjetësh të përmbyllnin procedurat e transformimit, përkatësisht të tjetërsonin statusin e tyre nga subjekt juridik shtetëror, në subjekte apo shoqata aksionare private**

tegorive. Media vazhdonte politikën diskriminuese kundër shqiptarëve, kurse pushteti bënte ekzekutimin. Jo rastësisht në asnjë arkiv të shtetit, nuk ka të dhëna për median në fjalë, për arsye të panjohura.

Nuk ka informacione, as në arkivin e radios, pasi të dhënat e pakta që kishin mbetur u zhduken nga vetë drejtuesit e këtij mediumi. Deri më sot, asnjë institucion dhe parti politike, nuk e kanë ngritur zërin për Radio Tetovën, për vendin ku kishin nisur diferencimi i shqiptarëve dhe për dëshmitë që nuk janë ruajtur as në arkivat e shtetit. Askush nuk i përmend njerëzit të cilët ishin maltretuar, përndjekur

për vite të tëra vetëm e vetëm pse kishin folur në gjuhën shqipe dhe zëri i tyre ishte dëgjuar në opinion. Ka shumë pyetje që deri më sot mbesin pa përgjigje.

Diferencimi ideo-politik, i diriguar nga qarqet më të larta të pushtetit komunist, në periudhën e viteve 1981-1990, nuk i anashkallon as gazetarët shqiptarë në Maqedoni, të cilët punonin në mjetet e ndryshme të informimit, si në gazeta dhe radio e televizione, por edhe ata që raportonin si korrespondentë nga Tetova, në radhë të parë për dy gazetat e vetme shqiptare "Flaka e Vëllazërimit" në Shkup dhe "Rilindja" në Prishtinë, sikundër edhe gazetarët lokalë në

# VEPRIMTARIA RADIODIFUZIVE E RADIO TETOVËS



Koha, e premte 12 janar, 2018

Qendrën për Informim dhe Veprimtari Botuese në Tetovë, në kuadër të së cilës vepronte Radio Tetova dhe Gazeta javore "Pollogu". Beteja kryesore e Komitetit të PK-së, ishte pikërisht në këtë media, sepse ishte zëri i vetëm shqip që dëgjohej në rajonin e Pollogut. Një media me frekuencë shumë të fuqishme që dëgjohej edhe në pjesën e Republikës së Kosovës, në kufirin e Jazhincës. Në mikrofonin e radios, ishte e ndaluar të raportohej për iniciativat, përpjekjet pluraliste politike dhe çfarëdo lloj ideje që synonte respektimin e shprehjes së lirë dhe të menduarit ndryshe, si vlera dhe parime themelore për një shoqëri të përparuar.

#### PERIUDHA E NDRYSHIMIT

Pas tri dekadave të funksionimit, të mbylljes hermetike, ose të territ informativ, pas ndryshimeve vitit 2000, mund të thuhet se Radio Tetova, njohu një evoluim, filloi të frymojë më lirshëm për të përmbushur misionin e saj në informimin objektiv të ngjarjeve të përditshmërisë, temave me interes për auditorin dhe e gjithë kjo u arrit falë ekipit të gazetarëve që punonin me përkushtim profesional, kreativitet dhe pa ngarkesa ideologjike e ndikime tjera. Krahasuar me periudhën e lartpërmendur, programi i saj nuk kishte të krahasuar, i njëjti u modernizua, si në formë ashtu edhe në përmbajtje dhe në këtë mënyrë ky stacion informativ, u rreshtua në grupin e radiove me koncept modern dhe dinamik, të pranueshëm për qytetarët dhe të gjithë dëgjuesit pa dallim. Me afriimin e kuadrove të reja, të shkolluara mire, me një politikë redaktuese të pacensuruar nga jashtë, Radio Tetova krijoi imazhin e një radiostacioni model për të ushtruar rolin edukativ-informativ, dhe rritjen e ndikimit të saj në ngritjen e vlerave kulturore të popullatës. Në aspektin informativ, ndiqte logjikën dhe rregullat e objektivitetit, kualitetit, saktësisë dhe informimit në kohë, trajtonte temat e përditshmërisë, probleme që i preokuponin qytetarët, dhe e gjithë kjo realizohej me përkushtim profesional dhe sipas parimit: gazetaria i shërben vetëm gazetarisë.

#### VENDIMI PËR TRANSFORMIM - APO VENDIMI PËR MBYLLJE

Fatkeqësisht, kjo etapë e ndryshimit rrënjësor zgjati 5-6 vjet, pasi Qeveria e Republikës së Maqedonisë, përkatësisht Kuvendi, në vitin 2003, solli vendim për transformimin e 29 radiove lokale në vend, përfshirë edhe Radio Tetovën që kishte të njëjtin status.

Ky vendim i dëmshëm i autoriteteve shtetërore, kërkonte nga drejtuesit e radiostacioneve lokale, që në afat kohor prej tre vjetësh të përmbyllnin procedurat e transformimit, përkatësisht të tjetërsonin statusin e tyre nga subjekt juridik shtetëror, në subjekte apo shoqata aksionare private. Nga procesi i transformimit të radiove lokale në Republikën e Maqedonisë, vetëm 3-4 prej tyre arritën të mbijetojnë duke u shndërruar në subjekte private, ndërsa pjesa dërmuese e tyre, u mbyllën, në këtë rast edhe Radio Tetova në prill të vitit 2009, u shua si rezultat i neglizhencës së drejtuesve, borxheve të mëdha të trashëguara, proceseve gjyqësore dhe problemeve pronësore-juridike të pasqaruara edhe sot e kësaj dite nga organet përkatëse. Kjo media me ndikim në opinionin publik, me dëgjueshmërinë më të lartë dhe shtrirjen më të gjerë gjeografike të valëve të saj, që kishte përgatitur e transmetuar qindra e mijëra raportime, lajme, kronika, reportazhe, emisione të ndryshme debative, sociale, kulturore, artistike, nuk e kishte menduar kurrë që në krye të saj do emëroheshin drejtues, me mision e vetëm për të "drejtuar" shkatërrimin e pronës së saj, asgjësimin e arkivit të edicioneve informative dhe fonotekës së pasur.



## ITALIA DHE NDERIMI I FASHIZMIT

Edhe më tepër se 70 vjet pas vdekjes së tij, Mussolini ka shumë ithtarë dhe adhurohet në Itali. Portrete të tij ose simbole të fashistëve i sheh pak a shumë hapur në etiketa shishesh vere, bluza ose si buste

Predappio është zakonisht një vend i qetë, me më pak se 6000 banorë. Evetmja gjë e veçantë e këtij qyteti rreth katër orë larg me makinë prej Romës, është se aty ka lindur diktatori italian Benito Mussolini, apo si njihet më tepër "Duçja". Në Predappio gjendet gjithashtu edhe "Muzeu i Mussolinit", ku mund të gesh thesare të vërteta të kohës së fashizmit. Në tri ditë të vitit Predappio kthehet në vend të vërtetë pelegrinazhi të ithtarëve të fashizmit - ditën e lindjes së Mussolinit, të vdekjes së tij dhe të "Marshimit në Romë". Kushdo që dëshiron mund të blejë në dyqanet e dhuratave dhe suvenireve portrete ose buste të tij, apo objekte me simbole të fashistëve. p.sh. bluza apo shishe vere me etiketa me simbole fashiste. Dhe autoritetet e lejojnë këtë lloj tregtie.

#### LOT ITHTARË

Në vendlindjen e Mussolinit, Predappio, mbahen po ashtu gjatë tri festave të mëdha fashiste edhe mesha. Dhe nuk janë vetëm njerëzit e moshuar që admirojnë Duçën. Faqja e Facebook-ut "I Giovani Fascisti Italiani" (Fashistët e rinj italianë) u pëlqen dhjetëra-mijëra vetëve! Në të mistifikohet historia e lavdishme dhe shprehet përbuzje e thellë për politikën italiane sot. Edhe përhëndetja fashiste, me krahun e djathtë të ngritur lart, shihet vazhdimisht gjatë ndeshjeve në stadiumet e futbollit. Por tani glorifikimi i fashizmit pritet të ndalohej me ligj. Për këtë arsye ajo që bashkon



shumicën e njerëzve që marrin pjesë në ceremonitë fashiste në Predappio nuk është thjesht mendësia - për shembull refuzimi i demokracisë, i liberalizmit dhe i politikës aktuale italiane. Ata duan tani edhe që të arrijnë ta ndalojnë miratimin e ligjit kundër fashizmit.

#### LIGJ PA SHUMË EFEKT

Që në vitin 1952 në Itali është miratuar një ligj që shpallte glorifikimin e fashizmit si vepër penale. Por duket shumë e qartë, se ky ligj nuk ka shumë efekt. Prandaj, eurodeputeti socialist Emanuele Fiano ka propozuar tani një ligj të ri, më të rreptë. Parlamenti tashmë e ka miratuar projektligjin, për të cilin "Forza Italia" e Berlusconi, "Lega Nord" dhe "Lëvizja Pesë Yje" votuan kundër. Tani ligji i Emanuele Fianos duhet të kalojë përmes Senatit, por koha nuk pret, sepse periudha legjislative është duke përfunduar. Ligji i ri kundër veprimtarive fashiste lidhet për Emanuele Fianon edhe me motive personale. Familja e tij hebreje u persekutua në Italinë e Mussolinit. "Unë mendoj se historia ime familjare më ka sensibilizuar në mënyrë të veçantë dhe më



shumë se të tjerët. Fashistët italianë i arrestuan paraardhësit e mi dhe ua dorëzuan ata nazistëve gjermanë. Dhjetë anëtarë të familjes sime vdiqën dhe u dogjën në Auschwitz!", thotë Emanuele Fiano.

#### TANI FJALËN E KA SENATI NË ROMË

Nëse ligji kalon edhe në Senatit atëherë kush përhëndet në publik në mënyrë fashiste - sikurse ndodh shpesh në stadiumet e futbollit - ose prodhon dhe tregton dhurata me motive përkatëse, mund të dënohet me burg nga gjashtë muaj deri në dy vjet. Nëse dikush përhap propagandë fashiste në internet ose në media, gjyqtarët mund t'i rrisin dënimet me një të tretën e tyre. Edhe kryebashkiaku i Predappios, Giorgio Frassinetti shpreson që ligji antifashist do të miratohet edhe nga Senati. "Meqë në Itali nuk ka pothuajse asnjë rishikim kritik të historisë, shumë gjëra mbeten të fshehta dhe dalin herë pas herë në sipërfaqe", thotë ai.

DOKUMENTE EKSKLUZIVE

# NJË DOKUMENT QË HEDH DRITË MBI SHOVINIZMIN MAQEDONAS NDAJ SHQIPTARËVE

Se në cilat përmasa kishte shkuar shovinizmi maqedonas asaj kohe, më së miri mund ta shohim përmes publikimit të dokumentit me titull: "Libri i Peticionit", i hartuar më 26 shkurt të vitit 1991 nga pesë bashkësitë lokale të fshatrave të komunës së Gostivarit: f. Gallat, f. Zuboc, f. Pozharan, f. Tumçevisht dhe f. Vrapçisht. Ashtu siç e thamë më sipër, edhe në këtë dokument, gjithçka konsiderohet si maqedonase, duke filluar nga toka, uji, ajri, qielli, dielli hënë, yjet etj, që "rezikohen" nga siç thuhet "përvetësimi i popullit jomaqedonas", përkatësisht nga "pakica shqiptare"



Nga Qerim LITA

Siç paralajmëruam në fillim, ky serial dokumentar maratonik, ka për qëllim zbardhjen e politikës diskriminuese të udhëheqjes maqedonase ndaj popullsisë shqiptare, i cili në fillim të viteve nëntëdhjeta të shekullit të kaluar kaloi në një shovinizëm të paparë deri në atë kohë. Të përkujtojmë, se gjatë asaj periudhe kohore u bë përpjekje maksimale, të maqedonizohen të gjitha institucionet e atëhershme shtetërore, veçmas ato informative e kulturore si për shembull RTV i Shkupit u emërtua në RTV maqedonase, Filharmonia e Maqedonisë në Filharmonia maqedonase, Opera dhe Baleti i Maqedonisë në Opera dhe Baleti maqedonas etj.. Madje jemi dëshmitar se nga disa udhëheqës të lartë të atëhershëm shtetëror të RSM-së, për shqiptarët, u shpik termi tepër ofendues "maqedonas me prejardhje shqiptare". Është për të ardhur keq, se një terminologji e tillë, u pranua aq me lehtësi nga ana e pjesës dërmuese të medimeve të atëhershme të Shqipërisë, si ato elektronike poashtu edhe të shkruara, që jo rrallë herë është prezent edhe në ditën e sotme. Se në cilat përmasa kishte shkuar shovinizmi maqedonas asaj kohe, më së miri mund ta shohim përmes publikimit të dokumentit me titull: "Libri i Peticionit", i hartuar më 26 shkurt të vitit 1991 nga pesë bashkësitë lokale të fshatrave të komunës së Gostivarit: f. Gallat, f. Zuboc, f. Pozharan, f. Tumçevisht dhe f. Vrapçisht. Ashtu siç e thamë më sipër, edhe në këtë dokument, gjithçka konsiderohet si maqedonase, duke filluar nga toka, uji, ajri, qielli, dielli hënë, yjet etj, që "rezikohen" nga siç thuhet "përvetësimi i popullit jomaqedonas", përkatësisht nga "pakica shqiptare", që sipas tyre përbën rastin e vetëm në botë "të kenë dy vende të tyre amë". Pa da-

shur të futem në një analizë të thelluar rreth përmbajtjes së tij, dëshiroj të vë në dukje se i njëjti është ndarë në tre nënkapituj: Hyrje, Qëllimi dhe Rezyme. Në këtë numër po e botojmë nënkapitullin e parë, ndërsa dy nënkapitujt tjerë do të botohen të premtën e ardhshme.

\*\*\*




"LIBRI I PETICIONIT" të nënshkrimeve të grumbulluara nga bashkësitë lokale të fshatrave: Gallatë, Zuboc, Pozharan, Tumçevisht dhe Vrapçisht, në lidhje me Kosovizimin e këtyre hapësirave të RS të Maqedonisë si dhe pezullimin e partive politike PPD-ë dhe PDP-ë.

Gostivar, 26 shkurt viti 1991  
Bashkësitë lokale  
F. Gallatë  
F. Zuboc  
F. Pozharan  
F. Tumçevisht  
F. Vrapçisht

## HYRJE

MË SHUMË SE NJË DEKADË, marrëdhëniet ndërnacionale në RSFJ-ë, me veprime pozitive e konstruktive mbi tërësinë e vendit. Filimi joserioz ishte në KSA të Kosovës, si epiqendër, me refleksë të fuqishme në mjediset tjera jugosllave. Në RSM-ë marrëdhëniet midis kombit maqedonas dhe pakicës shqiptare, kanë filluar të marrin një rrjedhë të ftohtësisë. Kjo pakicë, jo vetëm se ka të planifikuar natalitet shumë të lartë, me tendencë të qarta nationalist-përvetësuese e dominuese mbi kombin maqedonas dhe hapësirave të tij, por se ka vërshim intensiv e permanent nga KSA e Kosovës. Kjo e fundit është shprehur veçmas në dy vitet e fundit (nga pjesa e dytë e vitit 89 e 90-të) me aktivitetet për zbatimin e Kushtetutës së re e të ligjeve për një republikë të vetme të Serbisë. Shqiptarët kërkuar të ashtuquajtur azil, të fshehtë e masovik në RSM-ë, veçmas, në pjesën perëndimore të Maqedonisë ku janë më në numër dhe më të koncentruar, me një agrsivitet gjithnjë e më të madh (me natalitet të lartë të paparë deri më sot, vërshim mekanik në republikën tonë, ndërtime të egra në hapësirat të pabanuar ose

të lënë pasdore në RSM-ë). Një metodologji e tillë të nacionalistëve shqiptarë në hapësirat maqedonase, realizohet dhe ka një dinamikë shumë të shpejtë. Ata dominojnë në pjesën perëndimore të RSM-së (Tetovë, Gostivar, Dibër, Strugë e Kërçovë). Në pluralizimin politik të tanishëm në vendin tonë, pushteti ligjvënës në RSM-ë u dha liri më të madhe në veprimin dhe diferencimin politik të tyre. Me një procedim të këtyllë të politikës pluraliste në RSM-ë është bërë gabimi historik për ndarjen e hapësirës maqedonase, pushtetin dhe sovranitetin me popullin e jashtëm jomaqedonas. Pikërisht pakicës iu lejua të formoj parti politike, me qëllime të pastra nacionaliste për rrënimin në një perspektiv të integritetit të RSM-së. Historia e afërt tregoi se, shqiptarët ishin armiq të mëdhenj të kombit maqedonas me tendencë asimiluese ndaj territorit maqedonas. Krijimin e të ashtuquajturës Shqipëri e madhe, përkatësisht vendin e dytë amë të kombit të njëjtë, përbën rastin e vetëm në botë. Pakica shqiptare në RSFJ-ë e me këtë edhe në RSM-ë, është e vetmja në botë me asi të drejta e liri të pakufizuara në vendin jo të tyre. Taktikat e saj, formimi i dy partive politike PPD-ë dhe PDP-ë me pakicë të pastërt shqiptare (njënacionale) që të dyjat kanë qëllime plotësisht të njëjta, u futën në parlamentin maqedonas dhe filluan të veprojnë e do të veprojnë në mënyrë destruktive. Marrja e pushtetit në komunat nga



Maqedonia Perëndimore, me status shumëpartiak, u krijua perspektiv shumë e keqe për sovranitetin dhe integritetin territorial të hapësirës maqedonase, me pasojë të paparashikuara nga reziku për shqiptarizimin dhe çfarë jo tjetër.

Metodologjia teorike e agresive për prezencën permanente të lakmisë agresive taktizuese për pushtet, në një vend joshqiptar, na sjell deri te domosdoshmëria, për sjelljen e masave të domosdoshme për mbrojtjen e RSM-së - njëriun maqedonas, përderisa ende nuk është vonë. Populli maqedonas nuk ka qëndruar dhe nuk do të qëndroj duarkryq, reagoi në mënyra më të ndryshme (peticione, tubime e ngjashëm), por organet zyrtare maqedonase, sikur po heshtin ose janë të pafuqishme. Te secili maqedonas, paraqitet nevoja dhe ndjenja e thellë, për ta mbrojtur hapësirën e vet që pas diellit, të ngelet përjetësisht i tij, i pandarë nga askush nga jashtë (nga jomaqedonas).

Në Maqedoni mund të jetojnë edhe njerëz nga nacionalitetet tjera, mirëpo vetëm përmes obligimeve të parapara në aktet e së drejtës ndërkombëtare përkatësisht të KB-së. Këshilli ynë inciues-aksionar, dëshiron të ofroj ndihmë kah rregullimi i përhershëm i të drejtave të pakicave në RSM-ë, sidomos të, tash më të asaj më të madhe, mbi bazat të lartëtheksuara. Ky libër ka zërin, ndjenjen dhe nevojën gjithmaqedonase, si farë e parë burimore për hartimin e Kushtetutës së re maqedonase, ndërsa do të ngelet në historinë e qeverisë maqedonase.

Janar 1991, KËSHILLI INCIUES DHE AKSIONAR

(vijon të premtën e ardhshme)

FC SHKUPI NUK NDALET, SJELL DY PËRFOCIME TË REJA

# NË ÇAIR ZBARKON GOLEADORI ILIJOSKI DHE VUJÇIÇ



Gjatë ditës së djeshme skuadra e Shkupit ka njoftuar edhe dy përforcimet e reja. Stefan Vujçiç nga radhët e KF Shkëndija dhe Bazhe Ilijoski nga radhët e Pelisterit. Dy futbollist mjaft kualitativ me të cilët Shkupi sigurisht se do të jetë konkurrent i denjë i skuadrave tjera dhe pretendent për të kapur pozitën e cila qon në Liga Evropë

Shkup, 11 janar - Skuadra e Shkupit nga momenti që ka marrë sponsorin e fuqishëm, ka sjellë dhe shumë ndryshime në klub, duke aranzhuar përgatitjet dimërore në Antalia të Turqisë, pastaj nënshkroi marrëveshje me brendin sportiv italian "Kappa", por nuk ka ndenjur duarkryq edhe në sjelljen e përforcimeve në afatin kalimtar të janarit. Së fundmi klubi nga Çairi po tregon se me pronarin e ri Shefket Demiri ka ambicie që për një kohë të shkurtër të kthejë ekipin në një konkurrentë edhe për tituj. Dy prurjet e fundit në kampin bardhekalitër janë Stefan Vujçiç dhe golashënuesi më i mirë në historinë e kampionatit të Maqedonisë (130 gola), Bazhe Ilijoski. Ilijoski ka nënshkruar për 18 muajt e ardhshëm, ndërsa Vujçiç për gjashtë muaj me opsion që e njëjta të vazhdohet edhe për një vit tjetër. Ndryshe, të dy futbollistët janë të kualitetit të lartë dhe

s'ka dyshim se do të jenë përforcime të mëdha për skuadrën e trajnerit Ardian Nuhii.

Karriera e Ilijoskit është shumë e pasur, duke luajtur në arenën ndërkombëtare, ndërsa në kampionatin vendor ishte pjesë e Rabotniçkit, Metallurgut dhe Pelisterit. Sulmuesi korpulent që është makineri e golave, ka arritur që tre herë të fitojë titullin kampion me skuadrën e Rabotniçkit, ndërsa pas vete ka edhe pesë tituj fitues i Kupës së Maqedonisë, nga një me Pelisterin dhe Metalurgun dhe tre herë me Rabotniçkin. Gjithashtu ai ka fituar edhe një titull kam-

pion me ekipin tajlandez Bangkok. Derisa, Vujçiç bashkohet me Shkupin pas largimit nga skuadra e Shkëndijës. Luan në pozitën e mesfushorit dhe ka përvojë të madhe. Cekim, karrierën e tij e kishte nisur në Gjermani me

ekipin e Ligës së Tretë Holstein Kiel, që më pas të afrohet te Rabotniçki në vitin 2010, e më pas transferohet në Ligën e parë kroate te inter Zapreshiç. Nga Kroacia Vujçiç përsëri rikthehet në Maqedoni te Rabotniçki me të cilët luajtur tre vite, ndërsa së fundmi ishte pjesë e Shkëndijës. Ndërkohë, me angazhimin e Vujçiç dhe Ilijoskit, ka arritur në katër numri i përforcimeve te FC Shkupit. Kujtojmë, më herët drejtuesit e klubit arritën marrëveshje me dy futbollist cilësor, Bllagoja Lamçevski dhe Rron Broja. (B.K.)

## PREZANTOHEN BLERJET E REJA

Skuadra e FC Shkupit, sot (e premte) do të prezantoj blerjet e reja në afatin kalimtar të janarit, Bllagoja Lamçevski, Rron Broja, Stefan Vujçiç dhe Bazhe Ilijoski. Këta do të prezantohen para opinionit sportdashës në një konferencë për media në sallën e takimeve në "Marriot Hotel" në Shkup prej orës 13:30.

## Duka zyrtarizon kandidaturën për president të FSHF-së

Armand Duka kërkon mandatin e pestë në krye të Federatës Shqiptare të Futbollit. Presidenti aktual i FSHF-së, e zyrtarizoi dje rikandidimin nëpërmjet një postimi në rrjetet sociale, duke shpallur edhe objektivat për të ardhmen. Zgjedhjet për strukturat drejtuese të FSHF-së do të mbahen më 7 shkurt në Asambleenë e Përgjithshme Zgjedhore. "Ndiem jo vetëm i detyruar por mbi të gjitha i vlerësuar dhe i respektuar që një pjesë e konsiderueshme e komunitetit të futbollit dhe anëtarëve të Federatës Shqiptare të Futbollit ka kërkuar rikandidimin tim në rolin e Presidentit të këtij institucioni. Pas konsultave me faktorë të rëndësishëm dhe grupe interesi që përfaqë-


sojnë të gjitha kategoritë, moshat dhe gjinitë vendosa të rikandidoj i bindur se të gjithë bashkë përfshirë dhe ju që nuk keni të drejtë vote mund të vazhdojmë se bashku një rrugë e cila në mënyrë të pashmangshme na ka dërguar te progresi. Masivizimi i futbollit, fëmijët, të rinjtë, femrat, rezultatet e skuadrës Kombëtare me objektivin madhor për kualifikimin në EURO 2020 dhe Kupën e Botës 2022, arritjet e klubeve në arenën ndërkombëtare, politikat e futbollit dhe e ardhmja e garantuar më japin besim se sërish do vendosim për një futboll shqiptar gjithnjë e më të mirë. Që nga ky moment jam në dispozicion të të gjithë anëtarëve te Asamblesë Zgjedhore", ka shkruar Duka.



## Xhemali drejt Bolonjës

Mesfushori shqiptar, Blerim Xhemali është i gatshëm që të rikthehet te Bolonja, pas një edicioni të kaluar në ligën amerikane te Montreal Impact. Futbollisti nga Bogovina e Tetovës iu bashkua klubit kanadez në majin e vitit 2017, por ka konfirmuar që do të largohet gjatë kësaj jave. "Blerimi ka kërkuar që të rikthehet në Itali, për t'u kthyer të Bolonja, për arsye sportive dhe personale", ka deklaruar trajneri i Montreal Impact, Remi Garde. "Kështu që do të mundohemi të gjejmë zgjidhjen më të mirë. Kur një lojtar më thotë se nuk dëshiron të qëndrojë, është e vështirë për mua, edhe nëse unë mezi pres që të punoj më atë lojtar. Kështu që, ju mund të vini në përfundimin logjik se ai nuk do të kthehet", shtoi ai ndër të tjera. Të dyja skuadrat zotërohen nga i njëjti pronar Joey Saputo dhe së shpejti pritet që ai t'i nënshkruhet testeve mjekësore te klubi italian, para se të nënshkruajë kontratën për dy vjet e gjysmë.

## Belica, përforcon Partizanin



Shkup, 11 janar - Egzon Belica është lojtari më i ri i Partizanit. Mbrojtësi 27-vjeçar nga Struga, me një të kaluar te Besa e Kavajës, është bashkuar dje me ekipin në Turqi. Derisa, lajmin e kanë konfirmuar edhe drejtuesit e klubit të kuq. Largimi i Malotës dhe Krasniqit kishte lënë një boshllëk të madh në mbrojtjen e Partizanit, por drejtuesit e kuq kanë lëvizur në këtë drejtim dhe kanë sjellë në ekip përforcimin e parë për prapavijën. Belica ka luajtur në shumë kampionate, përveç atij maqedonas, por ka spikatur në Finlandë. Ai është 1.86 m i gjatë dhe me përvojën e tij pritet t'i shërbejë ekipit të trajnerit Starova në të ardhmen. Ndërkohë, te Partizani, strugani do të gjejë futbollistin shkupjan Jasir Asani.



Në bazë të nenit 22 dhe 23 ndërsa në lidhje me nenin 14 paragrafi 2 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 167/15 – teksti i pastruar), nenit 142 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve (Gazeta zyrtare e RM nr. 23/2013, 12/2014, 44/2014, 144/2014, 10/2015, 25/2015 dhe 150/2015), UD Drejtori i IPKÇF “23 Avgust” Berovë publikon:

**SHPLLJE PUBLIKE**

**Për punësim për kohë të caktuar**

**1. Përkëdhelës.....1 (një) realizues**

- Arsim të mesëm të mbaruar katërvjeçar
- Me dhe pa përvojë pune
- Licencë valide për përkëdhelës
- Orari ditor i punës: 8 orë (me shkallë prej ora 06 - 17)
- Orari javor i punës: 40 orë (prej ditës së hënë deri ditën e premte)
- Neto pagesa bazë: 14.772, 00 den.

**2. Mirëmbajtës të higjienës..... 1 (një) realizues**

- Arsim fillor
- Me dhe pa përvojë pune
- Orari ditor i punës: 8 orë (i shkallëzuar prej ora 05:30 –17:00)
- Orari javor i punës: 40 orë (prej ditës së hënë deri ditën e premte)
- Neto pagesa bazë: 12.000, 00 den.

Krahas kushteve të posaçme të lartpërmendura kandidatët duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme të parapara me Ligj dhe me fletëparaqitjen duhet të parashtrijnë:

1. të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë
2. të njeh gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik
3. të jetë i shëndosh fizikisht dhe psikikisht
4. Vërtetim se nuk i është shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit veprimtarisë ose detyrës
5. Vërtetim se nuk i është shqiptuar dënim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me çka dënohet për veprë penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdesë ose keqtrajtim të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për veprë penale të grupit të veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese.

Dokumentet e nevojshme, kandidatët duhet t'i parashtrijnë në adresën: IPKÇF “23 Avgust” – rr. Mladinski kej nr. 5, Berovë, telefoni për kontakt 033-471-039

Afat për parashtrimin e dokumenteve është 5 ditë pune duke konsideruar nga dita e publikimit të shpalljes, ndërsa zgjedhja e kandidatëve do të realizohet në afat prej 5 ditëve të punës pas kalimit të afatit për paraqitje.

Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, i pakompletuar dhe i parregulluar nuk do të merret parasysh gjatë shqyrtimit.

IPKÇF “23 Avgust” Berovë

Në bazë të nenit 20-g, ndërsa në lidhje me nenin 22 paragrafi 1 alineja 2 të Ligjit për punësim në sektorin publik (Tekst i konsoliduar), nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie të punës (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 74-teksti i pastruar) dhe Pajtimin nr. 18-14198/3 të datës 29.12.2017 nga Ministria e financave dhe nenit 12, nenit 16 paragrafi 1 dhe 2 nga Rregullorja për sistematizim të vendeve të punës në IPKÇF “Rada Poceva” – Kavadar, U.D Drejtori i IPKÇF “Rada Poceva” – Kavadar, publikon:

**SHPLLJE PUBLIKE  
PËR PUNËSIM PËR KOHË TË CAKTUAR**

**1. Një (1) person për vendin e punës përkëdhelës – ofruer të shërbimeve të nivelit të parë G për kohë të caktuar të punës,**

Krahas kushteve të përgjithshme për punësim në institucione për fëmijë të parapara me nenin 142 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve (tekst i konsoliduar dhjetor 2017),

**Kushtet e përgjithshme:**

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Të njeh gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik;
- Të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Të mos i jetë shqiptuar dënim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me çka është dënuar për veprë penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdes ose keqtrajtim të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për veprë penale të grupit të veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese

**Kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:**

- Arsim të mbaruar të mesëm katërvjeçar
- Licencë valide për përkëdhelës
- Me dhe pa përvojë pune,

Marrëdhënia e punës është për kohë të caktuar dhe është për periudhë deri më 28.02.2018  
Orari ditor i punës është i shkallëzuar prej ora 08:00 deri në ora 16:00 dhe prej ora 10:00 deri në ora 18:00 prej të cilëve 7 orë punë me fëmijë.

Neto pagesa bazë për vendin e punës: 13.000 denarë  
Shpallja zgjatë 5 ditë pune nga dita e publikimit.

Kandidatët e interesuar informata më të hollësishme mund të marrin në numrin e telefonit 043/412-097 ndërsa aplikacionet e tyre mund t'i parashtrijnë në arkivin e IPKÇF “Rada Poceva” Kavadar, në rr. “Braça Xhunovi” nr. 11 a, (çerdhja qendrore).

IPKÇF “Rada Poceva”  
UD Drejtor,  
Cana Dobrinova

Në bazë të nenit 23 alineja 1 e Ligjit për marrëdhënie pune (G. Zyrtare e RM nr. 62/05, dhe plotësim ligjit 106/08,161/08,114/09,130/09,50/10,52,10,124/10,47/11,11/12,39/12,13/13,25/13,170/13, 187/13 dhe 113/14) dhe neni 80,82 alineja 1,3 dhe neni 86 alineja 1 i ligjit për shkollla fillore G.z.RM nr. 103/08 dhe pëlqimin e Ministrisë së arsimit dhe shkencës të RM 12-14411/3 të 12.12.2017, Drejtori i shkollës fillore „Limani Kaba” f. Luboten - Butel, i shpallë të lira këto vende të punës për vitin shkollor 2017/18.

**KONKURS  
Për këto vende pune**

- |   |                |
|---|----------------|
| 1. Një arsimtar të gjuhës angleze me fond të plotë të orëve.....  | 21.118,00 den. |
| 2. Një arsimtar të edukatës muzikore me 10 orë ,dhe kor 3 orë=13 në javë.....                           | 13.400,00 den. |
| 3. Një arsim. të arsimit fig. me 12 orë, arsim teknik 6 orë dhe inovacion 2 orë=20 orë.....             | 21.118,00 den. |
| 4. Një arsimtar të gjeografisë me 16 dhe 4 orë shkenca natyrore =20 orë.....                            | 21.118,00 den. |
| 5. Një arsimtar të informatikës me 10 orë në javë.....  | 10.439,00 den. |
| 6. Një arsimtar të etikës 2 orë , 4 orë njohje të religjioneve dhe shencë natyrore 4 orë-10 orë në javë | 10.439,00 den. |
| 7. Një arsimtar të gjuhës shqipe me 16 orë në javë.....   | 16.808,00 den. |
| 8. Një arsimtar të gjuhës maqedone me 4 orë në javë.....  | 4.176,00 den.  |
| 9. Një pastruese me orar të plotë pune.....   | 12.476,00 den. |

Kandidatët duhet të ofrojnë këto dokumente:  
-Kopje të diplomës e vërtetuar në noter.  
-Certifikatë të shtetësisë.  
Konkursi është i hapur 5 ditë pune nga dita e shpalljes.

Drejtor  
Ajfer Dibrani

Në mbështetje të nenit 21 dhe 22 të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e RM. Nr. 27/2014) ,të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta zyrtare nr. 167/2015) , nenit 82 alineja 1 dhe 3 të Ligjit për shkollat fillore (G. zyrtare e RM nr: 103/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 15/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14 ,116/14,dhe 135/14) dhe Pëlqimit të Ministrisë për arsim dhe shkencë nr. 12-11042/2 të datës 07.12.2017 ,u.d drejtori i SHFK „Orhan Xhemaili,, Tatesh i Epërm publikon:

**SHPLLJE PUBLIKE**

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për vitin shkollor 2017/2018

1. Një arsimtarë për **Gjuhë gjermane** me fond jo të plotë orësh (12 orë) dhe me kohë të caktuar
2. Një arsimtarë për **Gjuhë frënge** me fond jo të plotë orësh (04 orë) dhe me kohë të caktuar
3. Një arsimtarë për **Muzikë** me fond jo të plotë orësh (08 orë) dhe me kohë të caktuar
4. Një arsimtarë për **Gjuhë angleze** me fond jo të plotë orësh (3 orë) dhe me kohë të caktuar, ky vend pune është në f. Bogovicë
5. Një arsimtarë për **Art figurativ** me fond jo të plotë orësh (08 orë) dhe me kohë të caktuar
6. Një arsimtarë për **Arsim qytetar** me fond jo të plotë orësh (4 orë) dhe me kohë të caktuar
7. Një arsimtarë për **Mësim klasor** me fond të plotë orësh dhe me kohë të caktuar në f. Misslodezhde
8. Një arsimtarë për **Shkencat natyrore** me fond jo të plotë orësh (4orë) dhe me kohë të caktuar
9. Një arsimtarë për **Gjeografi** me fond jo të plotë orësh (08 orë) dhe me kohë të caktuar
10. Një arsimtarë për **Kultura klasike dhe Civilizimin Evropian** me fond jo të plotë orësh (4 orë) dhe me kohë të caktuar

Vendet e punës të lartpërmendura janë për kohë të caktuar pune deri më 31.08.2018.

Orari i punës për arsimtarët për ndërrimin e parë është prej orës: 07:00 deri 13:00 kurse për ndërrimin e dytë prej orës 13:00 deri në orën 18:00.

Ditët e punës: prej ditës së hënë deri ditën e premte.

Rroga neto për një arsimtarë me fond të plotë orësh është 20.640 den.

Kandidatët e interesuar që do të paraqiten në konkurs duhet t'i plotësojnë kushtet konform nenit 42,77 dhe 80 të Ligjit për Arsim Fillor.

Kandidatët e interesuar së bashku me kërkesën duhet t'i kompletojnë këto dokumente:

- Diplomë për shkollimin e kryer
- Certifikatë të shtetësisë;
- Certifikata e mjekut (pas pranimit).Të interesuarit dokumentet duhet t'i dorëgojnë në lokalet e shkollës fillore “Orhan Xhemaili”, f. Tatesh i Epërm.

Dokumentet e pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Shpallja do të jetë e hapur 5 ditë pune nga dita e shpalljes në shtypin ditor.

Vendimi për zgjedhjen e kandidatëve do të merret 15 ditë pas mbarimit të shpalljes publike .

Nr. Telefoni dhe faksi i shkollës: 070 760 192

Shfk. “Orhan Xhemaili”  
F. Tatesh i Epërm  
u.d Drejtor:  
Selami Alla

Në bazë të nenit 22, 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 145/14 tekst i pastruar) i Ligjit për arsim fillor dhe pëlqimit të marrë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Shkollla fillore komunale “Sv. Kliment Ohridski” f. Drasllajca – Strugë publikon:

**SHPLLJE**

Për vendet e lira të punës për kohë të caktuar

1. Një mësimdhënës për mësimin klasor f. Moroishta deri në kthimin e mësimdhënësit – drejtorit.
2. Një mësimdhënës të gjuhës angleze deri në kthimin e mësimdhënësit nga pushimi mjekësor.
3. Një mësimdhënës të edukatës fizike dhe shëndetësore – sport i zgjedhur me 20 orë punë në javë gjegjësisht 10 orë mësimore për f. Drasllajca deri më 31.08.2018. Kandidatët nga pika 1-3 duhet të përmbushin kushtet nga Ligji për arsim fillor dhe LMP. Orari i punës është prej ora 7 deri në ora 15. Pagesa 20.640 den. për pikat 1, 2 ndërsa pagesa për pikën 3 është 10.320 den.

Dokumentet: lutje, diplomë për arsim të mbaruar, certifikatë të shtetësisë.

**Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë nga dita e publikimit. Zgjedhja do të realizohet në afat prej 45 ditëve nga data e kalimit të afatit.**

Dokumentet parashtrihen në adresën: SHFK “Sv.K. Ohridski” f. Drasllajca - Strugë.  
**SHFK “Sv. K. Ohridski”**

**SHPLLJE PUBLIKE**  
I nr. 1958/2016

Sipas nenit 46-b të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për përbarim Gazeta Zyrtare e RM nr. 8 të datës 17.01.2008 ndërsa në lidhje me nenin 265 të LP Gazeta Zyrtare e RM nr. 72/2016 të datës 12.04.2016

Përbaruesit Aleksandar Kuzmanovski nga Gostivari në bazë të kërkesës për realizim të përbarimit nga kreditori Hallk Bank SHA Shkup nga Shkupi me seli në rr. “Sv. Kiri i Metodi” nr. 54, bazuar në dokumentin për përbarim Akti noterial ODU nr. 121/2015 të datës 20.02.2015 të Noteri Përbarim Reshepi, Gostivar, kundër borxhit Ardijan Ramadan nga Gostivari me seli në f. Belovishtë dhe debitorit të pengut Qemal Ramadan nga Gostivari me seli në f. Belovishtë, për realizim të përbarimit në vlerë prej 1.216.747,00 denarë për lëndën përbaruese të regjistruar nën I nr. 1958/2016 të datës 09.01.2018:

**FTON**

1. Borxhliu Ardijan Ramadan dhe debitorin e pengut Qemal Ramadan të dy nga Gostivari me seli në f. Belovishtë, për shkak të dorëzimit të:
  - Proceverbale për shpjetë të pronës së patundshme përmes ankandit publik me gojë në bazë të nenit 175 paragrafi 3 të LP I nr. 1958/2016 të datës 19.12.2017 të Përbaruesit Aleksandar Kuzmanovski nga Gostivari
  - Konkluzion për Shpjetë e dytë publike me gojë në bazë të nenit 169, nenit 169, nenit 170 të LP I nr. 1958/2016 të datës 04.01.2018 të Përbaruesit Aleksandar Kuzmanovski nga Gostivari.
2. Personin Zhivka Angevaska nga Shkupi me banim në bul. Ilinden 9-4 për shkak të dorëzimit të:
  - Proceverbale për shpjetë të pronës së patundshme përmes ankandit publik me gojë në bazë të nenit 175 paragrafi 3 të LP I nr. 1958/2016 të datës 19.12.2017.
  - Lajmërim nga 04.01.2018.
  - Konkluzion për Shpjetë e dytë publike me gojë në bazë të nenit 169, nenit 169, nenit 170 të LP I nr. 1958/2016 të datës 04.01.2018 të gjitha të Përbaruesit Aleksandar Kuzmanovski nga Gostivari.

Në afat prej 1 (një) dite duke konsideruar nga dita e publikimit të kësaj thirrje publike në shtypin ditor. PARALAJMËROHEN borxhliu Ardijan Ramadan, debitori i pengut Qemal Ramadan dhe personi Zhivka Angevaska se mënyra e këllëje e dorëzimit konsiderohet si e regullt dhe se pasojat negative që mund të dalin do t'i bartë vetë pala. Kjo shpallje paraqet SHPLLJEN E TRETË.

Përbarues  
Aleksandar Kuzmanovski

**Koha** <http://www.koha.mk> Search

**Koha**  
E përditshme informative

**Koha**  
Gazeta Zyrtare e RM nr. 72/2016 të datës 12.04.2016

**Koha**  
Me Kosovën s'kë çështje të hapë

**Koha**  
Kur shkollat dëshohen me mbi 26.000 euro!

**Koha**  
BBI 10 komunë, ASH 3 BENA I dhe FISH I

**Koha**  
Në 17 sektore, anije shqiptarë ndërheqis

**Koha**  
Si gjatë vendlindit në 55 vjetor

**Koha**  
Kandidatët e interesuar të informohen për kushtet e punës në adresën: [www.koha.mk](http://www.koha.mk)

**www.koha.mk**  
[koha@koha.com.mk](mailto:koha@koha.com.mk) | [marketing@koha.com.mk](mailto:marketing@koha.com.mk)  
Tel: 02 3179 - 904; Fax: 02 3118 - 060;  
Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, I.Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdheshë, Shkup

**Urgjentisht shitet shtëpi në rr. Pere Toshev nr. 30 - Xhon Kenedi, Shkup me sipërfaqe prej 140 m2 oborr dhe 116m2 objekt banimi. Kontakt telefoni 072/643 093**

PLAS "BOMBA"  
TE REAL  
MADRIDI



# ZIDAN LARGOHET NË QERSHOR, BISEDIME ME JOACHIM LEV!

Siç raportohet nga portali "Unë jam Madridist", Florentino Perez, presidenti i "Los Blancos", tashmë ka vendosur që trajneri francez të mos vazhdojë nga 30 qershori i ardhshëm. Po ashtu, është përvijuar edhe emri i pasuesit të tij ideal. Ky është gjermani Joakim Lev, trajneri aktual i kombëtares gjermane, edhe pse argjentinasi Mauricio Pochettino (Totenhem) është opsioni tjetër në tryezën e Perez

Zinedin Zidane, trajnerit të Real Madridit, tashmë i ka skaduar data, sipas informacionit që ka filluar të filtrohet nga politika e klubit mbretëror spanjoll. Siç raportohet nga portali "Unë jam Madridist", Florentino Perez, presidenti i "Los Blancos", tashmë ka vendosur që trajneri francez të mos vazhdojë nga 30 qershori i ardhshëm. Po ashtu, është përvijuar edhe emri i pasuesit të tij ideal. Ky është gjermani Joakim Lev, trajneri aktual i kombëtares gjermane,

edhe pse argjentinasi Mauricio Pochettino (Totenhem) është opsioni tjetër në tryezën e Perez. Siç shpjegohet, lidhshipi i Real Madridit ka qenë në kontakt me Lev për të testuar gatishmërinë e përfshirjes së tij në këtë operacion dhe bisedimet janë në rrugën e duhur. Udhëheqësit e të bardhëve janë shumë optimistë në lidhje me opsionet për trajnerin gjerman, se në fund do ta pranojë propozimin e tyre. Handikapi kryesor i operacionit është se Lov ka një kontratë në fuqi me

Federatën Gjermane të Futbollit (DFB) deri në vitin 2020, prandaj, në përfundim të Kupës së Botës së kësaj vere në Rusi, ai do të duhet të japë dorëheqjen, ose të negociojë lamtumirën e tij. Gjithçka do të varet nga vullneti i mirë i treguar nga drejtuesit e DFB.

Zidan është i dënuar me largim për atë që ka ndodhur deri më sot, në këtë sezon, çfarëdo që të ndodhë në muajt e ardhshëm. Atë nuk do ta shpëtonte as fitimi i Ligës së Kampionëve për të tretën herë radhazi.

Trajneri francez e ka humbur në mënyrë të qartë impulsin e tij me Florentino Perez pas nënshkrimit të portierit Kepa Arrizabalaga. Joakim Lev ka qenë në krye të skuadrës kombëtare gjermane që nga viti 2006 dhe ka qenë gjithmonë i hapur për të marrë përgjegjësinë e drejtimit të një ekip të ligës spanjolle, sapo të përfundojë angazhimi i tij për "DFB". Natyrisht, Real Madridi do të ishte një "Olimp" për të, në karrierën profesionale, pas drejtimit me sukses të Gjermanisë.

## RAMIRES HAP DERËN PËR INTERIN

### Shpresoj të gjendet marrëveshja

Interi po kalon një kohë të vështirë pas një fillim të shkëlqyeshëm të sezonit. Menaxhmenti zikalitër po punon për ta mbështetur skuadrën sa më shumë të jetë e mundur. Për disa kohë nuk është folur për ish-lojtarin e Çellsit, Ramires, i cili tani shprehet drejtpërdrejt nga tërheqja e Jiangsu Suning në Marbella. I intervistuar nga mikrofoni i "Sky Sport", mesfushori brazilian hap derën për Interin. "Unë jam këtu për të filluar përgatitjen, pastaj do të shohim se çfarë ndodh. Nëse Interi ka folur me menaxherin tim, kjo është një gjë pozitive. Përdorimi i Interit është i interesuar për mua, kjo do të thotë se jam duke punuar mirë, ndaj duhet të vazhdoj kështu. Nëse duhet të ketë një



shans për të shkuar tek Interi do të isha shumë i lumtur, por unë jam ende te Jiangsu dhe duhet të përqëndrohem këtu. Nëse do të

kthehesha në Europë për të luajtur në një klub të madh, do të isha i lumtur. Jam gati", shprehet Ramires. Ndryshe, pengesa kryeso-

re është angazhimi i lartë i lojtarit, i cili shpreson, megjithatë, në mbylljen e marrëveshjes. "Nuk varet vetëm nga unë çështja e reduktimit të angazhimit financiar apo jo, ka disa palë të përfshira. Të gjithë duhet të jenë të kënaqur, si Jiangsu, edhe Interi. Shpresoj se mund të arrijmë një marrëveshje", shtoi më tej ai. Ramires, nuk ka kontakt me Spalletin, por mesazhi i tij është i qartë. "Unë nuk arrita të flisja me Spalletin, kur Interi erdhi në Kinë. Nuk kisha mundësi ta takoja atë për shkak të kohës së ndryshme të trajnimit mes nesh dhe atyre, por është trajner i madh. E njoh atë para se të arrihte tek Interi, jam i lumtur që diku shi ai më ndjek mua", përfundoi Ramires.



### Ançeloti, pasuesi i Venger?

Karlo Ançeloti do të jetë pasuesi i Arsen Venger tek Arsenal. Kështu raportojnë mediat angleze dhe ato italiane. Trajneri francez, që drejton prej 21-vjetësh "Topçinjtë" do të largohet në fund të sezonit, për t'ia lënë vendin italianit, i cili do të nënshkruajë një marrëveshje 4-vjeçare, nga e cila do të përfitojë në total 40 milionë euro, pa bonuset. Pronarëve të klubit londinez u ka sosur durimi me francezin, që për herë të fundit titullin e Premier Ligë e ka fituar në vitin 2004. Zbehet mundësia që Ançeloti të marrë drejtimin e Kombëtares Italiane. Në fakt, vetë 58-vjeçari, i cili ka fituar 20 trofe në 5 vende të ndryshme e kishte bërë qartë që synon të jetë në qendër të një projekti me një klub të njohur. Arsenali ndoshta është destinacioni ideal për të nisur një epokë të re në Premier Ligë.

### Mina, për 11.8 mln euro te Barcelona



Është zyrtare. Barcelona njoftoi të enjten nënshkrimin e saj me Jerry Mina për pjesën e mbetur të sezonit dhe pesë të tjerë të tillë. Barça do të paguajë Palmeirasin 11.8 milionë euro për "centralin" kolumbian, i cili do të ketë një klauzolë largimi nga katalanasit prej 100 milionë eurosh. Mina do të nënshkruajë deri më 30 qershor 2023, kohëzgjatje e njëjtë e kontratës si braziliani Koutinho. Çdo gjë tregon se Mina do të zërë vendin e lirë që Mascherano do të lërë në këtë merkato dimërore. Ndryshe, Jerry Mina ka lindur më 23 shtator 1994 (Guachene, Kaukaz, Kolumbi) dhe arrin te Barcelona për të përforcuar boshtin e mbrojtjes. Ai do të ndikojë për mirë në luftën ajrore, falë gjatësisë prej 1.95 metrash. Falë fizikut të tij imponues, Mina është edhe një shënues qendror. Në 49 ndeshje me Palmeiras, ai ka shënuar 9 gola. Në sezonin e tij të parë me ekipin brazilian, Mina u zgjodh qendra më e mirë e kampionatit brazilian, ndërsa në vitin 2017 ishte më i miri i "Kampionatit Paulista".



**DASHI** 21. mars - 20. prill

Zemra për të dashuruarit është e mbushur me emocione dhe do të jetë e vështirë për të folur me ta. Mundohuni të mos e largoni partnerin/en nga ky gëzimi juaj. Shumë heshtje nuk është e mirë për dashurinë. Beqarët do të jetë në kërkim të miqësisë të reja, por do të jetë më mirë që më parë të shmangni pasiguritë. Një rezultat i mirë në punë do t'ju pëlqejë.



**DEMI** 21. prill - 21. maj

Megjithë Hënën në kundërshtim me shenjën tuaj, emocionet do jenë të mira. Në frontin privat pranoi me entuziazëm propozimet e partnerit/es, pasi kjo do e bëjë atë të lumtur. Beqarët do të duhet të lënë pas të kaluarën dhe të vlerësojnë të tashmen. Vetëm në këtë mënyrë mund të jenë objektivë. Edhe sot mendja gjen hapësirën e duhur, po vijin ide të reja.



**BINJAKET** 22. maj - 21. qershor

Do të jesh plot energji, gati për të dhënë maksimumin në jetën tuaj në çift. Trajtojeni veten me një mbrëmje relaksuese me partnerin/en. Hëna është me ju! Ditë e bukur edhe për beqarët që mund të gjejnë dashurinë. Ju do të jeni të ëmbël dhe romantik si kurrë më parë! Do të keni ide më të qarta se si të lëvizni për të arritur qëllimet tuaja dhe për të forcuar pozicionin tuaj profesional.



**GAFORRJA** 22. qershor - 22. korrik

Një punë e paparashikuar do të minojë qetësinë e brendshme, por me ndihmën e Hënës në Akrep, do të jeni të qetë dhe do të relaksoheni me të dashurin/en tuaj. Beqarët mund të kalojnë një mbrëmje të mirë në shoqërinë e miqve. Në punë pavarësisht gjithçkaje qëndroni konçiz në atë që kërkoni dhe propozoni.



**LUANI** 23. korrik - 22. gusht

Një ditë e vështirë për jetën tuaj private. Ju gjithashtu do të duhet të merreni me një çështje të vogël familjare, të përdorni kontaktin dhe të kuptuarit në mënyrë që të mos lëndoni të tjerët. Nëse jeni vetëm mund të njihni miq të rinj në rrjetet sociale, por bëni kujdes nga mashtrimet. Nëse punoni në varësi të të tjerëve, mund të keni konflikte me një epror, veproni me diplomaci.



**VIRJERESHA** 23. gusht - 23. shtator

Dashuria dhe seksi sot ecin krahas për krahas dhe do ju japin emocione intensive. Nëse bëni premtime, përpuni t'i mbani ato. Shumë beqarë do të duhet të marrin një vendim të rëndësishëm, të dëgjojnë ndjenjat e tyre. Në punë do të shkëlqeni për iniciativë dhe shkathësi dhe do të merrni rezultate të shkëlqyera.



**PESHORJA** 24. shtator - 23. tetor

Mërkuri dhe Saturni sot janë në kundërshtim me shenjën tuaj, por do të përballeni me çdo problem, duke luftuar për të pushtuar zemrën e partnerit/es. Beqarët do të ndjehen të paduruar, do të bëjnë një përpjekje të vogël për të kuptuar të tjerët! Në punë do të jeni më të vendosur se kurrë dhe nuk do të ktheheni nga vendimi juaj.



**AKREPI** 24. tetor - 22. nëntor

Sot do të keni një ngarkesë të madhe të entuziazmit dhe euforisë, gjithçka do të jetë e mrekullueshme. Ju jeni gati për të planifikuar të ardhmen me partnerin/en tuaj! Beqarët do të jenë optimistë dhe të gatshëm për t'u argëtuar në takime. Kjo ditë hap perspektiva të reja në lidhje me jetën tuaj profesionale, shfrytëzojeni!



**SHIGJETARI** 23. nëntor - 21. dhjetor

Ndiq instinktet tuaja dhe zbukuro historinë tënde të dashurisë. Ju jeni intrigues dhe interesantë, partneri/ja nuk do t'ju rezistojë dhe do të bjerë në këmbët tuaja. Beqarët sot do të jenë shumë të sinqertë në çdo hap. Në punë vendos përqendrimin në plan të parë. Ju do të jeni të përpiktë dhe të rregullt për të shmangur rrezikun e shpërqendrimeve dhe gabimeve.



**BRICJAPI** 22. dhjetor - 20. janar

Qetësia juaj është sa e dukshme dhe e fshehur në një dëshirë të madhe. Partneri/ja nuk do të vlerësojë disponimin tuaj, dhe kjo nuk do ju pëlqejë aspak. Sot, beqarët do të jenë në gjendje të zgjidhin një çështje delikate dhe do të jenë në gjendje të përmirësojnë një miqësi të vjetër. Në punë do të jesh i/e pamposhtur!




**UJORI** 21. janar - 19. shkurt

Sot ju do të keni mbrojtjen totale të yjeve në marrëdhënien tuaj të dashurisë. Ju do të pushtoni partnerin/en tuaj dhe do të përjetoni emocione të pabesueshme. Beqarët do të marrin lajme të mira dhe mund të kalojnë një mbrëmje të lumtur në shoqërinë e miqve të besuar. Financat do të jenë të mira, por bëni një shqyrtim të kujdesshëm të llogarive.



**PESHQIT** 20. shkurt - 20. mars

Planetët në qiell janë në anën tuaj dhe ju sigurojnë momente të lumtura: një ditë me të vërtetë pozitive dhe e dobishme ju pret. Gëzimi i madh në dashuri edhe për beqarët: sot ju mund të takoni personin e ëndrrave. Sot është një ditë e mrekullueshme edhe për punën, do të ofrohen mundësi të mira, nuk do të shmanget ato më të mirat.



KOHA	SPORTISTI NË FOTO ISHTE ...	PIKTURA QË BËHET ME BOJERA UJI MBI SUVA TË NUOMË	BËRSI RRUSHI	KOHA	E RESHUR E DIMRIT KËNGËTARE ISLANDEZE	Mensur Mamuti	ÇEKAN	DËRGUAR	SHTETI I SPORTISTIT NË FOTO SHUFËR E HOLLË METALIKE	K
BAZAT E ARSIMIT TEKNIK				QYTETI I LINDJES SE SPORT NE FOTO		GRUP I VOGËL I ARMATOSUR				
BËJ OFERTË				POLITIKANI GABONEZ, DANIEL ONDO		BREZ I FORTË PREJ LËKURE OSE PREJ LESH!				
APARAT PËR MATJEN E KOHËS				AKTORJA POLAKE, PATRICIA TITANI		Q				
NDAJ BËJ SEPARIM						KILOGRAM				
QYTET I LASHTË NË AZI TË VOGËL						ILIRIANA SULKUQI			LITRI TRUP GJEGOMETRIK	
EKREM KRYEZIU		TEMPERATURA				THIKË E VOGËL				
QË KA FITUAR RUTINË						KOHA	GRUPI AMERIKAN, DI EM SI			
						XH	SPORTISTI AMERIKAN NË FOTO			
						AKTORJA AMERIKANE, DEREK		TANTALI		
								LËSHON (PËR BLETËT)		
										MIZA QË JETOJNË NEPER DRURË

ZGJIDHJET: K, ÇETA, QEMER, KILO, IS, L, ÇAKI, RAN, XH, TA, BORE, BAT, BOFORT, OFROJ, RIKE, KRONOMETER, SEPAROJ, NM, ISI, KAZADI, EK, T, NETËT, RUTINAR, SHE.

## Sudoku

shumë i lehtë

mesatar

		4	8	2	3																
					4	3	9			9		2		1		5					
								8													
5	2		9	3							9	7	2								8
8			6		2						8										9
6				8	1																7 3
	3											6									4
	6	5	3									9	8			2	6				1
			4	6	5							7			4						2

Shumë i lehtë: 954823716, 786154392, 312796485, 521937648, 873642159, 649581273, 138279564, 465318927, 297465831. Mesatar: 328175496, 915426783, 674398512, 497253168, 182647935, 563981247, 236519874, 749832651, 851764329.

## Australi, temperaturat e larta shkaktojnë ngordhjen e qindra lakuriqëve

Temperaturat që këto ditë kanë shkuar deri në 45 gradë Celsius kanë çuar në ngordhjen e qindra lakuriqëve në Sydney të Australisë. Në Sydney, dy ditë më parë, termometri ka teguar 47.3 gradë Celsius, duke e bërë atë ditën më të nxehtë në atë rajon që nga viti 1939. Shtëpia mediale lokale Camden Advertiser njoftoi se të dielën ishte regjistruar 45.1 gradë Celsius, e cila çoi në ngordhjen e më shumë se 500 lakuriqëve. Kate Ryan, drejtore e zyrës për mbrojtjen e lakuriqëve Flying Fox Campbelltown, deklaroi se lakuriqët për shkak të temperaturës së lartë kishin djegie. Shërbimi për Informim, Shpëtim dhe Trajnimin e kafshëve të egra në Uellsin e Ri Jugor tha se vullnetarët ishin në terren dhe u kanë dhënë ujë lakuriqëve. Në këtë mënyrë, ata shpëtuan më shumë se 100



sosh. Megjithatë, qindra që ishin ngjitur në pemë nuk mbijetuan. Në shtator 2017, australianët u paralajmëruan për rrezikun e temperaturave të larta dhe të zjarreve në

këtë sezon veror pas një nga dimrat më të thatë që kur ekzistojnë matjet zyrtare atje. Gjatë fundjavës ishte regjistruar edhe dita më e nxehtë në 79 vitet e fundit.

## “MAKINA EZGJUAR”, Byton prezanton të ardhmen



Ish punonjës të BMW dhe Apple shfaqën për publikun makinën e tyre elektrike, me të cilën pretendojnë që të ndryshojnë pikëpamjen e njerëzve për automobilin. Makina Byton, kroskoti i së cilës është një ekran gjigant me prekje,

synon që të ndryshojë rrënjësisht atë që pritet nga pjesa e brendshme e makinës. Në letër, Byton nuk matet dot me performancën e rivalit Tesla, por ndërtuesit e saj thonë se nuk ishte ky qëllimi. Kompania e re kërkon që t'i bëjë njerëzit të interesonte për fuqinë dixhitale të mjetit me katër rrota dhe jo kuajt fuqi. Carsten Breitfeld, shefi i kompanisë, tha se ideja e tyre është që të nxjerrin në treg makinë e parë vërtetë të zgjuar. Veç ekranit gjigant në kroskot, makina ka një ekran me prekje në timon dhe pas sediljeve me qëllimin që të

transferojë jetën sociale online të njerëzve nga shtëpia apo celularët në makinë. Automjeti elektrik është pajisur me sensorë për autonomi të nivelit 4 që teorikisht lejojnë shoferin të dremisë rehat, ndërsa makina udhëton drejt destinacionit. Gjithsesi, rregulloret ende nuk e lejojnë këtë, kështu që për momentin makina do të prodhohet me nivelin 3 të autonomisë, që do të thotë se ecën vetë, por shoferi duhet të qëndrojë vigjilent e të mos hutohet pas ekranit të madh dhe lukseve të tjera që automjeti ofron.

## Këndimi "përshejton" shërimin nga depresioni postnatal



Këndimi ndihmon përshejtimin e shërimin të nënave të cilat kanë hyrë në depresionin postnatal (pas lindjes). Sipas lajmit të BBC-së, në një hulumtim të publikuar në "British Journal of Psychia-

try" hulumtuesit kanë treguar se simptomat e depresionit postnatal te nënat të cilat këndojnë këngë pranë foshnjave të tyre në aktivitete grupore zvogëlohen më shpejtë në krahasim me nënat tjera.

Në hulumtim kanë marrë pjesë 134 nëna me depresion postnatal. Ato janë ndarë në 3 grupe, në nënat të cilat morën pjesë në aktivitete grupore të këndimit, në ato të cilat morën pjesë në aktivitetet e lojërave kreative, kurse grupi i tretë mori ndihma të zakonshme, si mbështetja familjare, ilaçet kundër depresionit ose terapia vetëdijësuese. Nënate të cilat kënduan pranë foshnjave të tyre ninulla të mësuara nga e gjithë bota, ose krijuan këngë të reja për amësinë, treguan shërim shumë më të shpejtë se sa nënat në grupin e lojërave dhe në grupin e trajtimeve të tjera. Në të 3 grupet u raportua shërim pas 10 javësh, por në gjashtë javët e para grupi i kënduesve kishte raportuar një rënie mesatare prej 35 për qind të simptomave depressive.

1528 - Gustavi I kurorëzohet si mbret i Suedisë.

1755 - Carina Elizabeta themelon Universitetin e parë rus.

1940 - Lufta e II Botërore: Sovjetikët bombardojnë qytetet e Finlandës.

1948 - Mahatma Gandhi fillon agjërimitin e tij të fundit.

1970 - Përfundon Lufta e Biafranit. Biafrani i dorëzohet Nigerisë.

1974 - Libia dhe Tunizia shpallin shkrijen e tyre në "Republika Islamike Arabe".

1977 - Fillojnë demonstratat në Izrael kundër Francës pasi Parisi të lirojë Abu Daudin, përgjegjës për masakrën ndaj atletëve izraelit në vitin 1972 në Mynih.

1994 - Arrestohet vajza e Mallkom X për komplot në vrasjen e Louis Farrakham.

2006 - Turqia liron nga burgu Mehmet Ali Ağgca, i cili mbajti 25 vjet burg për tentim vrasje ndaj Papa Xhon Palit II

2010 - Tërmet i madh në Haiti. 230.000 të vdekur dhe pjesa më e madhe e kryeqytetit Port-au-Prince mbetet e shkatërruar.

Edhe puna e striptistes nuk është e mbrojtur nga vërshimi i robotëve "humanoidë" në jetën e përditshme. Në Las Vegas po mbahet këtë javë një spektakël me striptiste robot, organizuar posaçërisht për një konventë të apasionuarish pas teknologjisë. "Më duhen para për bateri", ose "Më ndihmoni për të studiuar për teknologji" ishin disa nga mesazhet në koshat e bakshisheve... Një goditje mjaft e zgjuar marketingu. Por jo të gjithë të pranishmit ishin të mahnitur. "Kam parë robotë të bëjnë lëvizje shumë më të vështira se këto", thotë njëri prej pjesëmarrësve. Dhe ndoshta me standardet e teknologjisë së lartë të ditëve të sotme ka të drejtë. Ato janë ndërtuar me pjesë mekanikësh, metale të vjetra dhe kamera rrugësh.



### DY PACIENTË NË SPITAL

Dy pacientë të shtrirë në spital flasin me njëri-tjetritin:

- Çfarë të gjeti ty?
- Nuk i bleva guas veturë.
- Po ty?
- Unë i bleva veturë.



Gratë janë të këndshme të biesh në krahët e tyre, por jo në duart e tyre.

(thënie latine)



KALENDARI HISTORIK 12 JANAR



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS